

PËRMBAJTJA



3 Nacionalizmi i pandëshkuar...



5 Mësimi përfundoi



20 Intervistë me Sead Ramadanin



24 Allahu është i vetmi gjykues



36 Rrethina e Malishevës nis...

Portreti i muajit: Sulltani i shekullit XXI	2
Dr. Milazim Krasniqi: Nacionalizmi i pandëshkuar serb në dyert e Brukselit	3
Muhamet Jahiri: Sa po zbatohet Kushtetuta e Kosovës dy vite pas hyrjes së saj në fuqi?	4
Drita Vitia: Mësimi përfundoi	5-6
Abdurrahim Maxhuni: Suksesi i dobët i nxënësve rezulton edhe në testin e maturës	7
Fatos Shala: Dhuna nëpër shkolla – shqetësuese ..	8
D. V.: Frymë e re në UP	9-11
Osman D. Gashi: Studentët – nismëtarë dhe bartës të proceseve	12-13
Alban Zeneli: Efektivat e policisë po plaken	14
Lulzim Ahmeti: "Kosova e Re" mund të mos ndërtohet	15
Astrit Veliqi: Ndotja e mjedisit në Kosovë i tejkalon standardet evropiane	16-17
Iljasa Salihu: Mërgata shqiptare – kultivon vlera fetare dhe kombëtare	17-19
Intervistë me humanistin dhe veprimtarin Sead Ramadanin	20-23
Mr. Muhamed Jusufi: Allahu është i vetmi gjykues .	24-27
Mr. Ferdi Kamberi: "Meditime..." një mesazh modest social e fetar	28
Emine A. Vezaj: A janë politike të drejtat e njeriut?..	29
Avni Avdiu: Kirgistani – kur shqiponja bëhet pulë ...	30-31
Hekuran Avdyli: Librat islam më të shiturit në pavnair	32-33
Ndodh edhe kjo	33
Illir Sefaj: Kritika – cila është ajo?	34
F. Maloku: Promovohet kompleti i librave të Nexhat Ibrahimit	34
Agim Avdiu: Misteret e fundit të botës	35-36
Artan N. Bejta: Rrethina e Malishevës nis "luftën" me rriqrat	36-37
Dilaver Polisi: Historiku i botërorëve nga viti 1930-2006	38
Alban Bilalli: Xhamia në Sevilje, pronë e një futbolisti	39
Fjalëkryqi	40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti V / Nr. 43
19 qershor 2010 - 19 korrik 2010

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Redjtor

Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës

Avni AVDIU

avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës

Flamur MALOKU

flamurmalku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika

Osman D. GASHI

osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore

Mimoza SINANI

e-mail:

revistapaqja@gmail.com

revistapaqja@hotmail.com

http://www.zeri-yne.org

Adresa:

Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Portreti i muajit

Sulltani i shekullit XXI

Fama e tij dhe e presidentit Abdulah Gyl te qytetarët turq vazhdon të shënojë rritje të konsiderueshme. Në këtë kontekst mund të flitet edhe për reagimin e tij pas ndërhyrjes së ushtrisë izraelite në flotën e anijeve humanitare që ishin nisur për në Gaza. Sulmin të cilin e dënoi njëzëri edhe OKB-ja, e cila kërkoi hetime të paanshme, e dënoi më ashpër kryeministri turk Erdogan, i cili dërgoi disa mesazhe jo vetëm për Izraelin. Duke i cilësuar vrasjet në anije si masakër e përgjakshme, Erdogani tha se sulmi në ujërat ndërkombëtare të Detit Mesdhe 'tregon pasigurinë dhe traumën nëpër të cilën po kalon qeveria çifute'. Duke i përcjellë viktimat turke në qytetin e Konjës, Erdogani tha: "Le ta dijë Izraeli se Turqia nuk është vend fisesh, se Izraeli do ta paguajë rëndë këtë dhe kjo do të ketë pasoja të pariparueshme. Nëse bota ia

ka kthyer shpinën Palestinës, Turqia nuk do t'ia kthejë kurrë shpinën Kudsit. Fati i popullit palestinez nuk është i ndarë nga ai i popullit turk, as fati i Gazës nga fati i Ankarasë. Nëse bota hesht, ne nuk do të heshtim; nëse bota mbyll sytë përballë kësaj masakre, ne nuk do t'i mbyllim; nëse bota bën sehir, ne nuk do të rrimë duarkryq. Ne nuk do të lëmë të derdhet gjaku palestinez, sepse kjo nuk i shkon për nder popullit e kombit turk". Ai ia bëri me dije SHBA-së se nuk do ta pranonte dot kualifikimin e Hamasit si organizatë terroriste. Lëvizja e Rezistencës Islame (Hamas) është lëvizje rezistence që lufton për të mbrojtur tokën e saj. Erdogani ia bëri me dije edhe Perëndimit 'demokratik' se shumë anëtarë të Hamasit janë duke u dërguar në burgjet izraelite, edhe pse fituan në zgjedhjet e lira demokratike, kështu që atyre po u ndalohej e drejta e tyre për të qeverisur. ■

BIOGRAFIA:

Rexhep Tajip Erdogan lindi më 26

shkurt 1954, në Stamboll.

Ka qenë kryebashkiak i Stambollit, kurse që nga 14 marsi i vitit 2003 e deri tani është kryeministër i Turqisë. Njëherësh është kryetar i partisë në pushtet për Drejtësi dhe Zhvillim, e cila ka shumicën e ulëseve në Kuvendin e Madh Kombëtar të Turqisë. Ai diplomoi më 1981 në Universitetin Marmara, në Fakultetin e Shkencave Ekonomike. Në politikë është inkuadruar qysh në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare. Në periudhën 1969-1982 ka qenë i angazhuar në karrierën sportive si futbollist gjysmëprofesionist. Nga koha kur Partia për Drejtësi dhe Zhvillim mori pushtetin në vitin 2002, politika e jashtme e Turqisë ka ndryshuar për 180 shkallë. Brenda një periudhe të shkurtër kohore, ai ka ndërmarrë reforma të shumta. U sollën shumë ligje që kontribuuan në demokratizimin e vendit, në arritjen e transparencës dhe në parandalimin e korrupsionit. Inflacioni u vu nën kontroll, kurse lirës turke iu kthye vlera e saj monetare. Të ardhurat për frymë u ritën dukshëm.



Nacionalizmi i pandëshkuar serb në dyert e Brukselit



Dr. Milazim KRASNIQI

Ministrat e jashtëm të shteteve anëtare të Bashkimit Europian, në takimin e mbajtur më 12 qershor në Luksemburg, ranë dakord për fillimin e ratifikimit të Marrëveshjes së Stabilizim-asocimit me Serbinë, duke ia dhënë asaj edhe një copë të pamerituar të karotës. Pajtimi i ministrave u bë edhe falë raportit të prokurorit kryesor të Tribunalit të Hagës, Serzh Bramercit, i cili raportin e vet ua paraqiti atyre para se ta dërgojë në selinë e OKB-së. Sipas fjalëve të Bramercit, “raporti është pozitiv, por përmban edhe kritika.” Mirëpo, ministrat e jashtëm u bazuan në “raportin pozitiv” dhe e ndezën dritën e gjelbër të ratifikimit të MSA me Serbinë. Kësaj radhe, edhe Holanda u step nga raporti pozitiv i Bramercit dhe paralajmëroi se nuk do ta bllokojë procesin e ratifikimit. Ministri i jashtëm i Italisë, Franko Fratini, shprehu entuziazmin e vet, duke paralajmëruar se Italia do ta ratifikojë menjëherë, meqë ekzistua pëlqimi për këtë gjë edhe ndërmjet qeverisë dhe opozitës italiane. Bile, ai shprehu dëshirën që të ndodhte edhe deblokimi i procesit të pranimit të kandidaturës së Serbisë, e cila është paraqitur nga presidenti serb, Boris Tadiq, më 22 dhjetor 2009 te kryeministri suedez, Fredrik Rajnfelt, i cili në atë kohë e kryesonte Bashkimin Europian.

Fillimi i ratifikimit të marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Serbinë nga ana e shteteve të Bashkimit Europian, është në vazhden e koncesioneve të palogjikshme që shtetet europiane ia bëjnë shtetit serb. Përveç faktit që nuk janë dërguar në Hagë Ratko Mlladiqi dhe Goran Haxhiqi, Serbia e ka edhe një mal problemesh që do të duhej t’u jepte zgjidhje para përparimit në procesin e integritimit në Bashkimin Europian. Para së gjithash, Serbia do të duhej të kishte bërë përparime në “bashkëpunimin rajonal”, për çfarëdo fillimi të procesit të ratifikimit të MSA. Ndërsa, sa i përket

bashkëpunimit rajonal dhe veçmas në raportit me Kosovën, Serbia do të duhej të ndëshkohej me sanksione e jo të shpërblehej me ratifikimin e MSA. Mbajtja vetëm para disa javësh e zgjedhjeve komunale në Mitrovicë, nga ana e partive politike të Serbisë, është tregues i qartë se ndërhyrja e saj në shtetin e ri të Kosovës është flagrante. Mitingjet nacionaliste të Tomislav Nikoliqit, mesazhet për spastrim etnik të veriut nga shqiptarët të Vojislav Koshtunicës dhe provokimet në ditën e zgjedhjeve nga paramilitarë serbë, janë provë e sigurt se asgjë nuk ka ndërruar në agjendën e politikës zyrtare të Serbisë, sa i përket projektit të Serbisë së Madhe dhe mbajtjes së rajonit në jostabilitet permanent. Vetëm falë prezencës ushtarake të NATO-s është duke u ruajtur paqja në relacionet ndërmjet Kosovës e Serbisë. Kjo do të thotë se Serbia nuk ka bërë asnjë lëvizje në drejtim të shpëputjes nga e kaluara e errët nacionaliste, kur me anën e spastrimit etnik dhe të gjenocidit, u bënë përpjekje që të krijohet Serbia e Madhe.

Por, krahas mbajtjes së zgjedhjeve komunale në shtet fqinj, Serbia po punon edhe projekte të tjera që janë në esencë thellim i agresionit ligjor e kushtetues në Kosovë. Edhe draft-ligji më i ri i planifikimit hapësinor të Serbisë për vitet 2014-2021 është në vazhden e ndërhyrjeve drastike në shtetin e ri të Kosovës. Ky plan e përfshin Kosovën në kuadër të organizimit hapësinor të Serbisë, duke specifikuar edhe mjete e modalitete për projektin serbizues. Në këtë kontekst, një element i ri paraqitet, “turizmi fetar” në ambientet dhe rrethinat e kishave dhe manastireve ortodoske serbe. Në këto hapësira të mbrojtura, parashihet të zhvillohen aktivitete turistike e politike. Kjo edhe për faktin se Plani Gjithëpërfshirës i Ahtisarit, u ka dhënë status të veçantë. Në këtë kontekst, Serbia planifikon



shfrytëzimin e ujërave të pijshme në rajonin e Sharrit (në komunën e Shtërpcës), mbledhjen dhe përpunimin e prodhimeve të malit, zhvillimin e industrisë ushqimore me prirje drejt eksportit, etj. (Gjynah që institucionet e Kosovës nuk kanë këso planesh, ose së paku nuk i kopjojnë këto të Serbisë për zhvillimin e ekonomisë në komunat e vendit!)

Me një fjalë, ndërhyrja e Serbisë në Kosovë nuk ka të bëjë vetëm me veriun e vetëm me mosnjohjen e shtetit të Kosovës. Ndërhyrja e saj në Kosovë është edhe kapilare, pra deri te planifikimet hapësinore të komunave, përkatësisht deri te mbledhja e lenave në male. Natyrisht, brenda kësaj politike, duket si veprim normal për burokratët e Brukselit edhe mbajtja për dhjetë vjet në këmbë e strukturave pushtetore komunale të “komunave të Kosmetit”, në Serbi. Para pak ditësh ndodhi një incident brutal që e shpërfaq gjithë këtë politikë: në Kurshumli u rrahën masivisht “anëtarët e komunës së Podujevës”, të cilët tash dhjetë vjet mbahen si strukturë komunale e Podujevës në Kurshumli. Ata u rrahën për hesapet e veta, për paratë që ua jep shteti serb, duke i mbajtur si struktura të gatshme për kthim në Kosovë si pushtet okupues.

Si është e mundshme që të gjitha këto marifete të Serbisë nuk i sheh Bashkimi Europian e madje as të njëzet e shtatë shtetet anëtare? Si është e mundshme që të vlejë për Serbinë standarde aq të ulëta të integritimit, aq sa edhe këso ndërhyrjesh brutale në një shtet, të cilin e kanë njohur 22 shtete të Bashkimit Europian, kalojnë pa u vërejtur?

Por edhe hipokrizia e ka çmimin e vet. Fitorja në Belgjikë e forcave që angazhohen për dezintegrimin e shtetit, është një tregues shqetësues se paaftësia e Bashkimit Europian për t’u bërë një strukturë kredibile, e aftë të imponojë standarde universale për të gjithë, po e godet mu në zemrën e vet. Tolerimi dhe shpërblimi i nacionalizmit në Serbi është si virusi që herët a vonë do të japë virulencë edhe në tërë Evropën. Nëse nacionalizmi dhe agresioni paguhen, atëherë shumë shtete mund ta provojnë t’i vjelin frutat e tij. ■

Sa po zbatohet Kushtetuta e Kosovës dy vite pas hyrjes së saj në fuqi?



Muhamet JAHIRI

Me rastin e dyvjetorit të hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, krijuesit e saj nuk janë të kënaqur me respektimin dhe shtrirjen e saj në gjithë territorin e Kosovës. Sipas tyre, krijimi i Kushtetutës ka qenë akt historik, mirëpo duhet të punohet shumë për implementimin dhe mos shkeljen e saj.



Kosumi: Kushtetuta – fitore historike e Kosovës

Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Bajram Kosumi, duke folur për dyvjetorin e hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, ka thënë se kjo është datë historike dhe krenarie për Kosovën, por duhet të bëhet më shumë që Kushtetuta e Republikës të mos mbetet vetëm dokument në letër.

“Kushtetuta e Kosovës, e tillë çfarë është, është fitore historike në Kosovë, por deri tash ajo ka mbetur ende dokument në letër. Shteti i Kosovës është bërë, por shteti i Kosovës është ende pa përmbajtje. Klasat politike në Kosovë ende nuk po munden ta ndërtojnë nga brenda shtetin tonë. Ende nuk po mundet të ketë një rend ligjor e demokratik”, - ka thënë Kosumi.

Ai ka theksuar se vendi po vazhdon edhe më tutje të dirigjohet nga grupe të ndryshme të interesit, të cilat po e shkelin edhe vetë dokumentin më të lartë shtetëror.

“Kosova ende dirigjohet prej grupeve të vogla politike të implikuar në biznese etj, e jo nga institucione legjitime demokratike. Vetë fakti që Kosova po

udhëhiqet prej grupeve dhe individëve, e jo prej institucioneve, është shkelja më e madhe që mund t'i bëhet kushtetutës”, - ka pohuar deputeti Kosumi.



Beqiri: Do të bëjmë më shumë për Kushtetutën

Edhe Ismet Beqiri, duke folur për dyvjetorin e hyrjes në fuqi të Kushtetutës, ka thënë se ky dokument, më i larti i një vendi, është mjaft modern, edhe pse sipas tij në një mënyrë disa çështje janë imponuar.

“Është shumë e rëndësishme që ne, si shtet, së pari, kemi arritur ta shpallim shtetin, ta bëjmë pavarësinë dhe t'i nxjerrim ligjet juridike dhe aktin më të lartë ligjor, Kushtetutën e Kosovës. Pa dyshim se kjo është një kushtetutë e mirë me disa nuanca dhe disa elemente, të cilat për hir të rrethanave dhe situatës është dashur të futen, por të cilat, realisht, në disa shtete nuk janë”, - ka deklaruar Beqiri, duke shtuar në këtë kontekst se kjo nuk duhet të shihet si pengesë për ecjen e mëtejshme përpara.

“Por kjo nuk duhet të jetë pengesë për ecjen përpara të shtetit të Kosovës. Kushtetuta nuk po mund të implementohet në tërë territorin e Kosovës. Është shumë e qartë se kushtetuta, pa ndihmën e Bashkësisë Ndërkombëtare, pa një këmbëngulje më të madhe të institucioneve vendore dhe pa një bashkëveprim, është e vështirë të implementohet”, - ka theksuar ai.

Sipas tij, një nga sfidat më të mëdha me të cilat po ballafaqohet Kushtetuta e vendit është veriu i Kosovës, ku ky dokument nuk po mund të zbatohet.

“Në veri të vendit, sovraniteti i Kosovës është veçanërisht i cunuar. Kemi struktura ilegale dhe mund të themi se me përjashtim të policisë, KFOR-it dhe mekanizmave ndërkombëtarë, në atë pjesë,

fatkeqësisht, nuk funksionon ndonjë institucion”, - është shprehur Beqiri, duke shtuar se do të kalohen edhe këto vështirësi.

“Shpresojmë se gradualisht do të kemi ndryshim të kësaj klime dhe të kemi një integrim më të madh të komunitetit serb. Por, akti i fundit i mbajtjes së zgjedhjeve serbe në atë komunë, ka qenë akti i fundit i shkeljes së kushtetutës atje, por absolutisht duhet që ta fusim nën kontroll edhe atë pjesë”, - ka pohuar deputeti Ismet Beqiri.



Zeneli: Krerët e vendit – shkelësit më të mëdhenj të Kushtetutës

Në anën tjetër, deputeti Lulzim Zeneli ka akuzuar krerët e institucioneve, të cilët sipas tij janë shkelësit më të mëdhenj të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

“Kushtetuta e Republikës së Kosovës jo vetëm që nuk zbatohet, por ajo po shkelet nga vetë krerët e shtetit dhe të flasësh për zbatimin e saj ose kushtetutshmërinë është njësoj sikur të themi se Kosova ka një ambient ekologjik”, - ka deklaruar Zeneli.

Zeneli ka thënë se Kushtetuta po shkelet edhe me moszbatimin e saj në të gjithë vendin dhe si shembull për këtë ka marrë veriun e Kosovës.

“Sot sovraniteti i Kosovës cenohet çdo ditë. Sovraniteti nuk është shtrirë në të gjithë territorin. Kemi të bëjmë me diçka që po e rëndon funksionimin e shtetit dhe, si rezultat i saj, Kosova po mbetet larg integriteteve evropiane. Ne jemi në një pozicion kur gjithçka që flitet për kushtetutën dhe ligjshmërinë po shndërrohet në suazat e një lufte mes pozitës dhe opozitës”, - ka theksuar deputeti Lulzim Zeneli.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi më 15 qershor të vitit 2008, pak muaj pas deklarimit të pavarësisë së shtetit të Kosovës. ■



Drita VITIA

Mësimi përfundoi

Në të gjitha shkollat e nivelit parauniversitar të Kosovës, tanimë ka përfunduar viti shkollor 2009/10. Derisa zyrtarët e Ministrisë së Arsimit vazhdojnë të nxjerrin statistikën për suksesin e përgjithshëm në nivel

vendi, fëmijët janë ata të cilët i janë gëzuar më së shumti fundvitit shkollor. Një gjë të tillë më së miri e shprehin ata të cilët në bankat shkollore u ulën për herë të parë në shtator të 2009-ës. Ata tanimë janë të lirë nga obligimet dhe pushimin do ta shfrytëzojnë duke lozur.

Tetëmbëdhjetë qershori shënon datën kur nxënësit përfunduan vitin shkollor 2009/10. Nxënësit që iu gëzuan më së shumti përfundimit të mësim-it, ishin ata, të cilët në shtator të 2009-ës ishin ulur për herë të parë në bankat shkollore. Tanimë ata janë lehtësuar nga mësimet dhe detyrat shkollore, ndërsa gjëja e vetme që ata do të bëjnë, sipas tyre, janë lojërat e ndryshme të cilat do t'i luajnë me bashkëmoshatarët. Për Gentin, i cili ka përfunduar me sukses relativisht të mirë klasën e parë të shkollës filllore, më e rëndësishmja është liria që do të ketë për rreth tre muaj rresht. Genti nuk do të merret shumë me detyra gjatë kësaj kohe, ngase thotë se dëshiron vetëm të pushojë dhe të luajë. Mirëpo, jo të gjithë nxënësit mendojnë njëllëj. Shoku i tij Endriti, edhe pse e ka mbaruar me sukses të shkëlqyer klasën e parë, thotë se një pjesë të madhe të pushimit do t'ia kushtojë mësimin dhe librave. Endriti ka thënë se i pëlqejnë shumë tregimet për fëmijë, të cilat do t'i lexojë gjatë pushimit veror.

Shkollat e kanë realizuar të gjithë planprogramin

Përkundër nxënësve, të cilët problemin më të madh e kishin përfundimin e vitit shkollor dhe fillimin e pushimeve

verore, Ministria e Arsimit po vazhdon me kryerjen e punëve edhe gjatë verës. Zyrtarë të kësaj ministrie kanë bërë të ditur se mësimi është zhvilluar sipas dinamikës dhe programeve që ka Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me planin dinamik të punës së vet dhe me të gjitha datat e përcaktuara që në fillim të vitit shkollor. Zyrtarët në MASHT thonë se të gjitha shkollave iu është dashur t'i përmbahen atij plani, sepse, sipas tyre, numri i orëve duhej realizuar pa mbetur zbrazëtira. Sipas zyrtarëve për komunikim dhe marrëdhënie me publikun në MASHT, këtë vit nuk ka pasur asnjë ndërprerje të mësimin jashtë kalendarit të paraparë në fillim të vitit, qoftë për shkak të kushteve atmosferike, qoftë për shkak të ndonjë fatkeqësie, gjë që ka bërë që edhe planprogrami mësimor të zbatohet deri në fund dhe me kohë. Ndërkohë, një nga problemet në të cilat ka hasur arsimit parauniversitar këtë vit, ka qenë çështja e pensionimit të mësimdhënësve brenda vitit shkollor. Ndërkohë, së fundi, Ministria e Arsimit ka nxjerrë një udhëzim administrativ, sipas të cilit të gjithë mësimdhënësit, të cilët e arrijnë moshën e pensionimit brenda vitit shkollor, ta vazhdojnë atë deri në përfundim të atij viti. Kjo, sipas ministrit të arsimit Enver Hoxhaj, është bërë me qëllim që të mos dëmtohet pro-

cesi mësimor, duke pritur procedurat e konkurseve për diçka të tillë.

Provimi përfundimtar

Ndërkohë, një ndër objektivat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, edhe këtë vit ka qenë organizimi i provimit përfundimtar, i cili është organizuar për të tretën herë me radhë për të gjithë nxënësit e shkollave profesionale në vend. Udhëheqësi i divizionit për Vlerësim Standarde dhe Monitorim në MASHT, Mustafë Kadriu, ka thënë se të gjithë nxënësit, të cilët e kanë kaluar klasën e fundit, kanë pasur të drejtën t'i nënshtrohen provimit përfundimtar. Sipas tij, kjo ka qenë edhe procedura që është dashur të përfundohet. Rreth 52% të maturantëve nga numri i përgjithshëm janë nxënës të arsimit profesional. Provimi përfundimtar, sipas Kadriut, ka qenë një përmblyllje e arsimit parauniversitar dhe me atë diplomë, sipas tij, nxënësi e ka përmbushur vetveten, pasi që me atë certifikatë nxënësi ka mundësi të hyjë në tregun e punës. "Duhet të bëjmë një dallim: diploma ka për qëllim hyrjen në universitet, ajo nuk ka për qëllim hyrjen në tregun e punës dhe ata të cilët nuk mendojnë të studiojnë nuk kanë arsye t'i nënshtrohen provimit të maturës shtetërore", - është shprehur Kadriu. Sipas tij, në qoftë se një



kandidat i papërgatitur hyn në universitet dhe nuk e përfundon atë për dhjetë vjet, kjo do t'i kushtonte edhe shoqërisë.

MASHT realizon planin e paraparë

Udhëheqësi i divizionit për Vlerësim Standarde dhe Monitorim në Ministrinë e Arsimit, Mustafë Kadriu, është shprehur se në bazë të planit vjetor të MASHT-it, klasa e dymbëdhjetë, gjegjësisht trembëdhjetë, është lëshuar në pushim më datë trembëdhjetë maj, ndërsa brenda kësaj kohe arsimit profesional, sipas po atij plani, e ka zhvilluar provimin përfundimtar. Nxënësit e shkollave profesionale i janë nënshtruar këtij provimi në formë teorike dhe praktike, ku përveç pyetjeve në test kanë realizuar atë edhe në formë praktike. Udhëheqësi i divizionit për Vlerësim Standarde dhe Monitorim, Mustafë Kadriu, ka theksuar se këtë vit MASHT-i ka qenë shumë rigoroz në respektimin e datave rreth paraqitjes së provimit të maturës, si dhe të provimit përfundimtar. Këtë vit, me vendim të Komisionit Qendror Shtetëror të Maturës, gjatë mbajtjes së provimit të maturës, në çdo klasë kanë qenë më së shumti njëzet nxënës. Kjo, sipas Kadriut, është bërë me qëllim që të ketë më pak nxënës në një hapësirë, që ata të kenë kushte më optimale për punë dhe të ketë mundësi për menaxhimin e vërtetë të klasës. "Meqenëse nuk kemi pasur mundësi të sigurojmë salla të mëdha në disa shkolla, ne kemi marrë vendim që matura të realizohet në klasë", - është shprehur Kadriu.

Laramani e testeve për maturë

Për provimin e maturës shtetërore 2010, MASHT-i ka përgatitur tetë lloje testesh. Mustafë Kadriu ka theksuar se këtë vit ka pasur edhe disa ndryshime

në testet e maturës, kryesisht në fushën e matematikës, me qëllim të zhvillimit të proceseve në këtë drejtim. "Shumëllojshmëria e testeve ka qenë edhe kërkesë e një numri të mësimdhënësve në takimet që i kemi pasur me ta dhe jemi munduar që, në një masë, sa na lejojnë mundësitë, t'i aprovojmë ato", - ka shtuar Kadriu. Sipas tij, kjo ka bërë pastaj që provimi shtetëror i maturës të përmbajë shumë lloje testesh për drejtime të ndryshme. Ky është viti i tretë që MASHT është duke bërë maturë dhe sipas Kadriut, çka është më e rëndësishmja, matura ka marrë filozofinë e vet. Sipas tij, kjo është me shumë rëndësi për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ngase matura, që ka qenë e një natyre krejt ndryshe, është një sensibilizim, është një përkushtim edhe i mësimdhënësve edhe i nxënësve.

Mbi 27 mijë maturantë

Këtë vit, provimit shtetëror të maturës i ishin nënshtruar më shumë se njëzet e shtatë mijë maturantë, në rreth njëqind qendra testimi. Çdo qendër testimi ka përfshirë tre anëtarë të komisionit, drejtorin e shkollës, një anëtar nga MASHT-i dhe një anëtar nga komuna përkatëse. Këtë vit, pjesëmarrës në provimin e maturës kanë qenë edhe inspektorët, të cilët kanë qenë në cilësinë e monitoruesit. Provimi kishte filluar si zakonisht në orën dhjetë të mëngjesit, me përjashtim të ndonjë qendre ku ka pasur ndonjë pengesë, kohë e cila është kompensuar më pas, ndërsa provimi ka zgjatur njëqind minuta gjithsej. Sipas kalendarit shkollor këtë vit, më datë trembëdhjetë maj

Kalueshmëri e kenaqshme në maturë

Në bazë të rezultateve të publikuara nga

Komisioni Qendror Shtetëror i Maturës, Provimin e Maturës Shtetërore 2010, në nivel të vendit e kanë kaluar 64% e maturantëve. Mirëpo, rezultatet janë publikuar për vetëm njëzet e pesëmijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre maturantë nga njëzet e gjashtëmijë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë maturantë sa i janë nënshtruar këtij provimit më 5 qershor. Kjo për arsye se në tri qendra të testimit rezultatet janë pezulluar përkohësisht për shkak të disa dyshimeve për keqpërdorim të detyrës zyrtare nga ana e administruesve, vëzhguesve dhe vetë maturantëve. Pezullimi i rezultateve të maturës është bërë për qendrën numër katër në komunën e Gjilanit, qendrën numër dy në komunën e Deçanit dhe qendrën numër tre në komunën e Podujevës. Rezultatet për këto qendra pritet të publikohen në fund të muajit qershor.

ka përfunduar mësimi për klasat dymbëdhjetë dhe trembëdhjetë, pra, për maturantët. Më tre qershor ka përfunduar mësimi për klasat e nënta, dhjeta dhe njëmbëdhjeta, më tetëmbëdhjetë qershor ka përfunduar mësimi për klasat një deri tetë, duke përfshirë edhe parashkollorët, ndërsa testi i arritshmërisë për klasat e nënta do të mbahet më datën njëzet e nëntë qershor.

MASHT në përfundim të planit veror

Ministria e Arsimit tani është në përfundim e sipër të nxjerrjes së planit hartues deri në fillim të vitit të ri shkollor. Deri më tani janë përcaktuar datat për riprovimet e nxënësve, datat kur lirohen dhe kur ka riprovime për të gjitha nivelet. Deri më pesëmbëdhjetë korrik duhet të përfundojë afati i qershorit edhe me nxënësit e testit të arritshmërisë, edhe me ata të provimit të maturës. Është hartuar edhe plani për afatin e gushtit, i cili fillon diku me tetëmbëdhjetë të këtij muaji, ku janë të përcaktuara datat, të cilat janë përcaktuar edhe për afatin e gushtit. ■



Suksesi i dobët i nxënësve rezulton edhe në testin e maturës

Abdurrahim MAXHUNI

Testi i maturës është vlerësimi përfundimtar që iu bëhet nxënësve të shkollave të mesme dhe i atyre të filltores, si matës i diturisë së tyre. Megjithatë, përkundër tërë atyre viteve të shkollimit të mesëm dhe atij fillor, rezultatet përfundimtare nuk janë aspak të kënaqshme.

Nuk do të ishte aspak paradoksale nëse në publikimin përfundimtar të rezultateve do të shihnim shumë nxënës të cilësuar si të shkëlqyeshëm që nuk e kanë kaluar testin kombëtar të maturës, e në anën tjetër do të shihnim shumë nxënës të cilësuar si të dobët që ta kalonin provimin. Kjo për faktin se tashmë jemi mësuar me një ironi të tillë. E tërë kjo na sjell në një situatë të tillë ku pyetja se çka po ngjet me këtë sistemin arsimor është e pashmangshme.

Rezultate e dobëta nuk dalin në pah vetëm në testin e maturës, por ato po i përcjellin nxënësit gjatë gjithë procesit arsimor. Këto rezultate të dobëta lidhen me shumë faktorë të ndryshëm, duke filluar nga mospërgjegjësia e mësimdhënësve, që në vete përmban mungesën e stimulimit dhe vlerësimin jo të drejtë të nxënësve, e deri te mosinteresimi i nxënësve për mësim të mirëfilltë.

Pa dyshim se mësimdhënësi ka rol të madh në edukimin, arsimimin dhe aftësimin e nxënësve, duke përdorur mënyrat dhe mjetet adekuate, të cilat janë të parashikuara me kurikulumin e

arsimit fillor dhe atij të mesëm. Jetësimi i këtij programi me përpikëri do të sillte rezultate të mira në aftësimin e nxënësve dhe në ndërtimin e një personaliteti të shëndoshë të nxënësit. Mirëpo, rezultatet e dobëta të nxënësve i kanë vendosur në sprovë të madhe ata. Dyshimi tek aftësitë e mësimdhënësve do të ishte i gabuar nëse kemi parasysh përgatitjen e tyre profesionale. Por, qasjen dhe punën e tyre me nxënës do të mund ta quanim të gabuar.

Vlerësimi i mësimdhënësve e ka humbur kriterin e kërkuar dhe kjo ka ndikuar pashmangshëm në kualitetin e dijës së nxënësve, duke e çuar në minimum dallimin nxënës i mirë dhe jo i mirë. Vlerësimi tashmë, në shumicën e rasteve, ka marrë kahe të gabuar, duke i vlerësuar nxënësit në bazë të sjelljes së tyre se “ti ke nejt urtë, katër po ta mbylli” ose “ti s’ke bo zhurmë, tresh e ki”. Sigurisht që kjo është për të ardhur keq, sepse ky lloj vlerësimi krijon një personalitet të rremë të nxënësit, duke ia dhënë atë që nuk e meriton. Dhe përsëri nuk është paradoks kur studenti i vitit të parë i Degës së Gjuhës Shqipe në Universitetin e Prishtinës nuk di ta zgjedhë një folje në një kohë të caktuar ose ta lakojë një emër, edhe pse lënda e gjuhës shqipe ka qenë lëndë kryesore për më se një dekadë.

Edhe nxënësi nuk është “i pajshëm” karshi mësimdhënësve dhe sistemit arsimor në përgjithësi. Ai është zhytur në botën e ëndrrave, duke marrë si modele seritë e shëmtuara televizive,

se asgjë tjetër nuk është me rëndësi më shumë se dashuria. Sjelljet arrogante, neglizhenca ndaj mësimin dhe mosrespektimi i mësimdhënësve janë ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në cilësinë e tyre të dobët.

Të gjithë këta faktorë, në një mënyrë a tjetër, ndikojnë që nxënësit të tregojnë rezultate të dobëta, jo vetëm në testin e maturës e gjatë sistemit në përgjithësi, por edhe në fakultete. Andaj për të pasur një arsimim sa më cilësor e që testi i maturës mos t’ju duket nxënësve asgjë më shumë se sa një relaksim, secili duhet t’i marrë përsipër përgjegjësitë që u takojnë dhe t’i kryejë detyrat me vullnet dhe pa përtuar. Mësimdhënësit duhet të punojnë më shumë me nxënësit, duhet të jenë më të drejtë në vlerësimin e tyre, duke i stimuluar të mirët. Nxënësit duhet të jenë të dëgjueshëm, të mësojnë më tepër, të mendojnë për të ardhmen e tyre, duke treguar suksese të larta në çfarëdo situatë që të jenë. Kurse Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta kryejë edhe ajo detyrën e saj, duke i stimuluar mësimdhënësit me rritje pagash, me beneficione për mësimdhënësit e mirë. Ajo duhet të krijojë ambient të përshtatshëm për mësim, duke ndërtuar shkolla dhe duhet t’i pajisë ato me kabinete të ndryshme profesionale e moderne. Duhet t’i rishikojë tekstet shkollore dhe, nëse janë të papërshtatshme, duhet t’i zëvendësojë ato. Qeveria duhet ta kuptojë rëndësinë e faktit që vendi ynë të ketë arsim sa më cilësor, për të ecur në hap me kohën dhe për të kontribuar në forcimin e shtetit. ■



Dhuna ende prezent në shkollat e Kosovës

Dhuna nëpër shkolla - shqetësuese

“Në shkollën tonë mbajnë armë të ftohta, e ndoshta jo vetëm 15-vjeçarët, por edhe më të rinjtë. Zakonisht mbajnë thika”. “Mbajtja e armës së ftohtë është shenjë që ka për të ndodhur diçka në shkollë. Zakonisht, këta nxënës rrihen mes vete, duan të dalin fitimtarë, prandaj ndodhin therje. Nëse thikën e ka vetëm njëri, pëson ai që s’ka, por nëse e kanë të dy, e pësojnë që të dy”, - thotë nxënësja Mimoza Ymeri.



Baki Kelani - zëdhënës i PK-së



Fatos SHALA

Dhuna dhe huliganizmi në mjediset edukativo-arsimorë në Kosovë, tashmë, është bërë problem shqetësues duke marrë edhe jetë fëmijësh, - vlerësojnë organet e rendit, të cilat thonë se ky problem kërkon qasje urgjente. Policia e Kosovës tashmë është duke u përpjekur që procesi edukativo-arsimor të zhvillohet sa më i sigurt, duke mbajtur ligjërata në shkolla, si dhe përmes metodave të tjera, në mënyrë që të vërehen elementet që e rrezikojnë sigurinë në shkollë. Ndërkaq, Besa Bytyçi, zyrtare për informim në Ministrinë e Arsimit, thotë se nuk janë të rralla shfaqjet e dukurive asociale në shkollat e Kosovës. Por, edhe vetë nxënësit tregojnë që armëmbajtja në shkolla ende është e evidente.

“Në shkollën tonë mbajnë armë të ftohta.”

Mimoza Ymeri, 15-vjeçare, nxënëse e klasës së nëntë, nga Prishtina, thotë se edhe në shkollën ku mëson ajo, kjo dukuri është e pranishme. “Në shkollën tonë mbajnë armë të ftohta, e ndoshta jo vetëm 15-vjeçarët, por edhe më të rinjtë. Zakonisht mbajnë thika”. “Mbajtja e armës së ftohtë është shenjë që ka për të ndodhur diçka në shkollë. Zakonisht,

këta nxënës rrihen mes vete, duan të dalin fitimtarë, prandaj ndodhin therje. Nëse thikën e ka vetëm njëri, pëson ai që s’ka, por nëse e kanë të dy, e pësojnë që të dy”, - thotë nxënësja Mimoza Ymeri. Sipas saj, arsimtarët dhe drejtorja e shkollës, nuk kanë shumë fuqi t’i ndalojnë këto dukuri, për shkak se prindërit e fëmijëve problematikë i përkrahin fëmijët e tyre dhe shpeshherë konfrontohen me stafin e shkollës. “Ata që pësojnë me therje përfundojnë në spital, mbesin pa e vijuar mësimin nga dy muaj, derisa fëmijët huliganë që e kryejnë këtë vepër penale vazhdojnë të vijnë në mësimin”, - shprehet Ymeri. Ndërkaq, Besa Bytyçi, zyrtare për informim në Ministrinë e Arsimit, thotë se nuk janë të rralla shfaqjet e dukurive asociale në shkollat e Kosovës. Kjo dukuri vjen si pasojë e faktorit socio-ekonomik, mungesa e alternativës për të shfrytëzuar kohën e lirë, si dhe shumë faktorë të tjerë. Por, sipas Bytyçit, Ministria e Arsimit është duke punuar në këtë drejtim dhe tashmë është krijuar partneriteti i nevojshëm institucional për zbatimin dhe monitorimin e shkollave, parandalimin i incidenteve dhe sjelljeve asociale, përmirësimin e mësimdhënies dhe reagimin e duhur në rast të aksidenteve. “Ministria e Arsimit i ka vënë vetes si objektiv parësor të bashkëpunojë me faktorë relevantë, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të involvuar në këtë çështje”, - ka thënë Bytyçi. Kurse, zëdhënësi i Policisë së Kosovës, Baki Kelani, ka thënë se janë duke u përgatitur që të

fillojnë me disa ligjërata nëpër shkolla. “Policia e Kosovës tashmë është duke u përpjekur që procesi edukativo-arsimor të zhvillohet sa më i sigurt, duke mbajtur ligjërata në shkolla, si dhe përmes metodave të tjera, në mënyrë që të vërehen elementet që e rrezikojnë sigurinë në shkollë”, - ka thënë Kelani. ■

‘Shkolla - një vend i sigurt’

Besa Bytyçi, zyrtare për informim në Ministrinë e Arsimit

ka thënë se MASHTI dhe Ministria e Punëve të Brendshme kanë hartuar një strategji për siguri në shkollat për periudhën 2009-2019, që e kanë quajtur ‘Shkolla - një vend i sigurt’. Sipas Bytyçit, dokumenti është nënshkruar si memorandum mirëkuptimi nga pesë ministri: Ministria e Brendshme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, si dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Në rast të përlëshjeve do të veprohet me vendosmëri për t’u rritur siguria në shkolla. “Të gjitha institucionet i kanë marrë obligimet e veta. Po ashtu, Ministria e Arsimit ka bashkëpunim të mirë edhe me Policinë e Kosovës”, - theksoi Bytyçi. Sidoqoftë, sipas organeve të rendit, çështja e fëmijëve që kryejnë vepra penale është e rregulluar me ligj dhe, varësisht nga pesha e krimit, jepet dënimi.

Frymë e re në UP

Në fund të vitit akademik, menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës shprehet i kënaqur me ecurinë e këtij viti, sa i përket suksesit të përgjithshëm. Megjithëse nuk e mohojnë faktin që ka qenë një vit i mundimshëm, i cili është përcjellë edhe me ndonjë parregullsi, ata përmendin disa nga zhvillimet, të cilat, sipas udhëheqësve të UP-së, kanë sjellë një frymë të re në universitet. Mirëpo, për punën e profesorëve gjatë një viti, një vlerësim e kanë edhe studentët, atyre të cilëve u është dedikuar kjo punë. E këta të fundit, kryesisht, janë shprehur të kënaqur me mbarëvajtjen e ligjëratave, mirëpo kanë vlerësim jo të mirë sa i përket punës praktike.

Menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës e vlerëson si të suksesshëm vitin akademik 2009/2010. Drejtues të universitetit përmendin disa nga shumë punët që, sipas tyre, i kanë bërë për ngritjen e cilësisë në mësimdhënie, për zhvillimin e shkencës dhe punëve kërkimore etj. Prorektori për Mësim dhe Shkencë në UP, Bajram Berisha, ka thënë se edhe përkundër faktit që ka pasur probleme e pakënaqësi gjatë kësaj kohe, viti mund të cilësohet i suksesshëm. “Përkundër problemeve që ne kemi pasur kohë pas kohe me organizimin e mësimit, për arsye se siç e dini në fillim të vitit ne i kishim zgjedhjet në nivel lokal dhe një pjesë e madhe e stafit akademik ishin angazhuar në ato zgjedhje dhe u humb një pjesë e kohës së domosdoshme të mësimdhënies, megjithatë ky vit mund të cilësohet i suksesshëm”, - është shprehur prorektori Berisha. Ai ka theksuar se menaxhmenti i UP-së është përpjekur që koha e humbur të kompensohet, duke u shtyrë ligjëratat për kohë të mëvonshme, si rezultat i së cilës, sipas prorektorit Berisha, edhe sot e kësaj dite në disa fakultete vazhdon mësimi. “Në disa fakultete, edhe përkundër faktit

se zyrtarisht ka përfunduar semestri, mësimi ende vazhdon”, - shtoi ai.

Vëzhgime rreth mbajtjes së ligjëratave

Nërkohë, një gjë me rëndësi në Universitetin e Prishtinës, sipas prorektorit për Mësim në UP, Bajram Berisha, kanë qenë edhe vizitat periodike nëpër fakultete për të kontrolluar mbarëvajtjen e mësimit. Sipas tij, gjatë këtyre vizitave, përveç vëzhgimit të punës në mësimdhënie, profesorëve u është bërë e ditur disa herë që mbajtja e mësimit është e shenjtë në universitet. Megjithatë, prorektori Berisha, nuk e përjashton mundësinë që në ndonjë fakultet ka pasur lëshime në mbajtje të mësimit, por sipas tij, në përgjithësi mësimi është zhvilluar me rregull. “Jemi të vetëdijshëm që kohë pas kohe ka pasur ngecje, por mendoj që “suma sumarum” ka qenë një vit i suksesshëm në procesin e mësimdhënies”, - është shprehur Berisha. Ai ka përmendur se gjatë këtij viti akademik, për herë të parë në UP, në mënyrë zyrtare është ndarë një fond i veçantë për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe përmirësimin e cilësisë në kërkime shkencore. Në Universitetin e Prishtinës, gjatë këtij viti, kanë qenë të hapura edhe dy konkurse për një gjë të tillë, ku të gjithë për profesorët, të cilët

kanë dashur të avancohen në mësimdhënie si dhe me përvoja të reja të studimit në ndonjë universitet jashtë vendit, UP u ka siguruar të gjitha kushtet për trajnime dhe përfitimim e njohurive të ndryshme nga universitetet evropiane. Kjo, sipas prorektorit Berisha, ka ndodhur për arsye se është marrë vendim që përzgjedhja e profesorëve të sillet në nivel të ri, në një nivel tjetër kualitativ. Megjithatë, prorektori për mësim në UP, Bajram Berisha, ka thënë se e rëndësishme ka qenë ndarja e një pjese të buxhetit të UP-së, e cila është bërë për herë të parë për përmirësimin e kërkimeve shkencore dhe mësimdhënien në Universitetin e Prishtinës.

Projekte për arritjen e suksesit

Zyrtarët udhëheqës të Universitetit të Prishtinës, gjatë këtij viti, kanë hartuar një program të gjerë sa i përket përmirësimit të cilësisë në mësim, i cili fillon me infrastrukturën në universitet. Prorektori Bajram Berisha është shprehur se UP ua ka bërë me dije njësitë akademike që për vitin e ardhshëm akademik të tregojnë me shkrim nevojat e tyre konkrete për fakultet, në kuptimin e përmirësimit të cilësisë së objekteve, sallave të leximit, bibliotekave, laboratorëve dhe vendeve ku kryhet praktika. “Do të



presim nga ta që të vijmë me ide të reja rreth teknikave të reja të mësimdhënies në kuptimin e përdorimit të teknikave të caktuara për mësimdhënie, të projektorëve të ndryshëm, që do të jetë pjesë e cila do të kërkohet në buxhetin e vitit të ardhshëm”, - ka theksuar prorektori.

Puna praktike – shqetësuese

Ndërkohë, sa i përket zhvillimit të punëve praktike në Universitetin e Prishtinës, studentët nuk janë të kënaqur, edhe pse menaxhmenti i UP-së një gjë të tillë nuk e sheh shqetësuese. Zyrtarët e UP-së kanë deklaruar se ekzistojnë fakultete të ndryshme, të cilat e kanë obligative praktikën profesionale në kuadër të planprogramit ose jashtë departamenteve të tyre, gjë që sipas prorektorit për mësim, Bajram Berisha, aty ku ka qenë obligim i universitetit, kryesisht, është zhvilluar. Mirëpo ai ka shtuar se në disa fakultete ekziston përvoja që praktika të mbahet nëpër organizata të ndryshme, me çka është marrë qendra për zhvillimin e karrierës, e cila deri më tani është quajtur LINK e që ka për obligim që të bëjë ndërmjetësimin e studentëve nëpër organizata të ndryshme me të cilat UP ka marrëveshje që studentët mund të kryejnë praktikën e tyre profesionale. Mirëpo, edhe pse UP ka disa marrëveshje me institucione të ndryshme publike dhe private në Kosovë që studentët të kryejnë punën praktike në to, UP nuk ka ndonjë numër të saktë sa i përket përfshirjes së studentëve në këto vende pune. Mirëpo, zyrtarët e



UP-së shprehen se nuk kanë pranuar ndonjë ankesë të studentëve lidhur me pakënaqësinë e tyre rreth punës praktike.

Më 1 tetor UP-së i shtohet një hapësirë dukshëm e madhe

Që nga 1 tetori i këtij viti, Universitetit të Prishtinës pritet t'i shtohet një pjesë mjaft e madhe hapësinore. Kjo pasi që UP, këtë vit, ka rikthyer objektin, që i ishte dhënë Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) në shfrytëzim pas luftës. Po ashtu, më 1 tetor, pritet të fillojë funksionari edhe objekti i ri i Fakultetit të Edukimit, i cili përfshin një hapësirë mjaft të madhe për studim. Ndërsa, UP tani është në procesin e rivlerësimit ose rimatjes së hapësirave objektive nga një ekip, i cili është angazhuar për një gjë të tillë.

Studentët e pakënaqur me suksesin

Mirëpo, studentët e anketuar nuk kanë ndonjë vlerësim të mirë sa i përket cilësisë së studimeve në Universitet të Prishtinës. Adelina Komani, studente e vitit të parë në Fakultetin e Arkitekturës, vitin e parë të studimeve thotë se e ka përfunduar mirë. Ajo ka thënë se deridiku është e kënaqur me suksesin e arritur gjatë këtij viti. Ajo, po ashtu, thekson se në fakultetin ku studion, nuk mun-





gojnë kushtet për punë, duke shtuar se kush angazhohet mund të arrijë sukses të mirë. Adelina ka theksuar se ka dhënë edhe disa provime, për të cilat mendon se është përgatitur mjaft, duke u shprehur e bindur në arritjen e suksesit për këtë vit. Mirëpo, jo të gjithë studentët kanë mendim të njëjtë me Adelinën. Kolegia e saj, Minushë Gashi, e cila po ashtu e ka përfunduar vitin e parë në Fakultetin Ekonomik, në degën Banka Financa dhe Kontabilitet, ka thënë se e ka pasur shumë të vështirë studimin në fillimin e vitit. Ajo ka thënë se me gjithë mbajtjen me rregull të ligjëratave nga profesorët, mbajtja e ligjëratave me një numër aq të madh studentësh ka qenë pak cilësore. Minushja, megjithatë shprehet e kënaqur me suksesin e arritur për një vit. Ajo është shprehur se, për të dëgjuar një ligjëratë, çdo herë është dashur të shkohet në fakultet së paku dy orë para kohe, në mënyrë që të mund të futesh në sallë. Sipas Minushes, në fakultet është zbatuar plani duke përfshirë edhe mbajtjen e punimeve dhe testeve të ndryshme.

Juristët – me sukses relativisht të mirë

Ndërkohë, Shqipërim Jashari, student i vitit të tretë në Fakultetin juridik në UP, është shprehur relativisht i kënaqur me cilësinë e studimeve gjatë këtij viti akademik, duke thënë se ka mundur të jetë edhe më mirë. Sipas tij, ka pasur disa herë shtyrje të provimeve, gjë që ka shkaktuar tollovi, e cila sipas tij ka mundur të mos ndodhte. Edhe Shqipërimi është i kënaqur deri-diku me mbajtjen e ligjëratave, mirëpo ai është i pakënaqur me mbajtjen e punës praktike. Sipas tij, studentët në Fakultet Juridik e përfundojnë fakultetin dhe nuk shohin asnjë seancë gjyqësore ose diçka të tillë, që gjë sipas Shqipërimit është mangësi e madhe. Mendim të njëjtë ka edhe shoku i Shqipërimit, Labinot Baraliu. Sipas Labinotit, i cili ka përfunduar ligjëratat e vitit të dytë të Fakultetit Juridik, në përgjithësi, viti ka kaluar mirë sa i përket punës së tij, por ai ka thënë se nuk është i kënaqur me kushtet që ofron fakulteti. Labinoti ka thënë se është shumë i pakënaqur me punën praktike. Sipas tij, për dy vjet në fakultet nuk ka qenë asnjëherë në punë praktike, ndërkohë që ka shtuar se në shkollën e mesme e ka bërë një gjë të tillë.

UP – në gjendje jo të mirë – sipas Vetëvendosjes

Në fund të vitit akademik, me një raport rreth mbajtjes së orëve mësimore në Universitetin e Prishtinës ka dalë edhe Lëvizja Vetëvendosje. Qendra Studim, Kritikë, Veprim e kësaj lëvizjeje, ka bërë monitorimin e orëve mësimore në fakultetin juridik, ekonomik dhe filozofik, duke filluar nga data 4 maj 2010 dhe duke mbaruar në fund të këtij muaji. Sipas tyre, gjatë kësaj kohe janë vërejtur parregullsi të mëdha brenda këtyre fakulteteve. “Profesorët e Universitetit të Prishtinës nuk i respektojnë në masë të madhe oraret zyrtare, nuk i respektojnë kontratat e tyre të punës për të cilën marrin një pagë deri në tre herë mbi mesataren e pagës në Kosovë, të cilën ata e marrin nga fondet publike që

mbushen nga qytetarët e Kosovës dhe nga studentët e Universitetit të Prishtinës. Duke mos qenë në shërbim të studentëve, për çka janë të obliguar, ata po e dëmtojnë cilësinë e arsimit të lartë dhe studimin universitar”, - thuhet në raportin e nxjerrë nga Vetëvendosja.

Muaji i provimeve

Në të gjitha njësitë akademike në Universitetin e Prishtinës, tashmë, ka filluar edhe mbajtja e provimeve semestrale, afat ky i cili vazhdon deri në fund të muajit qershor. Në Universitetin e vetëm publik, atë të Prishtinës, në vitin akademik 2009/2010, studimet i kanë vijuar afër dyzet mijë studentë, duke e përfshirë nivelin bachelor, master dhe atë të doktoratës. UP, aktualisht, numëron rreth njëmijë të punësuar në procesin e mësimdhënies, prej të cilëve rreth 40% punojnë si asistentë, të cilët në vitet e ardhshme pritet që të angazhohen si staf i ri me emërtimin profesor, si dhe rreth gjashtëqind profesorë gjithsej. ■

Përgatiti: D.V



Tribunë e organizuar me rastin e mbarimit të vitit akademik 2009-2010

Studentët - nismëtarë



Osman D. GASHI

Në një atmosferë të këndshme dhe në një pjesëmarrje shumë të madhe, në sallën 1 Tetori në Prishtinë, më dy qershor, u mbajt një tribunë me rastin e përfundimit të vitit akademik 2009-2010, që u organizua nga O.J.Q. "Edukata" e Drenasit. Në këtë tribunë, në rolin e ligjëruesve, artistëve e folësve, morën pjesë shumë personalitete nga bota akademike, politike, kulturore dhe fetare.

Përfundimi i vitit akademik ishte shkaktar që mblodhi emra të tillë si: profesorët Milazim Krasniqi e Fadil Maloku, deputetët e Kuvendit të Kosovës Naser Rugova e Ibrahim Makolli. Po ashtu mori pjesë edhe hoxhë Shefqet Krasniqi, regjisori dhe aktori i mirënjohur Adem Mikullovc, si edhe këngëtarët Adem Ramadani, Ferki Shala dhe Fidush Aliu. Pjesëmarrësit i përshëndetën me disa fjalë rasti edhe këngëtarin Agim Gërguri i grupit "Fisnikët" dhe dy solistët e grupit "Aurora", Nazmi Sfishta e Ylli Valla.



Milazim Krasniqi

Pas hapjes së këtij takimi me recitimin e disa ajeteve të Kur'anit dhe këndimit të një ilahije nga Adem Ramadani, të pranishmëve iu drejtua prof. dr. Milazim Krasniqi, i cili foli për rëndësinë e diturisë. Ai tha se ajo duhet të jetë në shërbim të së vërtetës në mënyrë që kësaj të ndërgjegjësohet shoqëria jonë, e cila është e re dhe është shoqëria e vendit më të ri në botë. Ndër të tjera, profesor Krasniqi i porositi të pranish-

mit se: "të pajisurit me dije të bën që të ndërgjegjësohesh me një fakt themelor, se dituria është fuqi, është zhvillim dhe shoqëria jonë ka nevojë shumë për këtë gjë, pasi ajo është një shoqëri e re, një shoqëri me probleme të mëdha, të cilat mund të zgjidhen vetëm nëse njerëzit e ditur dhe njerëzit e ndershëm angazhohen për ndryshime pozitive në të. Andaj, tërë dituria që është fituar në këtë vit akademik do të duhej të transmetohej te familjet tuaja". Gjithashtu, ai bëri me dije se studentët janë bartës të proceseve dhe të ndryshimeve të rëndësishme të shoqërisë sonë dhe se ata duhet të vazhdojnë edhe më tutje të pajisen me dituri dhe ta transmetojnë atë te të tjerët. "Shoqëria jonë po kalon nëpër situata të vështira, të përcjella me gjëra të këqija, kriza të ndryshme e fatkeqësi, prandaj, studentët janë ata të cilët duhet të jenë bartës të ndryshimeve dhe të ndërgjegjësimin për këto gjëra. Jam



Naser Rugova

shumë i bindur që studentët do të jenë edhe më të përkushtuar për fitimin e diturisë, në mënyrë që të jenë të dobishëm për familjet e tyre dhe shoqërinë në përgjithësi," - shtoi në fund Krasniqi.

Rugova: Politika – përcaktuese e kornizave të zhvillimit

Ndërkaq, deputeti i Kuvendit të Kosovës dhe njëherësh nënkryetari i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Dardanisë (LDD), dr. Naser Rugova, për pjesëmarrësit, të cilët ishin në numër shumë të madh që i kalonte 3000 vetë, tha se ky numër kaq i madh i të pranishmëve në këtë organizim tregon se shoqëria jonë ende ka vlera. Ai, pasi kujtoi përgjegjësinë që kemi të gjithë për vendin tonë që mos ta lëmë në udhëkryq, rikujtoi se e drejta e përfitimit të dijes dhe besimit është e pamohueshme, përkundër faktit se politika cakton kornizat të ndryshme. "Jemi një shtet i ri, i cili ndodhet në udhëkryq, andaj për komb, fe e atdhe, kemi përgjegjësi që të gjithë. Politika shpeshherë po i cakton kornizat e zhvillimit shoqëror e kombëtar, po ndikon edhe në lirinë e besimit, po besa edhe në lirinë e shprehjes, por ne duhet të bëjmë përpjekje t'i anashkalojmë ato dhe të bëjmë një progres në të mirë të vendit tonë", - shtoi ndër të tjera deputeti Rugova. "Jemi shoqëri e lirë, kemi drejtë të besojmë lirshëm



dhe bartës të proceseve



Fadil Maloku

në Zot, kemi të drejtë ta themi identitetin tonë dhe të vërtetën,” - tha në fund nënkryetari i LDD-së, Naser Rugova.

Kurse, profesori i sociologjisë së globalizmit prof. dr. Fadil Maloku, vuri në pah ndryshimin dhe procesin e tranzicionit që po kalon shoqëria jonë dhe, përkundër këtij fakti, ai tha se ka indikacione që shoqëria jonë është duke ecur në rrugë të mbarë. “Prezenca juaj më jep një indikacion dhe dëshmon se ju, si studentë, jo vetëm që merreni me shkencë, por keni edhe një petk fetar, i cili është si mburojë morale për ju, e që është një protektor pa marrë parasysh deformimet dhe sjelljet devijante në shoqëri,” - tha ndër të tjera profesor Maloku.



Ibrahim Makolli

Studentët kanë qenë historikisht bartës dhe nismëtarë të proceseve

Të pranishmëve iu drejtua me një ligjëratë të shkurtër edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës dhe nënkryetar i Aleancës Kosova e Re (AKR), Ibrahim Makolli, i cili u shpreh se është një gëzim dhe një festë e madhe kur një familjeje dhe shoqërisë sonë i shtohet një njeri i arsimuar dhe njëherësh studentët jo vetëm se duhet të jenë bartës të proceseve por edhe të jenë nismëtarë

të tyre, ashtu siç kanë qenë gjithmonë në të kaluarën tonë. “Nuk ka festë më të madhe, nuk ka gëzim më të madh, nuk ka kënaqësi më të madhe edhe për një familje, edhe për një komb, se sa kur numrit të të arsimuarve, të të shkolluarve iu shtohen gjeneratat e reja. Studentët kanë qenë historikisht jo vetëm bartës të proceseve shumë të rëndësishme kombëtare, por kanë qenë nismëtarë të këtyre proceseve edhe në vitin 1968, edhe në '81-tën, edhe në vitin 1989, edhe në vitin 1997, dhe besoj shumë që studentët tani, në rrethana të tjera, do të jenë nismëtarë të proceseve për zhvillimin e vendit,” - tha në fjalimin e tij deputeti Makolli.

Ndërkaq, në ligjërimin e fundit, dr. Shefqet Krasniqi, hoxhë dhe ligjërues në Xhaminë e Llapit, tha se kjo natë është e madhërishtme dhe e bekuar, me tërë prezencën që ishte në sallën 1 Tetori në Prishtinë. Ai foli për rëndësinë dhe rolin e dijes. Sipas tij, ata që bartin në veten e tyre diturinë e mirëfilltë janë të privilegjuar dhe të ngritur lart. Dr. Krasniqi theksoi: “Jemi afër fundit të vitit akademik dhe studentët kanë qëndruar gjatë tërë vitit mbi librat e tyre shkollore, duke bërë përpjekje për të marrë dije dhe shkencë, ashtu që të shkojnë përpara. Njerëzit e ditur janë të privilegjuar nga çdo krijesë. Njeriu me dije bëri shumë në këtë tokë, e njohu Zotin e tij, shfrytëzoi shumë të mira nga kjo tokë. Dija është një gjë që edhe shejtani ia pati zili njeriut dhe shejtani nuk urren askënd më shumë se dijetarët. Andaj, njerëzit më të privilegjuar dhe të ngritur lart janë të diturit.”

Rrjedha e takimit vazhdoi me ilahi, fjalë përshëndetëse e me monologë nga



artistë të shumtë që ishin të ftuar në këtë organizim. ■



Shefqet Krasniqi



Në kuadër të këtij takimi u fol edhe për çështjen e qasjes së Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës (MASHT) dhe Kuvendit Komunal të Prishtinës ndaj veshjes së femrave të besimit islam, ku është propozuar një udhëzim administrativ përmes të cilit ndalohet përdorimi i mbulesës islame te femrat nëpër shkolla. Në një fjalim të zjarrtë dr. Shefqet Krasniqi theksoi: “Në Kosovë jetojnë mbi 90% muslimanë dhe mundohen t'i cenohen të drejtat elementare të besimit dhe fesë, kurse të gjitha minoritetet e shoqëritë e tjera në Kosovë i gëzojnë ato. Heqja e mbulesave për femrat muslimane është drejtpërdrejt cenim i lirisë fetare dhe prekje në moral dhe, sipas legjislaturës islame, më lehtë është rrënim i një xhamie sesa prekja në moral. Në shkollat tona, MASHT-i, në vend se të ndalojë shumë dukuri negative si alkooli, droga e prostitucioni, zgjedh të merret me një çështje që realisht nuk i pengon askujt, shaminë, e cila përkundrazi është vlerë dhe ruajtje e moralit të femrës. Në tërë shtetet e Bashkimit Evropian muslimanët janë pakicë, por gëzojnë më shumë liri e të drejta fetare se sa këtu te ne në Kosovë, në vendin e baballarëve e të stërgjyshërve tanë që 600 vite.”

Mosha mesatare e pjesëtarëve të PK-së sillet rreth 40 vjetëve

Efektivat e policisë po plaken

Prej gjithsej 7219 pjesëtarëve me uniformë të Policisë së Kosovës, mosha mesatare e tyre është 40.17 vjet. Sipas analistit të çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, mosha mesatare e preferuar për punë operative është mosha nga 25 deri në 37 vjet. Në anën tjetër, zyrtarë të lartë të PK-së kanë treguar për revistën "Paqja" se është miratuar një parim i ri i brendshëm policor që, në konkurset për pjesëtarët e rinj të PK-së, të ketë kufizime në moshë, gjë që do t'i mundësonte policisë të ketë një staf operativ më profesional dhe më të ri. Sipas tyre, konkurset e reja në polici do të kenë kufizim të moshës aplikative dhe do të mund të aplikojnë vetëm personat nga mosha 18 deri në 30 vjet.



Alban ZENELI

Statistikat për moshën mesatare të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës tregojnë që efektivat e saj janë duke u mplakur. Mosha mesatare e tyre sillet rreth 40 vjetëve, ndërkohë që ekspertët thonë që mosha ideale për punë operative e policisë është nga 25 deri në 37 vjet. Në anën tjetër, zyrtarë të lartë të PK-së kanë treguar për revistën "Paqja" se është miratuar një parim i ri i brendshëm policor që, në konkurset për pjesëtarët e rinj të PK-së, të ketë kufizime në moshë, gjë që do t'i mundësonte policisë të ketë një staf operativ më profesional. Ndhimësdrejtori i përgjithshëm i PK-së për personel, Riza Shillova, ka treguar se në konkurset e ardhme për rekrutimin e pjesëtarëve të rinj të PK-së do të pranohen vetëm personat nga mosha 18 deri në 30 vjeçare. Ai thotë se kjo çështje nuk ka mundur të rregullohet sepse ligji për policinë nuk ka qenë i miratuar në Kuvendin e Kosovës, por pjesëtarët e PK-së janë trajtuar si shërbyes civilë. "Rregullimi i kësaj çështje, se

pari, është adresuar në aspektin ligjor. Në këtë drejtim, aprovimi i ligjit për policinë, gjegjësisht neni i 50-të, i jep të drejtën drejtorit të përgjithshëm që, në koordinim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, të përcaktojë standardin minimal të punësimit ose rekrutimit. Drejtori i përgjithshëm ka nxjerrë një parim të brendshëm, i cili përcakton moshën minimale dhe atë maksimale të inkuadrimit në polici. Me këtë parim të ri, mosha minimale për inkuadrimit në polici është 18 vjet dhe ajo maksimalja është 30 vjet", - ka deklaruar Shillova, duke shtuar se ky kriter i krijon Policisë së Kosovës, në mënyrë automatike, mundësinë për rifreskimin e kuadrit policor. Ndërsa sa i përket mundësisë së hapjes së ndonjë konkursi të ri për pjesëtarë të policisë, Shillova ka thënë se kjo do të varet shumë nga rezultatet e vlerësimit të nevojave të PK-së. "Jemi në fazën e vlerësimit të nevojave të personelit të PK-së. Akoma nuk ka lëvizje në drejtim të hapjes së një konkursi të ri, sepse ne duhet të jemi shumë të saktë në vlerësimet e nevojave të PK-së", - është shprehur ai. Në anën tjetër, eksperti i çështjeve të sigurisë, Ramadan Qehaja, vlerëson se një pjesëtar i policisë duhet të jetë në mes të moshës 25 dhe 37 vjeçe, që të mund t'i kryejë detyrat me efika-

sitet. "Për t'i kryer detyrat e rregullta policore në mbrojtje të kushtetutës dhe ligjit, duke mos përdorur forcën por bindjen e njerëzve, konsideroj që mosha më e mirë është nga 25 vjet deri në 37 vjet", - ka deklaruar Qehaja, duke shtuar se në Policinë e Kosovës është më se e nevojshme të bëhet një riorganizim. Ai ka thënë se riorganizimi do të kuptonte një përtëritje kuadrovike dhe menaxheriale, sepse, sipas tij, PK-ja ka nevojë për këtë.

"Në secilën organizatë të sigurisë duhet të ketë përtëritje maksimale në çdo tri ose katër vite, ndërsa në Policinë e Kosovës kemi një pjesë të strukturës organizative e menaxheriale që nuk është ndërruar që nëntë vite", - është shprehur ai.

Nga gjithsej 7219 pjesëtarë me uniformë të Policisë së Kosovës, mosha mesatare e tyre është 40.17 vjet. Nga ta, 13 pjesëtarë do të mbushin këtë vit moshën 65 vjeçare, ndërkohë që pjesëtarët më të rinj me uniformë të PK-së janë 18 pjesëtarë, të cilët kanë moshë 25 vjeçare. Ndërsa numri më i madh i pjesëtarëve operativë (me uniformë), që kanë nga 35 vjet, është 462 pjesëtarë. Ndërkohë, konkursi i fundit për pjesëtarët me uniformë të PK-së është hapur në mars të vitit 2006. ■



Projekti i ndryshimeve të mëdha

“Kosova e Re” mund të mos ndërtohet

Duhet pasur shumë kujdes që të mos ndryshohen kapacitetet prodhuese të Termocentralit “Kosova e Re”, sepse kështu është duke u luajtur me zjarrin. Ky termocentral do të ketë kapacitete aq të vogla sa që nuk do të mund ta furnizonte vetëm një qytet të Kosovës, sado i madh a i vogël të jetë ai.



Lulzim AHMETI

Ndryshimet e shpeshta, që kur u dha ideja për ndërtimin e një termocentrali të ri, kanë bërë që ky projekt të mos jetë më aq atraktiv për investitorët e huaj. Më 2006 u tha se termocentrali i ri, i cili do të ndërtohet nën emrin “Kosova C”, do të siguronte energji të mjaftueshme për Kosovën, e besa e dhe për të shitur në vendet e rajonit, por kjo nuk ndodhi. Me ndryshimin e qeverisë u ndryshua emri nga “Kosova C” në “Kosova e Re”, si dhe filluan të ndryshojnë edhe kapacitetet prodhuese të termocentralit të “dritës”. Tash “Kosova e Re” u parapa që të ndërtohej me kapacitet 2100 megavat orë energji elektrike, por këto kapacitete filluan të bien dita-ditës për katër vjet me radhë. Trendi i uljes së kapaciteteve s’kishte më të ndalur, gjoja se me kaq shumë nuk do të kemi kompani të fuqishme, të cilat do të konkurronin për ta ndërtuar këtë termocentral. Pas uljes, u tha se do të ndërrohet me 1000 plus 1000 megavat. U hap edhe faza e parakualifikimit. Por çfarë ndodhi? Ajo që pakkush do ta dëshironte:

u larguan dy nga kompanitë gati më të fuqishme në Evropë, sa i përket fushës së energjisë, kompania çeke ÇEZ si dhe ajo gjermane RWE. Asnjëherë nuk u mësuan shkaqet e vërteta të tërheqjes së këtyre kompanive, edhe pse mund të thuhet se procedurat burokratike, si dhe çështja e krimit dhe e korrupsionit, i ka shtyrë këto kompani që të mendojnë për të investuar në këtë fushë në ndonjë vend tjetër, siç është Serbia, e cila ofron kushte shumë më të mira se sa Kosova për të investuar në fushën e energjetikës. Pas ndryshimit të kapaciteteve prodhuese të termocentralit “Kosova e Re”, nga 1000 plus 1000, ato u zvogëluan në 500 megavat orë energji elektrike në fazën e parë dhe 500 të tjerë në një fazë të mëhershme. As pas këtij ndryshimi, kompanitë e fuqishme nuk konkurruan. Qeveria e Kosovës dhe Komiteti Ndërmintor për Ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re” vendosën për ta bërë projektin, pasi që i kishin zvogëluar kapacitetet prodhuese. Ky vendim i Qeverisë së Kosovës është kritikuar dhe vazhdon të kritikohet nga ekspertë të ekonomisë dhe opozita, pasi që në termocentralin “Kosova B” vetëm pas lufte janë investuar 200 milionë euro. Me këtë, sipas tyre, humb vetë Kosova. Ndryshimet e shpeshta dhe çështjet e tjera që u bëhen pengesë investuesve të mundshëm po e

rrezikojnë seriozisht realizimi e këtij projekti madhor, i cili nëse do të ndërtohej në fillim do të ishte një gjë shumë e mirë për ekonominë e vendit dhe zhvillimin e saj. Por nuk u la me kaq. Pas ndryshimeve që po pësonte projekti i termocentralit “Kosova e Re”, i cili dikur ishte me kapacitete tejet të mëdha, tash Komiteti Ndërmintor për Ndërtimin e këtij termocentrali ka thënë se do të ndërtohet vetëm me 600 megavat orë, 300 në fazën e parë dhe 300 në fazën e dytë. Arsyetimi i drejtuesve të projektit “Kosova e Re” është se Banka Botërore e bën sigurimin me kaq megavat e jo më shumë.

Ideja “Kosova e Re”

Për ndërtimin e Termocentralit të ri “Kosova e Re”, Ministria e Energjisë dhe Minierave, në kohën e Et’hem Çekut, e ka marrë foton nga një termocentral në Gjermani, i kompanisë suedeze VATENFALL, e asnjëherë nuk ishte treguar fakti se ishte kopjuar atje. Por, pavarësisht nga kjo, duhet pasur shumë kujdes që të mos ndryshohen kapacitetet prodhuese, sepse kështu është duke u luajtur me zjarrin. “Kosova e Re” do të ketë kapacitete aq të vogla sa që nuk do të mund ta furnizonte vetëm një qytet të Kosovës, sado i madh a i vogël të jetë ai. ■

Ndotja e mjedisit në Kosovë i tejkalon standardet evropiane



Astrit VELIPI

Dita Botërore e Mjedisit - 5 qershori erdhi e shkoi edhe në Kosovë, e cila tashmë i ka mbushur më shumë se dy mote shtet.

Mjedisi, vendi ku po frymon i gjithë globi, tanimë është duke u shpërfillur më shumë se asnjëherë tjetër nga faktori njeri, i cili pikërisht nga moskujdesi për ambientin ka bërë që ai të bëhet një rrezik potencial për të ardhmen njerëzore.

Ndotja e ambientit nga termoelektranet e KEK-ut te ne i tejkalon normat e lejuara ndërkombëtare dhe kjo ndotje jo vetëm që është bërë e rrezikshme, por shumë sëmundje kronike e kancerogjene janë si pasojë e këtyre tymtarëve, prej të cilëve fatkeqësisht ne këtu në Kosovë jemi të varur për furnizimin me energji.

Fenomen tjetër shkatërrues për jetën dhe ambientin në tokë janë edhe mbeturinat që hidhen vend e pa vend, duke e ndotur mjedisin tonë dhe duke u bërë një rrezik potencial për vetë jetën e qytetarëve.

Edhe pse këta të fundit si të themi janë viktimë e dorës së tyre, edhe institucionet përgjegjëse për pastrimin dhe eliminimin e këtyre mbeturinave nuk janë të paktën në nivelin e dëshiruar.



Stacioni për monitorimin e ajrit

Megjithatë, përkundër herëve të tjera, kësaj radhe në Kosovë, Dita Botërore e Mjedisit është përcjellë me disa aktivitete simbolike, me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit për mbrojtjen e ambientit.

Përurohet stacioni për monitorimin e ajrit

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagcilar, ka thënë se problemet e mjedisit në Kosovë janë të shumfishta dhe ato ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. Sipas tij ndotja e ambientit në Kosovë i tejkalon normat e lejuara evropiane.

Pikërisht në këtë ditë në oborrin e Ndërtesës së Re të Qeverisë (ish-Pallati i Medieve), ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagcilar, përuroi Stacionin për Monitorimin e Ajrit dhe Projektin për Grumbullimin e Mbeturinave të Letrës dhe Plastikës.

Prandaj me këtë projekt, tash e tutje, qytetarët do të kenë mundësi që në ekranin e Stacionit t'i lexojnë të dhënat për shkallën e ndotjes së ajrit PM, 2.5 dhe PM.10., kushtet e motit, matjen e metaleve të rënda si dhe parametra të tjerë meteorologjik.

Kjo për faktin ngase stacioni është vendosur në një pikë mjaft frekuentuese të automjeteve.

Ministri i MMPH-së, Mahir Yagcilar, në fjalën e tij ka thënë se dita botërore e Mjedisit është e veçantë dhe shënohet në mbarë botën. Këtë ditë sot po e shënojnë edhe institucionet e nivelit qendror, por edhe ato të nivelit lokal.

Madhështinë e shënimit të kësaj dite e rrisin edhe më shumë dy projektet që sot po i përurojmë. Qytetarët e kryeqendrës së Republikës së Kosovës dhe së shpejti edhe qytetarët e të gjitha qendrave të tjera, do të kenë mundësinë që në çdo çast, përmes ekranit, t'i shohin të dhënat për shkallën e ndotjes, të dhënat për motin, matjen e metaleve të rënda si dhe parametra të tjerë meteorologjik.

Riciklimi i mbeturinave të letrës dhe plastikës

Yagcilar ka bërë të ditur, po ashtu, se pikërisht në Ditën Botërore të Mjedisit ka filluar së implementuari edhe një projekt shumë i rëndësishëm – Riciklimi i Mbeturinave të Letrës dhe Plastikës, projekt ky i cili fillon në institucionet e vendit për t'u zgjeruar shumë shpejt në mbarë vendin tonë.



Riciklimi i mbeturinave të letrës

Sipas ministrit Yagcilar ka shumë çështje mjedisore globale që kanë nevojë për vëmendje urgjente, të tilla si: ndryshimet klimatike, siguria mjedisore etj., të cilat gjithnjë e më shumë po ndikojnë në kërcënimin e planetit tonë, humbjen e biodiversitetit dhe ekzistencën e njerëzimit.

Ndërkaq, në nivelin lokal problemet mjedisore janë edhe më të shumta dhe prekin drejtpërdrejt kualitetin e jetës së njeriut, si trajtimi i ujërave të ndotura, menaxhimi i mbeturinave, ruajtja e kualitetit e ajrit, etj”.

Si do që të jetë, faktori njeri është padyshim miku, por edhe armiku më i madh i mjedisit ku jetojmë.

Mitrovicë: Mbillen 1000 fidanë

Po me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit, edhe në Mitrovicë, me një aksion simbolik të mbjelljes së disa fidanëve pranë shtëpisë së kulturës “Rexhep Mitrovica”, kryetari i Mitrovicës, Avni Kastrati, filloi aksionin për mbjelljen e një mijë fidanëve në këtë qytet.

Ky aksion është përkrahur nga komuna e Mitrovicës dhe UNDP-ja.

Kryetari i Mitrovicës, Avni Kastrati ndër të tjera ka thënë se është një premtime që u kemi dhënë qytetarëve se gjatë periudhës 4-vjeçare në Mitrovicë, secila familje do të ketë nga një fidan të vetin, andaj jemi shumë mirënjohës ndaj UNDP-së, që na ka mbështetur me këtë aktivitet dhe ne do të vazhdojmë.

Ai ka thënë se këta fidanë do të mbillen në shkollë, në rrugë, parqe e vende të tjera, në mënyrë që Mitrovica të jetë një qytet i gjelbëruar.

Kurse përfaqësuesja e UNDP-së, Osnat Lubrani ka thënë se është një ditë shumë e veçantë, pasi shënohet Dita Ndërkombëtare e Ambientit.

“Jam shumë e lumtur që jam këtu sot

me prezencën e kryetarit dhe t'u ofroj qytetarëve të Mitrovicës diçka shumë të qartë dhe konkrete, të mbëltojmë fidanë që e pasurojnë ambientin ku ata jetojnë”, - tha Lubrani.

Ndryshe, aktiviteti për mbjelljen e 1000 fidanëve në Mitrovicë do të përfundojë brenda 18 ditësh, ndërsa projekti i gjelbërimit të qytetit do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme.

Berisha: Qytetarët duhet të vetëdijesohen për ambientin

Qytetarët shprehen të pakënaqur me punën që bëjnë institucionet në mbrojtjen e mjedisit.

Megjithatë ata nuk harrojnë të mbajnë një pjesë të fajit edhe për vete.

“Ministria duhet të marrë masa më konkrete për ruajtjen e ambientit, por edhe qytetarët duhet të vetëdijesohen për mbrojtjen e tij”, - tha Halit Berisha.

Sipas tij është e turpshme, por edhe jo e qytetëruar, t'i shikosh kolegët studentë se si i hedhin mbeturinat kudo, vend e pa vend.

Sipas Halitit, këtë kaos e bën edhe mungesa e zbatimit të ligjeve, që në të shumtën e kohës mbesin vetëm në letër, duke bërë në këtë mënyrë që masat e veprimeve nga qytetarët të kuptohen sikur janë normale.

Është shumë e rëndësishme mbrojtja e ambientit ngase ne si qytetarë zgjohemi pothuaj çdo ditë dhe bashkëveprojmë kudo ku shkojmë me ambientin, natyrën, vendin, parkun, etj.

Dita e Mjedisit

Që prej vitit 1974, Kombet e Bashkuara e kanë shpallur 5 qershorin si Ditën Botërore të Mjedisit.

5 qershori u caktua si Dita Botërore e Mjedisit në vitin 1972, nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-s, me qëllim të ngritjes së ndërgjegjes së publikut për mjedisin.

U zgjodh kjo datë sepse përkon me ditën e hapjes së Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin, që u mbajt në vitin 1972 në Stokholm, nën udhëheqjen e Programit Mjedisor të Kombeve të Bashkuara (UNEP).

Të dhënat e fundit në botë janë alarmante dhe ekspertët tërheqin vërejtjen për ndotjen e ambientit nga zhvillimet industriale, teknologjike, por, edhe nga vetë faktori njeri. ■



Mërgata shqiptare - kultivon vlera fetare dhe kombëtare



Iljasa SALIHU

Nuk është thënë kot se gjërat e rënda vetëm njerëzit e urtë e të mençur mund t'i lehtësojnë. Në të kaluarën e afërt, tema rreth mërgatës shqiptare ishte rrahur dhe prekur, në shoqërimin e vazhdueshëm të vuajtjeve dhe pikëllimeve të mëdha, sepse të qëndrosh i vetëm një vit, a me vite të tëra pa familje, pa shoqëri të rregullt, si dhe pa aktivitete të lira rreth kauzës së vendlindjes dhe fundja rreth vetorganizimit shoqëror të atjeshëm, ishte me të vërtetë më shumë se dhimbje, më shumë se boshllëk i vlerave morale, si edhe ishte më shumë se mbyllje hermetike kundrejt shpirtërores së shëndoshë.

Mërgata shqiptare ishte shndërruar në hamall të vërtetë, për hir të rrjedhave të dhembshme që mbizotëronin në vendlindjen e tyre. Ata ishin më nostalgjikë. Përgjithësisht ishin më të hutuar për ngjarjet në vend, ngase in-

formacionet i merrnin prej duarve të ndryshme, duke mos u informuar pothuajse asnjëherë si duhet për gjendjen reale në vendin e tyre të lindjes. Këtë mjegull dhe boshllëk të informacioneve, e kishte ndihmuar dukshëm sigurimi i atëhershëm jugosllav, ku bijtë shqiptarë, të cilët kishin arritur të dilnin prej kthetrave të frikës, sigurimi në fjalë disa i kishte internuar, disa i kishte përndjekur në vazhdimësi, kurse disa të tjerë i kishte likuiduar në format më mizore të mundshme. Nga kjo mund të aludojmë se mërgata shqiptare në mënyrë permanente kishte punuar në Perëndim e gjetkë, por mendjen e kishte pasur tërësisht në vendlindje. Kësi lloj përditshmërisht me të vërtetë ishin të rënda, por falë vullnetit të fortë ia dolën mban edhe këtyre proceseve tejet të vështira. Sot Kosova është bërë shtet. Shqiptarët që dikur mësonin nëpër podrumet të errëta, sot, fatmirësisht, po mësojnë në kushte normale, meritë kjo tejet e madhe edhe e mërgatës shqiptare.

Kohërat ndryshuan dhe, fatmirësisht, dielli filloi t'i ngrohë edhe shqiptarët që gjenden në të katër anët e botës. Duke e parë se gjendja në vendin tonë

po përmirësohet nga ditë në ditë (e kemi fjalën, duke e krahasuar me gjendjen e atëhershme), tanimë mërgata shqiptare ka filluar të mendojë edhe për vetorganizimin e atjeshëm, duke e pranuar si gjë normale vazhdimin dhe zhvillimin e jetës atje, pra, tashmë, duke e ndierë si “vendlindje të dytë kurbetin”.

Duke qenë e vetëdijshme për sfidat e kulturës shqiptare kundrejt kulturave të tjera, në mënyrë emergjente, mërgata shqiptare e kishte kanalizuar aktivitetin e vet tashmë atje, duke hapur shoqata shqiptare kulturore dhe artistike, qëllimi i së cilave ishte ruajtja dhe kultivimi i vlerave të mirëfillta shqiptare në mërgim. Ajo që i kishte gëzuar pa masë prindërit, dhe pa dyshim neve kënde, ishte organizimi i mirëfillt i jetës fetare atje. Në kohën kur prindërit i kishte kapluar derti i fëmijëve për devijimet e mundshme, kishte dashur Zoti që në vend se një i ri bashkë me prindin e tij ta prisnin mesnatën në ndonjë diskotekë, në vend të kësaj ligësie, prindërit bashkë me fëmijët po e prisnin mesnatën në xhami, duke ndarë derte të ndryshme që i përkisnin jetës së përditshme dhe duke u pajisur me dituri tejet të dobishme rreth Islamit.

Pas namazit të akshamit, i gjithë xhemati po tuboheshin në kuzhinën e xhamisë, ku deri në kohën jaxisë po diskutonin tema të ndryshme. Kishin filluar ta përvetësonin së tepërmi edhe gjuhën shqipe, sepse ligjëratat, bisedat, leximi dhe zhvillimet e ndryshme po bëheshin në gjuhën shqipe.

Në Augsburg, një qytet në jug-perëndim të Bavarisë, në Gjermani, gjatë këtij viti (2010) komuniteti shqiptar, për herë të parë në historinë e këtij qyteti të lashtë, kishte hapur një xhami. Para se të bëhej hapja e kësaj xhamie, shqiptarët i kishin kryer ritualet e tyre fetare nëpër xhamitë e komunitetit turk dhe boshnjak, duke qenë kështu të privuar nga plotësimi e pjesës tjetër shpirtërore. Shqiptarët e të gjitha trevave që po jetonin në këtë qytet të lashtë e historik, në vitin 2006 e kishin themeluar një shoqatë shqiptare, edhe pse ideja kishte qenë që paralelisht të bënin edhe hapjen e një xhamie. Por themeluesit dhe ideatorët e këtyre objekteve e kishin parë të arsyeshme, duke u konsultuar me sistemin ligjor të shtetit gjerman, që fillimisht të bënin hapjen e shoqatës “Atdheu” për të arritur kështu deri tek inaugurimi i një xhamie, ku pjesa dërmuese e të rinjve dhe të moshuarve kishin gjet prehe në të.

Kryetari i shoqatës dhe njëherësh i xhamisë me seli në Augsburg ishte Bashkim Dalipi, kurse imam Nexhat Bonjaku. Zëvendëskryetari, z. Nysret Menxhiqi, për revistën “Paqja” mes të tjerash u shpreh: “Brenda xhamisë mudohe mi t’i kryejmë aktivitetet, të cilat kryesisht janë fetare, pra, mësimin e leximit të Kur’anit, furnizimin e bibliotekës brenda në xhami, gjë për të cilën një falënderim i veçantë shkon për Ferid Aganin, Husamedin Abazin - shtëpinë botuese Logos, Fatos Gërvalën dhe për disa dashamirë të librit që e ndihmuan begatimin e bibliotekës me



tituj në gjuhën shqipe. Më pas mudohe mi të gjejmë kohë dhe hapësirë për të biseduar dhe projektuar diçka rreth aktivitetit të mëtutjeshëm të xhamisë dhe përditshmërive të tjera të zakonit” - tha Menxhiqi. Ndërsa Zylfi Dullovi, në lidhje me funksionimin paralel të shoqatës dhe xhamisë, tha: “Edhe njëra, edhe tjetra funksionojë shumë mirë. Veçanërisht, në rastin tonë konkret, bashkimi i këtyre dy oazave është më tepër se i shkëlqyeshëm, ku anëtarët e njëjës janë automatikisht edhe anëtarë të tjetres”, - tha Dullovi. Në këtë xhami ishte shtuar në përmasa të mëdha edhe etja për mësimin e fesë islame. Nexhmedin Hamdiu u shpreh: “Kemi nevojë edhe për tituj të tjerë në gjuhën shqipe. Besoj që këtë do e kenë parasysht bashkatdhetarët tanë atje, sepse është nder i madh që, duke mos frekuentuar biblioteka të shumta, të mund të pajisesh me literaturë që të intereson edhe në xhami. Dikur këtë objekt, të mbushur përplot begati, e shikonim vetëm si objekt ku kryhej namazi dhe asgjë tjetër” - tha Hamdiu. Në lidhje me funksionimin juridik të kësaj xhamie, sekretari z. Hamit Alili u shpreh: “Xhamia është e regjistruar në komunë si objekt fetar islam dhe çdo





gjë që kryhet brenda dhe jashtë xhamisë realizohet në suaza ligjore”.

Për ta përmbyllur rrugëtimin tonë tejet mbresëlënës, ishim edhe në xhaminë e Mannheimit (Manhajmit), ku morëm prononcim vetëm prej kryetarit të kësaj xhamie, Muhamed Damati. “Rrethanat përmes dinamizmit prej të cilave përshkohet populli shqiptar, problemet me të cilat ballafaqohet, dukuritë e reja dhe të vjetra ideologjike prej të cilave bie mirëqenia e tërësisë së kombit, fërkimet filozofike e kulturore mes Lindjes e Perëndimit, paragjykimet ndaj trashëgimisë fetare dhe një varg i pambarim hallesh, e bëjnë ende më të ndërlikuar situatën tonë dhe, si pasojë, u shfaq nevoja për gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme që t’u dilet në mbrojtje pasurive tona të trashëgimisë kulturore, të cilën stërgjyshërit tanë e bartën me xhelozë përmes përvojave shekullore të këtij populli të vogël.

Të rinjtë shqiptarë të Mannheimit, duke pasur parasysh rrethanat në të cilat jeton mërgata jonë në Gjermani dhe rreziqet nga asimilimi, rrezik ky i cili iu kanoset shqiptarëve gjatë integritetit në shoqërinë gjermane, pra, kjo rini me vetiniciativë u organizua dhe u mobili-

zua për ruajtjen dhe ngritjen e vlerave tona fetare, kulturore dhe kombëtare; iniciativë kjo e cila më datën 07.10.2008 në qytetin Mannheim të Gjermanisë mori zanafillë, me Kuvendin e parë, i cili u përkrah nga 40 bashkatdhetarë të pranishëm. Në këtë Kuvend u vendos të hapet shoqata me emrin-*Deutsch Albanisch Islamischer*, shkurt : *D.A.I*

Kuvendi i parë konsideroi se bashkatdhetarët tanë duhet të vetëdijesohen dhe të vetorganizohen për sensibilizimin dhe vetëdijesimin e bashkatdhetarëve për t’u mbrojtur nga asimilimi. Më datën 18.02.2009, shoqata u legalizua me numrin e regjistrimit VR 700241 në Gjiqin Komunal të Mannheimit dhe, vetëm katër ditë pas legalizimit, shoqata ka filluar aktivitetin e mësim-besimit fetar me fëmijët parashkollorë, si dhe me nxënësit e klasave të ulëta. Kjo shoqatë, në datën 01.06.09, u kurorëzua edhe me objektin e vet me seli në Mannheim, në kuadër të së cilës u hap edhe xhamia e parë shqiptare në këtë qytet, me adresë: H7, 32 / 68159 MA.

Shoqata islame gjermano-shqiptare, *D.A.I*, ka plan-program të mirëfilltë, i cili shërben – për organizimin e jetës së besimtarëve, si udhëzues për funksioni-

min e saj dhe për mbarëvajtjen e aktiviteteve nga më të ndryshmet.

Pastaj, ndër aktivitetet e zhvillimit të jetës sociale, shoqata *D.A.I* ka bërë me sukses grumbullimin dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare, pastaj të *sada-katul fitrave*, si dhe të kurbaneve, në të gjitha trojet ku shtrihet populli shqiptar.

Ndërsa në aspektin kulturor janë organizuar dy ekskursionet, me qëllimin e vizitave të xhamive, njëra në Penzberg, e tjetra në Kufstein të Austrisë. Plan-programi ngërthen në vete edhe organizime të aktiviteteve javore sportive, ku edhe kurorëzohen me një ose dy herë në vit me turnirë të nivelit të gjerë. Vitin 2009 e përmbyllëm me sukses. Shoqata *D.A.I* ka vënë para vetes qëllime të cilat u shërbejnë të gjithëve. Përmes tyre ajo dëshiron që t’u ofrojë bashkatdhetarëve organizim të jetës së besimtarëve, ushqim shpirtëror, edukatë fisnike dhe mësim hyjnorë, gjegjësisht identitetet kristal të dhe origjinal të fesë. “Pra, për të arritur këtë qëllim, i kemi hyrë kësaj pune shumë të rëndë e të gjatë, mirëpo, me guxim të pathyeshëm dhe të bindur në ndihmën e Allahut, shpresojmë në suksesin e pritur të punës së saj. Ditaditës po del në pah shtimi i aktiviteteve, i nxënësve dhe i anëtarëve të rinj. Kështu që, deri më tani, kemi mbi 140 anëtarë”, - tha Damati.

Meqë gjendjen e pamë për së afërmi, mund të aludojmë fare pa hezitim për fjalinë e cila dikur endej në masën e gjerë të popullit, ku thuhej se isha në Perëndim dhe e pashë Islamin, por jo edhe muslimanët... Ndërsa tashmë mund të themi lirshëm se isha në Perëndim dhe e pashë Islamin, por i pashë edhe muslimanët, kuptohet në filltet e tyre, por sidoqoftë i pashë. ■





Plumba për pëllumbat

Intervistoi: Mr. Milazim MUSTAFA

Akoma nëpër mediet botërore është aktuale çështja e konvojit të ndihmave humanitare për në territorin e Gazës. Aksioni i quajtur “Flota e lirisë” përfshinte nëntë anije me ndihma humanitare, me mbi 10 mijë tonelata me ndihma për popullatën e Gazës, popullatë kjo që është nën embargo totale që prej katër vitesh. Në këtë karvan të madh ndihmash ishin të pranishëm një numër i madh aktivistësh humanitarë, gati nga e gjithë bota. Kishte aktivistë nga afro 50 shtete të botës. Ndër ta, në këtë konvoj

të madh dhe historik ndihmash, ishin edhe 4 aktivistë nga trojet tona: Sead Ramadani nga Kumanova, Jasmin Rexhepi dhe Sali Emin nga Shkupi dhe Fuad Ramiqi nga Kosova. Duke dashur që të njoftohemi për së afërmi me dhe rreth këtij karvani shfrytëzuam rastin të takohemi me njërin nga të pranishmit në këtë karvan. Është ky haxhi Sead Ramadani nga Sllupçani i Kumanovës, i njohur si aktivist humanitar në Kumanovë dhe më gjerë, përndryshe themelues i shoqatës edukative “Vllaznia”, që përkujdeset për mirëmbajtjen dhe edukimin e jetimëve. I dëshmuar në luftë dhe paqe, haxhi Seadi është personalitet i shquar,

veprimtaria e të cilit në Islam, në njëzet vjetët e fundit, është tejet e frytshme.

PAQJA: Ju njohim si njeri aktiv dhe humanist të vërtetë. Për të filluar bisedën, fillimisht, kisha dashur t’iu pyes se cili ka qenë motivi që ju ka shtyrë të jeni pjesëmarrës në këtë karvan historik?

Ramadani: Pa u hamendur aspak ju them se motivi kryesor kanë qenë fëmijët e Gazës. Thirrja e tyre e pandërprerë për ndihmë ka qenë ajo që më ka shtyrë t’i lë të gjitha anash dhe të marr rrugën për në Gaza. Siç jemi të njohur, ky vend është i bllokuar për katër vite me radhë, d.m.th katër vjet është nën embargo të



e paqes

hekurt dhe brenda këtyre katër viteve përjetuan edhe një luftë. Normalisht se jam përcjellës i situatës dhe gjendjes në Gaza dhe Palestinë, por normalisht edhe i vendeve të tjera nëpër botë, ku ekzistojnë kriza humanitare dhe ku shkelen të drejtat elementare të fëmijëve.

PAQJA: Rruga juaj nga Maqedonia ishte nëpërmjet Turqisë. Filluat nga Stambolli, pastaj vazhduat në Antali, ku pastaj hytë në anijen historike "Mavi Marmara". A mund të na jepni disa nga përshëndetjet tuaja për kohën gjatë pritjes dhe përcjelljes nga Turqia?

Ramadani: Po, ashtu është. Nga Ku-

manova mbërrimë në Stamboll e pastaj në Antali. Në Turqi qëndruam gjithsej dy ditë. Nga Stambolli shkua në Antali, ku u takuam me të gjithë të pranishmit e tjerë me të cilët do të niseshim në anijen Mavi Marmara. Turqit janë të njohur për krijimin e atmosferëve të mira, sidomos kur bëhet fjalë për çështje humanitare. Sa për informim, karvanë të tillë nuk janë organizuar veç për në Gaza. Vite me radhë merremi me aktivitete humanitare dhe kemi bashkëpunim të ngushtë me organizatorin kryesor të këtij karvani, Organizatën IHH nga Stambolli. Shteti turk dhe organizatat e ndryshme humanitare janë drejtuar me karvanë të tillë edhe për në Bosnjë, edhe për neve në Kosovë dhe Maqedoni, për në shumicën e vendeve afrikane, Amerikën Jugore e kështu me radhë. Sa i përket përcjelljes, në çdo kënd kishte njerëz që na përshëndetshin, uronin, porositnin për selame dhe përshëndetje vëllezërve tanë në Gaza.

PAQJA: Pastaj vazhduat me anije dhe për destinacion kishit Gazën...

Ramadani: Për destinacion kishim Gazën. Në anije ishte një atmosferë e mrekullueshme. Nuk besoj se dikush ka pasur rastin të përjetojë çaste të tilla, përveç neve 500 vetave që ishim në atë anije. Kishte njerëz nga shumë kombe, njerëz që flisnin shumë gjuhë, shumë kultura, por me të njëjtin qëllim, që të dhuronim ndihma dhe buzëqeshje për fëmijët dhe popullatën e Gazës. Të gjithë

flisnin gjuhë të ndryshme, por nuk e kishim aspak problem për të komunikuar. Kishte njerëz gati se nga të gjitha vendet e Evropës, SHBA-të, Kanadaja, Brazili, Australia, Indonezia, Malajzia, vendet afrikane e kështu me radhë. Në anije kishte edhe aktivitete të ndryshme kulturore dhe argëtuese që na mundësuan të kalojmë shumë mirë.

PAQJA: Dhe gjithë këtë harmoni dhe këtë idil e prishi sulmi i njësisë speciale izraelite. E prisnit një sulm të tillë?

Ramadani: Nuk e prisnim aspak një gjë të tillë. E kishim parasysh se mund të shkohej deri te bllokimi i anijes, pasi izraelitët ishin kërcënuar që më parë. Por nuk e kemi pritur aspak se mund të shkohej deri te një sulm i tillë piraterik i ushtrisë izraelite. Mendonin se mund të vinin për marrjen e anijes në mënyrë më të civilizuar, por jo ashtu siç bënë ata.

PAQJA: Momenti i sulmit ndodhi në ujërat e hapura detare, d.m.th. ky akt nuk ndodhi në ujërat territoriale të Izraelit apo të ndonjë shteti tjetër. Si ndodhi ky rast dhe ku ishit ju në ato momente?

Ramadani: Në ato momente ishim duke falur namazin e sabahut. Anija u sulmua në mënyrën më të ashpër, me bomba, armë zjarri, gaz lotsjellës dhe armë të tjera. Ishin dhjetë barka ushtarake me nga një tog ushtarësh. Pak më larg ishte edhe një numër i madh i anijeve luftarake izraelite. Kishte edhe helikopterë që fluturonin mbi anijen tonë. Sipas



Sead Ramadani



Sead Ramadani

kësaj, dukej sikur Izraeli të ishte nisur për luftë e jo për ndaljen e një anijeje me ndihma humanitare. Sulmi i anijes u bë nga uji dhe ajri. E gjithë kjo zgjati 15 minuta. Për këto minuta u vranë nëntë persona dhe tridhjetë të tjerë u plagosën. Pastaj u arrestuan edhe të gjithë të tjerët e mbetur në anije. 24 orë na mbajtën në anije, me duar të lidhura, pa pasur mundësi për kryerjen e nevojave fiziologjike. Kjo ndo-

dhi derisa mbërritëm në bregun izraelit, ku filluan me procedurat administrative. Pastaj na dërguan në burgun e vendit të quajtur 'Bir Seba'.

PAQJA: Si ishte sjellja e tyre në burg?

Ramadani: Katastrofale. Ishte një burg i ri, mirëpo, vazhdimisht kishim sulme dhe maltretime psikologjike. Sjellja e tyre ishte shumë arrogante. Gjithë

natën bërtitnin si të çmendur me qëllim që mos na linin të pushonim. Ushqimi ka qenë shumë i dobët. Njëherë ndodhi që të na jepnin ushqim të ngrirë, ishte i tëri akull... Pas 24 orëve na dërguan deri në aeroport, prej ku pastaj u kthyem me aeroplan në Turqi.

PAQJA: Në përgjithësi, komentet ishin shumë pozitive, mirëpo përkrahja më e madhe që iu bë misionit tuaj dhe karvanit "Flota e lirisë" ishte pritja që iu bë në aeroportin e Shkupit.

Ramadani: Po. I falënderoj të gjithë për përkrahjen. Me të vërtetë kanë dëshmuar vetëdije të lartë. Ishin të pranishëm qytetarë të nacionaliteteve të ndryshme, pjesëmarrës të organizatave të ndryshme humanitare dhe joqeveritare, fëmijë, të rinj, jetimë dhe të tjerë. Njëjtë, edhe miqtë dhe dashamirët që na kanë vizituar në shtëpi, na kanë dhënë edhe më tepër përkrahje për këtë mision tonin. Ne jemi popull human dhe jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e këtyre aktiviteteve humanitare.

PAQJA: Për në fund, dëshironi të shtoni





Fuad Ramiqi

Fuad Ramiqi

Veprimtari, humanisti dhe ish-luftëtar i UÇK-së, Fuad Ramiqi, i cili ishte në anije me qindra humanistë që po dërgonin ndihma në Gaza, u kthye në Kosovë, duke shprehur keqardhjen e tij për faktin se ndihmat nuk arritën në destinacionin e dëshiruar. "Kam qenë në mision shumë të rëndësishëm dhe të rrezikshëm, por vlera e këtij misioni ka qenë shumë më e madhe sesa reziku që kam bartur, sepse edhe ne si popull kemi përjetuar situata të ngjashme," - ka thënë Ramiqi. Ai ka shtuar se, sapo ka dëgjuar për këtë mision, ka shprehur gatishmërinë për të qenë pjesë e tij. "Ky mision ka filluar para tre muajve dhe për të kam dëgjuar nëpërmjet mediave. Më pas kam kontaktuar me disa miq në Stamboll dhe ata më kanë mundësuar që edhe unë të jem pjesë e këtij misioni. Ata m'i kanë mbuluar shpenzimet e udhëtimit deri atje dhe të kthimit këtu," - është shprehur ai. "Në mëngjesin e 31 majit, në ujërat ndërkombëtare, 75 milje larg Bregut të territorit të Gazës, pas orës katër të mëngjesit, disa të pranishëm kanë filluar të tregojnë se janë duke u afuar disa anije të vogla, me një shpejtësi të madhe. Pas tentimeve të këtyre anijeve për t'u futur në anijen humanitare, në ndihmë të tyre ka ardhur një helikopter, i cili ka zbarkuar ushtarë në platformën e lartë të anijes," - ka treguar Ramiqi për situatën e përjetuar. Më pas ai ka rëfyer se si ka filluar edhe momenti i dhunës. "Kanë filluar të na gjuajnë me plumba plastike, dhe më pas kam kuptuar se në platformën lart ka pasur një

përleshje të madhe... Pas kësaj, duke parë situatën e tensionuar, ka ardhur një përforsim tjetër përmes helikopterit dhe dy anije luftarake më të mëdha, të cilat kanë filluar të hedhin në anije plumba të vërtetë nga të gjitha anët. Kam arritur ta shoh njeriun e parë, duke e tërhequr. Ai ishte goditur në kokë me plumba...," është shprehur Ramiqi për të treguar më pas se: "Më pas na kanë tërhequr dhe na kanë marrë të gjitha gjërat, duke filluar nga orët, kuletat, aparatet e ndryshme të filmimit, kamerat dhe më pas na kanë lidhur dhe na kanë vendosur në një platformë jashtë, ku kemi qëndruar më shumë se pesë orë," - ka theksuar ai. Ramiqi ka thënë se ndihet i zhgënjyer me mosinteresimin e institucioneve të vendit për të dhe mosangazhimin e tyre për ta liruar dhe për ta sjellë në vend. Ai tregon sesi ka refuzuar takimin dhe ndërhyrjen për t'u liruar nga ambasadori serb. "I pari që ka mbërritur në mesin tonë, kur kemi mbërritur të burgosur në Izrael, ka qenë ambasadori maqedonas, i cili i ka kërkuar shtetasit e vet dhe unë i jam drejtuar atij, pasi që kemi biseduar se e kanë ditur që është një kosovar. Aty unë i jam drejtuar atij që të marrë emrin, mbiemrin dhe numrin tim të telefonit që të lajmërojë familjen time. Ai ka nisur të shkruajë dhe në një moment ka thënë që është interesuar ambasadori serb për të më ardhur në ndihmë dhe më ka thënë me e thirr. Unë, kur e kam dëgjuar këtë, i kam thënë se s'kam nevojë për të, sepse kam shtetin tim dhe përfaqësoj popullin tim," - u shpreh veprimtari Ramiqi.

edhe diçka tjetër?

Ramadani: Kisha dashur të apeloj te të gjithë bashkëkombësit tanë, pasi se kemi pasur situata të ngjashme me popullin e Gazës, që të interesohen më tepër për popullin e Gazës, sepse ky popull, që gjendet padrejtësisht nën embargo, ka nevojë për mbështetje. Ky popull gjendet nën embargo për shkak se në zgjedhjet demokratike ka votuar për një parti. Për faktin se ka fituar ajo parti, luftohet e gjithë popullata. Ne lusim Zotin që embargoja të hiqet sa më shpejt dhe që ky popull lirisht të lirohet dhe të zhvillohet normalisht si të gjithë popujt e tjerë të botës. Njëherësh i bëjmë thirrje edhe bashkësisë ndërkombëtare, që deri më tash ka dështuar në rastin e Palestinës, ta ngrejë zërin dhe të ndërmarrë hapa konkretë për thyerjen e kësaj embargoje.

PAQJA: Z. Sead, ju falënderoj që ndatë kohë të jeni prezent dhe t'i ndani emocionet dhe përshtypjet tuaja në lidhje me pjesëmarrjen tuaj në karvanin humanitar "Flota e lirisë".

Ramadani: Ju faleminderit edhe juve. ■

Allahu është i vetmi gjykues

Kuptohet, secili lider duhej të paraqitej me vendime të reja. Askujt nuk i mjaftoi vetëm slogani e të rrinte i qetë, por ideologjia e re kërkonte parime dhe vendime të reja. Fatkeqësisht, prej tyre lindën edhe hadithe jo të vërteta, të cilat e hutuan edhe më shumë popullatën muslimane. Aliu r.a. u bë, në të njëjtën kohë, me dy kundërshtarë të mëdhenj. Në Sham kishte kalifin e vetëshpallur dhe havarixhët.



Mr. Muhamed J. KAJOLLI

Takimi i Devmetul Xhendel-it ishte dita e shumëpritur për qytetarët e shtetit islam. Pas një katrahure dhe krekosjeje të disa personave, që tërhiqnin ithtarë dhe pas disa betejave të herëpashershme, filloi sërish të duket drita në tunelin e stërzgjatur. Fatkeqësisht, ky gëzim nuk zgjati shumë, për arsye se në mendësinë e krerëve të Shamit nuk ishte pajtimi dhe afrimi midis muslimanëve, por ndarja e plotë (mundësisht pa pasoja), ose fitorja e plotë për ta marrë pushtetin. Gjithashtu kishte edhe grupe të tjera që nuk e dëshironin këtë pajtim. Kur këta dëgjuan se takimi përfundoi pa rezultat, këtyre iu dha mundësia të dilnin me slogane të reja, të cilat i përçanë muslimanët edhe më shumë dhe u bënë shkaktarë të vëllavrasjeve të reja.

Kush janë havarixhët?

Qëkur u nda Aliu (Zoti e fisnikëroftë

fytyrën e tij) nga beteja e Siffinit e derisa arriti në Kufe, në ushtrinë e tij ishin formuar disa grupe të vogla, të cilët pëshpëritnin pakënaqësinë e tyre dhe herë pas here mendonin të dilnin kundër tij. Kjo vërehej në disa raste, por nuk mendohej se do të merrte përmasa aq të gjera sa të vinte dita që ai do të detyrohej t'i luftonte. 'Kush urdhëroi?' dhe 'Si ndodhi ndërprerja e betejës së Siffinit?' - ishin pyetjet më të zëshme gjatë rrugës së kthimit. Dy ose tre muaj pa filluar takimi i 'pajtimit' i caktuar në Devmetul Xhendel, një numër i atyre të cilëve iu shtua ankthi dolën me sloganin "Allahu është i vetmi gjykues". Ata ishin një grup prej katër mijë kalorësish të krahinës Nisak, të cilët morën vendimin fatal për ndarje definitive nga prijësi i muslimanëve. Këtij grupi, pa vonuar shumë, iu bashkëngjitën edhe disa grupe të tjera më të vogla, numri total i të cilëve u bë tetë mijë. Të gjitha grupet u takuan në fshatin e quajtur Harura, prej nga edhe fillimisht i emëruan me këtë emër. Pra, grupi i Harura-it.²

Numri total i të pakënaqurve me prijësin e muslimanëve arriti në dymbëdhjetë mijë ushtarë. Ndër kryesorët prej

tyre ishte Shejth Ibën Rubej Et Temimi (ish-negociator i Aliut me Muaviun), i cili pa vonuar shumë u emërua komandant i ushtrisë së Haruar-it, ndërsa për prijës të namazit caktuan Abdullah Ibën El-Kewa El Jeshkurij. Për shkak të shkëputjes nga ushtria e Aliut r.a. dhe formës së largimit të tyre, ky grup muslimanësh u quajt havarixhë, që do të thotë të shkëputurit.

Qëllimi i havarixhëve:

Shteti i ri i muslimanëve kishte shtrirje shumë të gjerë. Brenda tij ishin futur shumë popuj dhe fise, të cilët nuk kishin edukatën dhe njohurinë e duhur për Islamin. Kjo fe e re, qëllimet e së cilës ishin përhapja e fjalës: Nuk ka hyjni tjetër përveç Allahut - La i Lahe Il-Iallah, kishte qëllime globale, mirëpo kishte filluar të sulmohej nga diplomatë të jashtëm të shteteve me përvojë të madhe disa shekullorë. Në pamundësi për ta luftuar fizikisht këtë energji të madhe të muslimanëve, ata, siç kemi theksuar edhe më herët, krijuan strukturë të brendshme, sepse, as bizantinët e as persianët, nuk kishin forcë që ta shuanin fizikisht shtetin e sapoformuar.

Prandaj mund të thuhet se një grupi të vogël të havarixhëve, të shtyrë më herët nga vrasja e Osmanit r.a., u duhej të mbroheshin në çdo formë për të shpëtuar jetët e tyre. Ata dolën me sloganin: "Allahu është i vetmi gjykues", fjali që do të tërhiqte me vete shumë besimtarë të tjerë, të cilët nuk kishin formimin e duhur në Islam. Disa për shkaqe të afërsisë së tyre fisnore e disa të tjerë për qëllime të tyre personale, e shtuan numrin e rebelëve dhe dolën nga radhët e ushtrisë së Aliut r.a.

Këtu duhet të kemi parasysh se dymbëdhjetë mijë ishin vetëm meshkuj dhe të gjithë ishin të aftë për luftë. Nëse këtyre ua shtojmë edhe numrin e të papërcaktuarve, të pakënaqurve dhe të familjarëve të tyre, del se numri tyre do të ishte më i madh. Prandaj shkëputja prej kalifit, nënkuptonte se këta do të





krijonin strukturat e tyre politike dhe ideologjike. Për këtë arsye, menjëherë pasi u grumbulluan dhe caktuan prijësit e tyre, ata dolën me sloganin tjetër: Allahu është gjykuesi i vetëm, ndërsa ne nuk kemi kalif, ne udhëhiqemi nga komisioni, i cili do të merret me vendimet e gjykuesit absolut. Këto ishin teori dhe ide të reja çoroditëse, por ja që një numër iu shkoi prapa dhe ishin në gjendje të luftonin për këtë ideologji çoroditëse.

Këto ngjarje ishin paralajmëruar nga Pejgamberi i Allahut Muhamedi s.a.v.s., prandaj Aliu dhe shumë prej sahabëve, e dinin fare mirë rrezikun e këtyre trazirave. Çdo gjë e merrnin me durim dhe maturi të madhe nga frika që këto trazira të mos përmbylleshin me humbje fatale. Hadithi: “Në kohën kur do të ketë trazira dhe kundërshtime ndërmjet myslimanëve, do të shpëputet një grup. Ai i cili do t’i luftojë ata, do të jetë me të drejtën”. (Muttefekun alejhi)

Negociata me havarixhët

Pas një pauze disaditëshe, kur grupit të havarixhëve iu vështirësuan mjetet për ekzistencë dhe u bë kohë nga shkëputja e tyre prej familjarëve, Aliu r.a. dërgoi Abdullah Ibën Abasin të negociojë me ta. Mirëpo Abdullahu nuk arriti t’i bindë edhe pse atje në Harura u zhvillua një debat i gjatë.³ Ata nuk qenë të kënaqur me Abdullahun dhe kërkuan prej tij që të bisedonin drejtpërdrejt me Aliun r.a.,

i cili shkoi i shoqëruar nga njëqind kalorës. Pak para se të arrinte në Harura, atij i doli në pritë Abdullah Ibën El Keva, me njëqind shokë të tij. Pasi Ibën El Keva mori siguri prej Aliut se nuk do ta luftonte, u afruan afër njëri-tjetrit me nga dhjetë shokë. Bisedën e hapi Aliu r.a., duke ia kujtuar atij rrjedhën e ngjarjeve që nga beteja e Siffinit e deri në momentin e ndarjes.

Ibën El Keva-ja i pohoi të gjitha ato që tha Aliu r.a.. Më pas, Aliu r.a. iu tha se ne nuk po i gjykojmë njerëzit, por ata po mundohen të nxjerrin gjykimin e Allahut të Lartmadhëruar prej librit të Tij (Kur’anin). Havarixhët, ata të cilët e zgjodhën Ebu Musanë për të negociuar derisa ishin në Siffin, tani e kundërshtonin gjykimin e tij për shkak të ideologjisë së tyre të re. Aliu r.a. u tha: “Ne nuk po kërkojmë këtë. Ky Kur’an është Libër i shkruar dhe nuk ka se si të flasë vetë,⁴ prandaj më thoni si do të mësojmë prej tij se çfarë na thotë? Ndërsa unë ju them se atë e marrim vesh nga ata që i studiojnë ligjet e tij”.

Përfaqësuesi i havarixhëve i tha: atëherë pse e shtytë gjykimin për shtatë muaj? Aliu r.a. iu përgjigj: “Për arsye që negociuesit të kishin kohën e mjaftueshme për ta studiuar në qetësi dhe të jenë sa më të saktë”.

U vërejt se shumica dërmuese prej tyre u pajtuan me diskutimin e Aliut, i cili i porositi të kthehen në shtëpitë e tyre për të pritur vendimin e gjykimit,

që do të merrej pas pak kohësh. Në atë moment, u shtri dora e pajtimit dhe u kthyen në Kuffe.

Rebelimi i sërishëm i havarixhëve

Më 10 shkurt të vitit 657, ose të shtunën e parë të muajin Ramazan5, palët negociuese u takuan në Devmetul Xhendel. Mirëpo ky takim negociues në Devmetul Xhendel përfundoi pa rezultat. Pasi u informua për rezultatin e takimit, Aliu r.a. mbajti fjalimin e tij përpara turmës së madhe në Kufë. I kapluar nga mërzia, prej brendisë së shpirtit të tij dolën fjalë për ndodhitë e betejës së Siffin-it, duke ua përkujtuar të pranishmëve se ai, atje, u pengua nga ithtarët e tij që ta përfundonte mosmarrëveshjen me Muaviun, por u tha se duhej të ktheheshin nga e para, për të shkuar që t’i pastrojnë hesapet me të.6

Pastaj iu afrua grupit të ish-havarixhëve që i kishin dalë një herë nga struktura e tij. Me këtë rast, ata i thanë: “Tani po e refuzon edhe këtë gjykim?! A nuk ishte ti që na binde në Harura që të kthehemi te ti, kur na the se çdo gjë do të kalojë mirë në takimin në Devmetul Xhendel?”

Aliu r.a. u tha: “Po, por nga ta dija unë se negociuesit do të dalin aq të cekët sa të kthehen pa vendim të prerë nga takimi. Ju kujtohet kur ju thashë në betejë se kjo është një prej hileve të tyre dhe të mos i ndërprisnim luftimet deri sa të kapitullonin?”

Ish-havarixhët i thanë: “Po. Ai ishte

gabimi ynë më i madh që bëmë ndaj Allahut të Lartmadhëruar dhe për këtë jemi penduar. Po ti, a nuk je penduar për mohimin që bëre, sikurse edhe ne”?

Alia r.a iu tha: “Por unë asnjëherë nuk e kam mohuar Zotin. Gjatë tërë jetës sime jam kujdesur që ta ruaj besimin dhe, njëkohësisht, t’ua ruaj të tjerëve, me qëllim që mos ta mohonin Atë”.

Ish-havarixhët i thanë: “Ti pra, nuk na qenke penduar?! Që tani e tutje, ne nuk do ta ndjekim kurrë rrugën tënde. Ti nuk je më prijësi ynë sepse për ne je një mohues. Ti lejove të gjykohe mbi gjykimin e Zotit”.

Ata dolën nga radhët e tubimit duke brohoritur sloganin “Allahu është i vetmi gjykues”, slogan që do të tronditë sërish për një kohë të gjatë umetin musliman. Mirëpo Aliu r.a., duke qenë se ishte për afrim e jo për largim, u tregua i matur dhe kërkoi prej të tjerëve që të qetësohen dhe të jenë të durueshëm, me shpresë se, pas disa ditësh, mbase do të negocionte sërish dhe do të ktheheshin përsëri.

Aliu r.a. e dërgoi përsëri Abdullahun për negociata. Por, fatkeqësisht, prej tyre nuk doli asgjë, me përjashtim të një numri shumë të vogël. Meqenëse Aliu r.a. kishte prioritet Muaviun, ai ju tha ithtarëve të tij: “Slogani i tyre ‘Allahu është i vetmi gjykues’ është i drejtë, por disa prej krerëve të tyre kanë qëllime të këqija. Meqenëse nuk pranojnë këshillat tona, atëherë le të bëjnë çduan, ndërsa ne do t’iu përgjigjemi vetëm atëherë nëse na luftojnë”.

Aliu r.a. nisët për në Sham

Aliu r.a. nuk u shqetësua shumë nga rebelimi i havarixhëve, sepse konsideronte se shumë prej tyre ishin besimtarë shumë të devotshëm. Për Aliun r.a., hë për hë, kundërshtari kryesor ishte prefekti Muaviu dhe me të do të duhej t’i pastronte hesapet një herë e mirë. Ai urdhëroi për mobilizim. Për një kohë të shkurtër u mbledhën rreth 70 mijë ushtarë dhe, pa u vonuar shumë, u nis për në Sham. Ai e la Abdullah Ibën Abasin në Kufë dhe e këshilloi të merrej me havarixhët, për t’i kthyer në rrugë të drejtë.

Mirëpo nuk ndodhi ashtu siç e parashikoi ai, sepse kur arriti në vendin e quajtur Nuhejle, atij i erdhi lajmi se havarixhët ishin tërbuar dhe po e terrorizonin popullatën civile. Pas një konsulte me këshilltarët e tij, Aliu r.a., u detyrua



të kthehej prej andej, për ta stabilizuar situatën në vendin e vet dhe për t’i luftuar ithtarët e ideologjisë së re.

Havarixhët rigrupohen në Madain

Kur havarixhët u larguan nga Kufja, ata u drejtuan drejt ish-kryeqytetit të Persisë perandorake, Madain. Kjo ka ndodhur në muajt e parë të vitit 38 h.8 Atje zgjodhën liderin e tyre. Tani i pari i tyre ishte Abdullah Ibën Vehb El Rasibij. Kuptohet, secili lider duhej të paraqitej me vendime të reja. Atij nuk i mjaftoi vetëm slogani dhe të rrinte i qetë, por ideologjia e re kërkonte parime dhe vendime të reja. Fatkeqësisht, prej tyre lindën edhe hadithe jo të vërteta, të cilat e hutuan edhe më shumë popullatën muslimane. Aliu r.a. tani kishte, në të njëjtën kohë, dy kundërshtarë të mëdhenj. Në Sham kishte kalifin e vetëshpallur dhe havarixhët.

Nga parimet e havarixhëve doli se: Nëse Aliu është mohues i Zotit, tani të gjithë ata që qëndrojnë dhe mendojnë sikur ai, janë mohues të Zotit, sikurse edhe ai. Ndërsa për Muaviun, ata fil-

luan të thonë se ai ishte armiku i Allahut. Meqenëse veprimtaria e këtyre ishte larg territorit të Muaviut, atëherë filluan të terrorizojnë menjëherë popullatën më të afërt ku ata ishin, pa çka se ata mund të ishin edhe të afërmit e tyre. Ky terrorizim nuk kishte të ndalur, aq saqë popujt e zonave ku ata interferonin filluan të frikësohen prej tyre për disa muaj me radhë.

Ndiqe udhëzimin dhe jo njeriun

Havarixhët ishin vendosur në vendin në të cilën prefekti ishte Abdullah Ibën Habab Ibën Ereti. Një grup i havarixhëve shkuan te prefekti dhe filluan të diskutonin për Aliun dhe ish-kalifët e mëhershëm. Prefekti ju tha se ata ishin besimtarë të drejtë dhe shumë të respektuar, ndërsa ju jeni shumë të cekët në njohuritë e Kur’anit dhe të Islamit në përgjithësi. Ai ju citoi hadithin e Pejgamberi s.a.v.s. i cili kishte thënë: “Do të ketë sprova të mëdha, në të cilat do të vdesin zemrat e njerëzve, ashtu siç do të vdesin trupat e tyre. Do të ngriset njeriu besimtar e do të gdhiet kafir.



Bëhu rob i vrasëri i Zotit e jo rob vrasëri i Zotit” (Thartori,174-Bidaje,7/282)⁹

Vrasjen e Hababit e kishte parë një i krishterë i cili po kalonte andej pari me deve. Ishte një veprim makabër i kryer prej tyre. Rebelët kishin nevojë për një deve dhe kërkuan prej tij që t’ua shiste atë. Ai, pa u hamendur fare, ua fali atë nga frika se ata ishin në gjendje të bënin gjithçka. Mirëpo ata këmbëngulën që ai t’ua shiste atë, sepse kishin urdhër nga Muhammedi s.a.v.s. të silleshin mirë me të krishterët dhe hebrejtë. I krishteri i habitur tha: “Vrisni njeriun shumë të respektuar, ndërsa më nderoni mua?! Merreni devenë dhe më lini rehat dhe iku me të shpejtë”.

Beteja e Nehrevanit

Me t’u kthyer nga rruga e tij për në Sham, Aliu r.a. qëndroi një kohë në Kufe derisa mësoi saktë se çfarë kishte ndodhur midis popullatës civile dhe terroristëve havarixhë. Derisa ai ishte në Kufe, havarixhët e masakruan prefektin e tij, prandaj atij iu bë e detyrueshme të merrej seriozisht me pastrimin e re-

belëve vrasës. Mirëpo edhe havarixhët do t’i përgjigjeshin Aliut me luftë. Dy ushtritë u takuan në krahinën e quajtur Nehrevan, në fillim të vitit 39 h, ose në vitin 659 sipas atij gregorian.¹⁰ Siç ishte tradita islame, Aliu r.a. dërgoi te ta Harb Ibën Murren-in për të diskutuar për herë të fundit, nëse ata dëshironin të pendoheshin për atë çfarë kishin bërë. Rebelët jo vetëm që nuk u penduan, por donin t’i zbatonin menjëherë parimet e tyre që kishin vendosur kundër ithtarëve të Aliut dhe Muaviut dhe, pa u hamendur fare, e vranë edhe Harbin.

Gjykatësi i drejtë

Kur Aliu r.a. dhe shumë të pranishëm panë skenën çoroditëse që ndodhi me Harbin, ai r.a. doli disa hapa përpara dhe kërkoi prej ushtrisë së havarixhëve që të sillnin vrasësit e Harbit dhe të tjerëve menjëherë, ndërsa të tjerët do të liheshin të lirë. Përgjigja e tyre ishte negative, duke i thënë se të gjithë ishin vrasësit e tyre. Ai u përpoq sërish që t’i bindë, por pa rezultat konkret. Përfundimisht, pak para se të jepte urdhër për sulm të përgjithshëm do t’ua mundësonte edhe një shans pendimi, duke e urdhëruar Ejub El Ensariun që të shkonte në një kodrinë, e cila ishte pak larg nga ushtria e dy palëve dhe ta ngrinte flamurin. Pasi ta bënte këtë, atëherë duhej t’i thërriste rebelët duke ju thënë: kush do të vijë te ky flamur është i siguruar, kush do të shkojë në Kufe është i siguruar dhe kush do të shkojë në Madain (kryeqendrën e tyre) është i siguruar.¹¹

Kjo ftesë sikur i lëkundti zemrat besimtare që ishin ndier të tradhtuara dhe disa filluan të shpërndahen dhe të largohen në drejtimet që ju tha Ejub El Ensariu. Kështu në fushëbetëj mbetën rreth tre mijë ushtarë rebelues.¹² Pasi pushuan lëvizjet e shpërndarësve, Aliu r.a. urdhëroi për sulm të përgjithshëm dhe arriti të korrë sukses të plotë kundër tyre, me përjashtim të tetë personave, të cilët ia mbathën.

Më vonë, të penduar nga dezertimi, grupi i atyre që u shpërndanë në betejën e Nahravanit, u tubuan dhe i dolën përballë ushtrisë së Aliut r.a. në vendin e quajtur Nahile. Aliu r.a. dërgoi Abdullah Ibën Abasin për t’i këshilluar sërish dhe për të biseduar me ta, por pa rezultat. Pastaj Aliu r.a. shkoi vetë me ushtrinë e tij dhe e shkatërroi tërësisht edhe atë

ushtri rebele, me përjashtim të pesë personave, që arritën të iknin. ■

¹ Natyrisht, mos pajtimi i shkonte përshat diplomatikë të jashtme dhe atyre që kishin marrë pjesë në vrasjen e Osmanit r.a.

² Për më shumë lexo: Taberi, f. 5/47; el Futuh, f. 477; Bidaje, 5/511; Jakubi, 2/193; Taberi, 5/50; Dinuri, 141; el Fitne, f. 212;

³ Debati i Abdullah Ibën Abasit me havarixhët në Harura është theksuar nga disa historianë. Atë mund ta gjeni në: El Futuh: 483, në Bidaje, Taberij, Dinuri etj.

⁴ Dinuri sjell një detaj për këtë thënie: Aliu r.a. ka marrë Kur’anin në dorë dhe ka kërkuar prej tij të flas. Ata po habiteshin me veprimin e Aliut dhe i thanë: Ajo që ke në dorë është vetëm letër dhe ngjyrë, ajo nuk flet. Atëherë Aliu r.a. iu tha: Si kërkoni që ky i cili nuk flet të gjykojë te ju...

⁵ Sipas të dhënave të Muhtar Pashas, f. 69

⁶ Ata që iu gëzuan kësaj mosmarrëveshje ishin havarixhët dhe muavitët. Të parët u gëzuan se vendimi i tyre do të shtyhej, ndërsa të dytët iu gëzuan faktit se ishin më të bashkuar se ithtarët e Aliut r.a. dhe mund ta merrnin pushtetin në mbarë territorin e shtetit musliman.

⁷ Abdullah Ibën Abasi na përshkruan gjendjen në të cilën i kishte takuar havarixhët. Adhuruës të mëdhenj të Allahut dhe të përkulur, në ballë kishin shenjat e qëndrimit të tyre të gjatë në sexhde, gjithashtu te ta vëreheshin edhe shenjat në gjunjë.

⁸ Po në këtë kohë, pasi Muavii mësoi për havarixhët që u rebeluan dhe pasi u sigurua se Aliu r.a. u kthye nga rruga e tij e Shamit për në Kufe, ai u shpall kalif i Shamit. Populli i Shamit mendonte se kalifi duhet të ishte vetëm prej fisit Kurejsh, dhe shtëpia e emevitëve ishte njëra prej atyre që gëzonte më së shumti autoritet për këtë pozitë. Kështu, për herë të parë, zyrtarisht shteti i muslimanëve do të kishte dy kalifë. Menjëherë pas emërimit të tij kalif, ai do të dërgohej Amër Ibën Asin në Egjipt... Në temën tjetër do të kujtojmë vrasjen e Muhamed Ibën Ebi Bekrit dhe kalimin e pushtetit të Egjiptit në duart e Muaviut.

⁹ Po çfarë mendon konkretisht për Aliun, i thanë? Ai është njeriu më meritë dhe më i dituri nga të gjithë ne dhe ju. Ata ia prenë njërin vesh. Ia përsëritën pyetjen, ndërsa ai ripërsëriti të njëjtën përgjigje. Ata ia prenë veshin tjetër. Kështu vepruan derisa e masakruan. Pastaj shkuan në shtëpinë e tij dhe ia mbytën gruan që ishte shtatzënë dhe e dërguan xhenazen te gremina, ku e kishin hedhur bashkëshortin e saj.

¹⁰ Jakubi, f. 2/193, Muhtar Pasha, f. 71,

¹¹ Nuk ka dyshim se Aliu r.a. gjykonte sipas parimeve islame, ndërsa shembulli i tij ishte Pejgamberi s.a.v.s. Kjo thirrje na kujton hyrjen e Pejgamberit s.a.v.s në Mekë. Për më shumë rreth kësaj ngjarje lexo: Tarikh Taberij, 5/56; Dinuri, 147;

¹² Mendohet që ky grup të ketë qenë ai i protestuesve të vrasjes së Osmanit r.a. me disa përkrahës të përjetuar të tyre.

“Meditime...” një mesazh modest social e fetar



Mr. Ferdi KAMBERI

Meditimi, nga prizmi logjik, mund të konsiderohet si një komunikim introspeksional, subjektiv, analitik, një komunikim i brendshëm, një përqendrim, një thellësi në mendime për një problem të caktuar. Mirëpo, në suaza më të gjëra, meditim mund të përshkruhet edhe si veprimtari shpirtërore intencionale, ndërsa në fushën e religjionit zakonisht është i drejtuar nga bota shpirtërore e njeriut, me të vetmin qëllim që njeriu, si qenie e tërësishme, si krijesë t'i ofrohet Zotit, Krijuesit, Allahut sa më afër!

Libri “Meditime Sociologjike mbi Islam”, i autorit prof dr. Fadil Malokut, është një libërth i cili ngërthen në vete një estetikë filozofike. Autori në këtë libër jep një mesazh të qartë mbi atë se Islami është një fe hyjnore dhe se ligjet hyjnore janë ngadhënjimtare karshi atyre ideologjike dhe politike, sepse ligjet politike dhe ideologjike mund të ndryshohen dhe mund të manipulohen shumë lehtë, ndërsa me ligjet hyjnore kjo nuk mund të ndodhë.

Autori flet për nevojën e besimit, që sipas tij është natyrale. Pra, njeriu, si qenie sociale biologjike, gjithnjë është munduar që të gjejë një formë komunikimi, adhurimi, të bëjë rituale,

të meditojë për Krijuesin, ku varësisht nga konteksti social, njeriu nuk ka jetuar pa besim. Me fjalë të tjera, vetë besimi në një fuqi mbinatyrore, e ka ndaluar njeriun nga shumë veti negative dhe e ka afruar atë më afër Krijuesit.

Duke folur për demokracinë, sidomos në vendet post-komuniste, autori vë në pah se demokracia sot ofron si mundësi dy tipa alternativash: “E para, alternativa islame ka të bëjë me konceptin dhe filozofinë e zhvillimeve islame që është një konglomerat i praktikës politike dhe religjionit që është e bazuar në principet e Kushtetutës së parë në botë, e cila doli si rezultat i marrëveshjes në Medinë dhe u quajt “Karta e Medinës”. Alternativa e dytë, që sipas autorit mund të quhet edhe si alternativa aziatike, është një përvojë shumë e rëndësishme, për vetë faktin se sot po e ndjek këmba-këmbës konceptin e demokracisë perëndimore, me sukseset e papara deri më tani të zhvillimit ekonomik. Dhe gjysmë alternativa e tretë, e shquar si “ofensivë kulturore singapuri-ane”, është një alternativë sipas konceptit të së cilës njerëzit kanë nevojë jo për një qeveri demokratike, por për një qeveri të mirë dhe funksionale”. Nga këto alternative, autori mundohet të nxjerrë një konkludim se krahas këtyre alternativave, Kosova i takon zonjës së vjetër Evropës dhe si vend post-komunist ka nevojë për një demokraci funksionale, për mësimet e vetë demokracisë, sepse siç thotë ai “ky model i qeverisjes i ndihmoi (Kosovës) që të çlirohej nga zgjedha e obskurantizmit neofashist serb”.

Autori në fjalë, duke folur për një qytetërim të mundshëm, merr si bazë argumente nga Kurani famëlartë dhe nga fjalët e pejgamberit Muhamed. Ai është skeptik rreth idesë së një qytetërimi të vetëm, siç thekson: “...kujtoj, si dhe besoj shumë se utopia e re për një qytetërim të vetëm është e pamundur. Këtë e ilustron me bindjet dhe njohjet që i kemi të gjithë, pak a shumë për historitë e popujve të mëhershëm para nesh, të përshkruar nëpër të gjitha librat e shenjta dhe librat e historive”. Më tej, duke folur po në këtë pjesë, ai flet edhe për misionet e ndryshme që kishin ardhur në Kosovë pas luftës me qëllime të ndryshme. Këta misionarë e shihnin Kosovën si një Eldorado, por, sipas tij, ata hasën në një “Mission (In) Possible”. Sipas autorit qëllimi i tyre ishte paragjykses. Në fakt, ata kishin ardhur këtu për mbjelljen e farës së kulteve dhe të misticizmit, por ja që në Kosovë, te shqiptarët, edhe pse nuk kishte kulm shtetëror, të paktën identiteti fetar ishte i pandryshueshëm. Ndërsa duke folur për filozofinë në Islam, ai është i mendimit se ekziston një korrelacion mes fjalëve greke dhe atyre arabe p.sh. Hikme = me Sophia. Pra, sipas autorit në fjalë, *filozofia islame dhe ajo perëndimore kanë vënë themelet e para të meditimeve dhe aspiratës së njeriut, por edhe një karakter të veçantë të kuptimit të vetë jetës.*

Autori flet edhe për përleshjen e civilizimeve, për atë që Huntington-i e quan “Etnos Global”, duke vënë në pah se Huntingtoni kishte paraparë një përleshje të mundshme të civilizimeve, mirëpo teoria e tij, me rastin e konfliktit në Bosnje dhe Kosovë.

Si përfundim, mund të themi se ky libërth përmban në vete një mesazh modest në rrafshin social, fetar dhe kulturor. Ai trajton shumë tema të rëndësishme, tema aktuale, tema të një rëndësie të veçantë dhe, mbi të gjitha, ky libërth ka një mesazh të qartë: “Islami është fe universale, fe e paqes, fe e cila i trajton të gjithë të barabartë, pa dallime etnike, kombëtare, fetare, gjinore e klasore”. ■



A janë politike të drejtat e njeriut?

Shoqëria moderne dhe shteti modern ia arrijnë të krijojnë botën e tyre – botën dytësore, botën e “zgjedhjeve” dhe të “premtimeve” shterpe – si realitet të vetëm, në të cilin nuk ka vend për realitetin mbinatyror, për realitetin hyjnor. Për shkak të këtij horizonti ideor bashkëkohanikët tanë thjesht bëhen të paafte të hapen për realitetin hyjnor, ta dëgjojnë dhe ta kuptojnë Fjalën Hyjnore...

Prof. dr. Ismail Bardhi

Emine A. VEZAJ

Armiqësia e elitës kosovare ndaj mbulesës së disa vajzave muslimane dhe në veçanti ndaj mbajtjes së veshjeve së tillë edhe në shkollat publike, nuk bëhet fjalë thjesht se shihet si kufizuese e lirisë së femrave dhe simbolizon atë që edhe shumë evropiane kohëve të fundit e shohin si shtypje që feja islame u bën femrave, por kjo veshje fyen sekularizmin kushtetues të aktit më të lartë të Kosovës.

Realisht, Kushtetuta duhet të jetë shprehje e lirë e popullit, ose siç do të thoshte Huber për Ligjin: “ai është zëdhënës i popullit”. Në një gjendje jokushtetuese flitet për nxjerrjen e Kushtetutës së re dhe, në demokraci, Marksia thotë: vetë Kushtetuta paraqitet si vetëvendosje (vetëpërcaktim) e popullit. Në monarki, thotë ai, kemi popullin e Kushtetutës, kurse në demokraci Kushtetutën e popullit”. Këtu, Kushtetuta vazhdimisht reduktohet në bazën e vet të vërtetë (reale), në njeriun e vërtetë, në popullin e vërtetë dhe përcaktohet si vepër e tij vetjake dhe kjo jo vetëm për vete, ndaj thelbit të vet, por edhe për nga ekzistimi i tij dhe e vërteta, njëmendësia. Në një rrafsh më të gjerë, çdo përcaktim antidemokratik, me vetëdije ose pa të, edhe pse ky mund të mos jetë fare qëllimi, mund të çojë deri në fashizëm. (Newmann)

Edhe pse Kushtetuta e Kosovës garanton lirinë e besimit në kuadër të të drejtave të njeriut, çështja e natyrës së të drejtave të njeriut nuk është fare e zgjidhur për vetë faktin se janë braktisur premiset që janë vendosur nga vetë përpiluesit e këtij akti juridik më të lartë të shtetit. Çështja që na preokupon do të banalizohet. Çështja do të reduktohet në një pyetje rreth mundësisë së shfrytëzimit të idesë së të drejtave të njeriut, shfrytëzimit të kërkesave që

frymëzohen prej saj, në mënyrë që të mobilizohen energjitë kolektive dhe të shndërrohen në një forcë që do të ishte në gjendje të ballafaqohet me forcat e tjera në arenën politike. “Vetëm njeriu mund të bëjë të pamundurën, ai shkoqit dhe peshon, zgjidh dhe gjykon”, - thoshte Gëteja. Të drejtat e njeriut e shpjen të drejtën të një themeli i cili, me gjithë emërtimin që ka, është pa figurë dhe sado absurd të tingëllojë një emërtim i tillë, shenjat për zhvillime të tilla janë të pranishme kudo në botën demokratike. Politikë radikale të udhëheqësve tanë, të legjitimuar nga vetë aktet e kësaj Kushtetute, të prira me sjellje autokratike me parime dhe fantazi makiaveliste për prirje oligarkive, dhe me bindjen ta kthejnë veprimin shoqëror tërësisht në dobi të tyre, në mbrojtje të pozitës së tyre për ics ëndje individësh, është një prirje endemike. E pranojmë se në rrafshin lokal jemi shumicë muslimane, ndërsa në rrafshin e politikës kosovare jemi pakicë e parëndësishme dhe na duhet të heshtim sipas doktrinës filozofike të “Ketmani”-it, e cila lejon mbijetesën për të mbetur gjallë dhe për ta vazhduar “luftën” kur të piqen kushtet. Por, sa duhet prituri???

Në një botë demokratike, raste të tilla (shkelje të të drejtave të njeriut) gjykohen dhe merren si precedentë nga vetë elita, ndërsa në një botë të kufizuar (rasti ynë), sa kohë që njerëzit nuk e ngrenë zërin për ndryshime, serish për ta “kujdeset” elita. Mbi baza të tilla (mosrespektim të të drejtave të njeriut dhe politizimit të tyre), të drejtat e individit dhe shoqërisë

nuk mund të jenë bazë mbi të cilën mund të ngrihet Kushtetuta e re. Baza duhet të jetë garantimi dhe sigurimi i të drejtave kolektive, në qoftë se njëmend pretendohet për të drejta të tilla. Rasti i fundit i diskriminimit mbi baza fetare rreth mbulesës së vajzave muslimane dhe pjesëmarrjes së tyre edhe në shkollat publike, s’ka si të mos merret si diskriminim dhe shkelje e të drejtave themelore të njeriut, rast i izoluar për zgjidhje (sepse në disa shkolla vazhdohet mësimi), si dhe politizim total i situatës. Lideri i popullit është tutor gjeneral i gjithë shoqërisë. Kushtetuta është një “relevatë” e ardhur nga vetë qytetarët. Projektpiloti dhe menaxherët, në bazë të këtij projekti, janë udhëheqësit nga pozicionet që i janë besuar. Pavarësisht se të gjitha këto s’mund të koordinohen nga një Lider dhe të gjitha këto janë të vështira, për të mos thënë të pamundura të udhëhiqen nga një person, është Kushtetuta – relevata që zgjidh çdo çështje dhe problem që paraqitet në shoqëri. Mjafton një kujdes dhe një demonstrim se duam të respektojmë këtë. Nëse do ta parafrazonim edhe Volterin në këtë shkrim, dyshojmë se edhe ai e kishte një problem të kësaj natyre kur pat thënë: “Nuk miratoj veshjen tënde, por do të mbroj deri në vdekje të drejtën tënde për t’u veshur sipas bindjes”. Të tilla pohime do të reprezentonin figurën me kompetencë të plotë të një udhëheqësi që e respekton Kushtetutën, pavarësisht pse nuk pajtohet.

Shoqëria civile kosovare është në kërkim të një udhëheqësi me emrin njeri. Të gjithë janë shndërruar në mbinjerëz duke harruar se asnjë “mbinjeri” i pajisur me forcë “mbinjerëzore” nuk u ngrit në nivelin e arsyes mbinjerëzore, ndërsa sa më shumë që aspirojmë të shndërrohemi në mbinjerëz, aq më çnjerëzor e njeruca bëhemi!



Kirgistani - kur shqiponja b

Kur komunizmi perandorak i Kremlinit dështoi dhe perandoria e madhe u shpërbë, në Kirgistan nisi sulmin një "tjetër pushtues": varfëria dhe mjerimi i madh ishin të atyre përmasave sa vinin në rrezik jetët e njerëzve. Por ndërkohë, kjo situatë rizgjoi instinktin e vjetër të kirgizëve, atë të emigrimit. Kështu një brez i tërë meshkujsh nisi të kërkonte të ardhmen jashtë vendit, jashtë tokës amtare. Kësisoj, vendin e lanë rreth 800 mijë kirgizë nga mosha 18 deri në 35 vjeç. Pikërisht komuniteti i vogël i fshatit të Temir- Kanatit është edhe shembulli më i qartë ilustrues i kësaj boshatisjeje që i është bërë vendit për vite me radhë. Në këtë vend, 75% e banorëve janë larguar përfundimisht nga shtëpitë dhe vetëm një pjesë e vogël kthehet në ato maja herë pas here, kryesisht për të parë pjesëtarët e familjes që kanë lënë pas. Për breza me radhë, jeta në Temir-Kanat, ka rrjedhur në mënyrë të pandryshueshme. Të gjitha ditët njësoj me njëra-tjetrën. Ajo ndodhet në malet Tian Shen dhe fshatarët nomadë që jetojnë aty vazhdojnë me ritualet e zakonshme, të njëjta me ato të gjyshërve e stërgjyshërve: ruajtjen e bagëtive, kultivimin e kuajve dhe gjuetinë e shqiponjave. Ky i fundit është një ushtrim i lashtë, me të cilin vendasit kalojnë kohën dhe kanë përballuar edhe sulmet e pushtuesve të ndryshëm, që kanë qenë të shumtë, duke filluar nga hordhitë mongole e

deri tek ushtritë sovjetike. Në dimër, temperaturat shkojnë deri në ekstrem, nga minus 15 gradë në minus 40 Celsius. Gjithçka mbulohet nga një dëborë e akullt dhe njerëzit izoloohen për muaj me radhë brenda shtëpive, ku konsumohet zakonisht pastërma. Por edhe kjo me shumë kursim, sepse të ardhurat janë të pakta. Një pension për gjyshet dhe gjyshërit nuk i kalon kurrë të 25 dollarët në muaj. Dhe fshati është i mbushur me gjyshe e gjyshër. Kështu vendi, emri i të cilit do të thotë "krahu i hekurt", është shndërruar në një fshat fantazmash. Dhe në të gjithë vendin, zona të tilla të braktisura, me pak banorë, edhe ata të plakur, janë me qindra. Në fakt janë zona të populluara nga mosha ekstreme. Aty ka njerëz shumë pleq dhe shumë të rinj, si fëmijët për shembull. Kjo sepse fëmijët u lihen gjyshërve që merren me rritjen e tyre, ndërkohë që prindërit janë në kërkim të punës gjetkë. Një plakë 74- vjeçare, e veshur kokë e këmbë me rroba leshi shumëngjyrëshe, sipas traditës vendase rrëfen: "Im bir është larguar prej kohësh, për të punuar në qytet. Unë ndërkohë kujdesem për tre fëmijët e tij. Është detyra ime. Im bir nuk më dërgon shpesh para, ndaj rregullohem vetëm me pensionin tim që është 25 dollarë në muaj. Është një situatë e vështirë. Ne hamë vetëm makarona dhe pimë çaj, sepse nuk kam më fuqi që të punoj token dhe të mbjell zarzavate, ose drithëra. Tashmë jeta jonë është e tillë që duhet vetëm të mbijetojmë pa

ndihmën e më të rinjve". Edhe banorë të tjerë të fshatit janë në situata të tilla. Një tjetër plakë e moçme përpigjet që herë pas here të çojë nipërit në shkollë, që të mësojnë të paktën të shkruajnë e të lexojnë. Ata shkojnë në shkollë derisa arrijnë moshën 13-vjeçare e më pas çdo fëmijë konsiderohet i aftë që të nxjerrë vetë bukën e gojës. Dhe e vetmja mënyrë për ta bërë një gjë të tillë është emigracioni, vajtja në qytetet e mëdha, ose jashtë atdheut. Zakonisht profesionet "e preferuara" të kirgizëve meshkuj janë ai i ndërtuesit. Pjesa më e madhe e tyre përbëjnë krahu më të lirë të punës në vendet perëndimore. Ata marrin sa t'u japë pronari, duke e kyçur gojën. Si pasojë e ndryshimit të mënyrës së jetesës kanë filluar të zhduken edhe disa nga traditat më të mira të vendit, ato për të cilat kirgizët kanë qenë krenarë brez pas brezi, si tradita e gjuetisë së shqiponjave dhe skifterëve. Në fakt, bëhet fjalë për shumë më tepër se një gjueti e thjeshtë. Sipas traditës, burrat shkojnë nëpër maja malesh dhe aty marrin zogj të vegjël shqiponjash dhe i sjellin në shtëpi. Aty i rrisin dhe mësohen që të bashkëjetojnë me to për shumë kohë. Të mendosh që jetëgjatësia e një shqiponje është rreth 40 vjet, pra pak a shumë sa një jetë njeriu. Një tjetër traditë shumë e bukur është ajo e lojërave të ndryshme me kuaj. Kuajt e këtyre zonave janë perla të vërteta për nga bukuria, zhdërvjelltësia dhe marrëdhënia e jashtëzakonshme që kanë me të zotët e tyre. Ata trajtohen si njerëz shtëpie dhe kujdesi që u rezervohet shpesh kalon edhe kujdesin për fëmijët. Por braktisja e vendit, kryesisht nga meshkujt, ka bërë që këto tradita të zbehen dhe të shkojnë drejt shuarjes. Në fakt, një situatë e tillë përkraket edhe nga qeveria autokratike e vendit, sepse ikja e njerëzve që kujdesen për kuajt do të thotë dobësim i asaj shtrese që është më e prirë ndaj rebelimeve dhe kryengritjeve. Zakonisht njerëzit e maleve që merren me kuaj e shqiponja janë shumë krenarë dhe të lirë dhe këtë krenari dhe liri e vënë mbi gjithçka tjetër dhe rrezikojnë për ta pasur. Kur ajo u është kërcënuar, shekuj më parë, ata nuk janë hamundur që të ngrenë krye dhe të



Bëhet pulë

luftojnë, edhe duke e ditur se do të vdisnin. Tashmë kushtet ekonomike i kanë detyruar këta njerëz që të lënë vendin dhe të zhbëjnë një traditë të lashtë dhe unike. Bëhet fjalë për tradita shekullore që përcilleshin nga babai te fëmijët, për një traditë që kishte krijuar një lidhje të fortë mes njeriut dhe kafshëve. E kush është sot ai burrë që ka mundësinë të kalojë 40 vjet me radhë me një shqiponjë, me rritjen dhe stërvitjen e saj, apo me një kalë për ta përgatitur për lodra e kalërimet? Prodhimi kombëtar bruto për frymë është 951 dollarë, ndërsa popullsia e vendit prej 5.200.000 banorësh jeton në kushtet e një varfërie të tejkajshme që mund të krahasohet me atë të Haitit dhe Çadit. Por gjatë viteve 2004 – 2008, shumë banorë të vendit, të rinj dhe kryesisht gra, arritën që përmes një pagese 500 dollarëshe të zhvendoseshin



në zonat fushore të vendit, për të punuar në bujqësi, kryesisht në firmat e mëdha të kultivimit e prodhimit të duhanit, ose të emigronin në Rusi. 90 për qind e emigrantëve nga Kirgistani punojnë në kushte të paligjshme, edhe pse shifra e saktë ka shumë mundësi që të jetë më e lartë. Ata që largoheshin, fillimisht, kishin dëshirë që një ditë të riktheheshin në vendin e tyre, por tashmë kjo dëshirë i është venitur pjesës më të madhe, sepse regjimi nuk ka ndryshuar dhe, për më tepër, situata ekonomike është përkeqësuar. Bëhet fjalë për eksodin e pjesës më vitale dhe më aktive të popullsisë, që në fakt e ka zhveshur vendin, si nga krahu i punës, ashtu edhe nga truri. Në vend, në kohën e komunizmit, nuk kishte shtresa. Të gjithë ishin njësoj. Ndërsa tani shoqëria është polarizuar së tepërmi dhe vetëm një pakicë janë super të pasur, ndërsa pjesa dërmuese e popullsisë nuk gjen asgjë të mirë nga qëndrimi në vend. Ndaj edhe pse shumë banorë janë fizikisht në atdhe, mendjen e kanë të ngritur për të ikur. Rosa Kohnyava është gjysmë ruse, gjysmë kirgizase. Ajo është 70 vjeçe dhe kujdeset për katër nipërit e saj. Të bijtë dhe nuset kanë ikur në Rusi për të punuar dhe ajo nuk ka dëgjuar asgjë prej tyre që prej 6 muajsh. Ajo thotë: "Unë i dua ata. Janë nipër kaq të mirë, që më falin shumë dashuri. Ata sjellin vetëm mbarësi, por jetojmë shumë keq, sepse kemi humbur vlerat te të cilat besonim më parë, te liria dhe krenaria e të qenit njerëz të maleve, njerëz të shqiponjave". Gjatë trazirave të muajit të shkuar, presidenti

i vendit Kurmanbek Bakiyev iku në Jug, duke refuzuar dorëheqjen e tij, por duke ofruar bisedime me liderët opozitarë. Një rrugët e kryeqytetit Bishkek ka pasur trazira mes forcave të rendit dhe opozitës, e cila mëton përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në vend.

Së fundi, gjatë këtyre ditëve nëpër rrugët e kryeqytetit Bishkek ka pasur trazira në mes forcave të rendit dhe opozitës, e cila mëton përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në vend. Mijëra uzbekës etnike kanë rendur në kufi për t'u shpëtuar luftimeve të ashpra mes kirgistanëve dhe uzbekëve që po zhvillohen që prej dy ditësh. Sipas të dhënave, lufta nisi mes disa bandave rivale, të cilat u përleshën me armë dhe më pas qindra të rinj u nisën drejt qendrës së qytetit, duke plaçkitur dyqanet dhe thyer dritaret e tyre. Dëshmitarë okularë thonë se betejat me armë vazhdojnë edhe gjatë natës deri në orët e para të mëngjesit dhe se u vihat zjarri shumë makinave. Ministria e Shëndetësisë tha se të paktën 113 njerëz janë vrarë, 92 në Osh dhe 21 në Xhalalabad dhe më shumë se 1.400 janë plagosur nga përleshjet më të egra që nga muaji prill, kur Presidenti i Kirgistanit, Kurmanbek Bakiyev, u rrëzua me forcë nga pushteti. Uzbekët po përpiqen të kalojnë kufirin për në vendet fqinje, por pikat kufitare janë të mbyllura. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq paralajmëroi se gjendja humanitare në Kirgizinë jugore po bëhet 'kritike' pas përleshjeve dhe vrasjeve ndërmjet grupet etnike kirgize dhe uzbekë. ■

Përgatiti: Avni AVDIU

Kirgistani

Kirgistani gjendet në pjesën qendrore të

Azisë, në perëndim të Kinës. Sipërfaqja e përgjithshme e Kirgistanit është 198,500 km², prej së cilës 7,200 km² janë të mbuluara me ujë. Rreth 70% e popullsisë janë kirgizë, uzbekë rreth 14,5% dhe rusë rreth 9%. Religjioni tradicional është Islami sunit. Kirgistani është cilësuar prej kohësh si "Zvicra e Azisë", për shkak të terrenit malor të mrekullueshëm e të virgjër që kufizohet me Kazakistanin, Kinën, Tashikistanin dhe Uzbekistanin. Por përtej majave të bukura e bardhoshe të maleve, toka legjendare e 40 tribuve të Kirgistanit ka shumë pak ngjashmëri me atë të vendit të pasur evropian me të cilin e krahasojnë. Nga Kombet e Bashkuara, ky vend renditet pas Guinesë Ekuatoriale dhe Guajanës për nga shkalla e varfërisë. Kirgistani është vend strategjik, si për Rusinë ashtu edhe për SH.B.A-në, dhe është shtëpi e bazave ushtarake të dy superfuqive.

Librat islam më të shiturit në panair



Hekuran AVDYLI

Panairi i librit i mbajtur në Prishtinë prej 7 deri më 13 qershor i ka bërë të ndahen të pakënaqur shumë shtëpi botuese të librit, pjesëmarrëse në panair. Zbritja prej 20 %, sa ishte zyrtarja e deri në 50 % në disa shtëpi botuese, nuk ka ndikuar që të rritet shitja, përkundrazi sivjet u vërejt një rënie sa i përket si interesimit për pjesëmarrje të klientëve në panair, ashtu edhe shitjes. Dy shtëpitë botuese “Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Shqipërisë” dhe “Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës”, të cilat standat i kishin të vendosura pranë njëra-tjetrës, u ndanë mjaft të pakënaqura me ecurinë e panairit në përgjithësi, e sidomos me shitjen. Përfaqësuesi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë, Mendim Zogaj tha se vizitorët ishin të interesuar për botimet e këtij institucioni, pasi që siç tha ai, botimet e tyre dhe të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Shqipërisë, janë studime me karakter kombëtar, diçka që i dallon nga shtëpitë e tjera botuese por që nuk ndikon në rritjen e shitjes!

Shtëpia Botuese “Toena”, e cila thotë se e ka respektuar njëzet përqindëshin e zbritjes, sa ka qenë e zakonshme për shumicën e shtëpive botuese pjesëmarrëse, por prapë kjo nuk ka ndikuar në interesimin për të blerë libra. Ngjashëm edhe përfaqësuesit e Shtëpisë Botuese “Koha”, të cilët në panair janë shfaqur edhe me promovimin e një libri, thonë se nuk janë të kënaqur me interesimin e lexuesve ose të blerësve këtë vit. Pak më të kënaqur u ndanë Shtëpia Botuese “Dukagjini”, të cilës i është dashur të bëjë zbritje deri në 50 për qind, për literaturën në gjuhën angleze, ndërsa deri 30 për qind për literaturën shqipe. Përfaqësuesit e kësaj shtëpie botuese thonë se në krahasim me vitin e kaluar, interesimi dhe shitja kanë shënuar rënie, mirëpo mbase duke pas parasysh zbritjen pak më të lartë, edhe sivjet nuk ka shkuar

keq me shitjen për këtë shtëpi botuese.

Vlerësime dhe përshtypje krejtësisht të tjera morëm në standat, të cilat në panair kanë marrë pjesë me literaturë islame. Kështu Shtëpia Botuese “Fjala e Bukur” është shprehur mjaft e kënaqur me shitjen që kanë pasur këtë vit, si dhe në përgjithësi me interesimin për këtë lloj literature. Shtëpia botuese “Dituria Islame” është ndarë po ashtu mjaft e kënaqur nga panairi i sivjetmë. Përfaqësuesi i kësaj shtëpie botuese, Fejzal Spahiu tha se këtë vit ka pasur ngritje të shitjes deri në 50 për qind. “Jemi mjaft të kënaqur me panairin e sivjetmë. Përveç literaturës fetare ne kemi marrë pjesë edhe me libra me tematika të tjera, si historike ashtu edhe tema të tjera shoqërore. Po ashtu kemi respektuar edhe zbritjen deri në 30 % të librave”, - tha Spahiu. Shtëpi tjetër botuese, e cila korri sukses me tituj të ri të prezantuar në panair, si dhe me shitje të kënaqshme, është edhe Shtëpia Botuese “Logos A”, nga Shkupi, e cila në panairin e sivjetmë u paraqit me dymbëdhjetë tituj të rinj, me tre komplete të reja librash, si dhe me tre fjalorë sociologjikë të rinj. Kjo shtëpi botuese në panair ka bërë edhe përrurimin e librave të rinj: atë të prof.

Milazim Krasniqit “Letërsia dhe besimet fetare”, dhe të prof. Ibrahim Berishës “Kafazi i frikës”, përrurimin e Fjalorit të Sociologjisë të autorit Ali Pajaziti, si dhe të fjalorit tjetër me emra të bimëve dhe të kafshëve shqip-latinisht dhe latinisht-shqip të autorit Xhevat Lloshi.

Përfaqësuesja e kësaj shtëpie botuese, Selvie Ademi, tregon se libri më i shitur në këtë panair nga kjo shtëpi botuese është ai i autores Sabile Keçmezi-Basha me titull “Të burgosurit politikë shqiptarë në Kosovë 1945-1990”. Edhe kjo shtëpi botuese u nda e pakënaqur me organizimin e sivjetmë të panairit, si dhe me numrin vizitorëve. “Ndarja e objektit të panairit në dy pjesë është shkaku kryesor i mungesës së vizitorëve në pjesën e dytë, dhe kjo me të drejtë pasi që nuk kanë qenë më parë të informuar për shkak të organizimit të dobët”, - tha Selvie Ademi, përfaqësuese e Shtëpisë Botuese “Logos A” nga Shkupi. Përdërisa ka pasur shumë pakënaqësi nga shtëpitë e njohura botuese të Kosovës, në lidhje me numrin e vizitorëve dhe të shitjes së librave, Shtëpia Botuese “Furkan” nga Shkupi, u nda mjaft e kënaqur nga ky panair. Agim Abazi, përfaqësues i kësaj shtëpie botuese, tha se nga pesë





vitet e kaluara sa u bënë gjithsejtë prej se marrin pjesë në këtë panair, ky vit ka qenë viti më i suksesshëm për sa i përket shitjes së librave.

“Në këtë panair jemi prezantuar me 8 tituj të rinj, botime të vitit 2010, si dhe me tri ribotime. Ndërsa nga titujt e ri libri më i shitur është ai i autorit Amër Halid “Derisa të ndryshojmë veten”, duke mos munguar as shitja e librave më të vjetër”, - tha Abazi. Në lidhje me organizimin, Agim Abazi shprehet të jetë i kënaqur pasi që i ka rënë ta ketë stendën në pjesën ku za-

konisht është mbajtur panairi, mirëpo thotë se shpreson të gjendet në të ardhmen një zgjedhje më e logjishme për t'u mos u ndarë panairi në dy pjesë. Shikuar nga këndi i prof. Daut Demakut, Drejtor i Panairit “Pristina 2010”, faktorët për rënien e interesimit për blerjen e librave janë të ndryshëm. Sipas tij, ndër shkaktarët kryesorë janë kushtet ekonomike të banorëve të Kosovës, pastaj vjen në shprehje edhe mungesa e kulturës së leximit, e cila fatkeqësisht, është ende aktualitet për popullin tonë.

“Faktor tjetër ndikues në mosleximin e librit e pastaj rezultues edhe në mos interesim për blerje edhe në këtë panair është edhe digitalizimi që po përjeton bota, sidomos kohëve të fundit, përhapja në masë e internetit dhe e atraksioneve të tjera, të cilat fatkeqësisht e kanë zbehur interesimin për leximin e librit”, - përfundoi Demaku, duke shtuar se sipas tij nuk është faji i organizimit për këtë rënie interesimi e blerje të librave. Ndër eventet interesante të mbajtura në kuadër të aktiviteteve të këtij panairi ishte edhe shënimi i 110 vjetorit të Abetares së Zymit, që është abetarja e parë e botuar në trojet shqiptare në Zym të Prizrenit, në vitin 1900, pastaj përurimi i Abetares Internacionale, produkt i Shtëpisë Botuese “Albas” nga Shqipëria, abetare kjo e digitalizuar dhe e punuar me modele nga vende të ndryshme të Bashkimit Evropian, e cila e bën më të lehtë dhe më atraktive mësimin e shkronjave për fëmijët. ■

RAMIZ ALIA

Jeta ime

Kujtime

BOTIMET TË TRINA

Ndodh edhe kjo

Disa qytetarë të Prishtinës, që merrnin pjesë në Panairin e Librit “Pristina 2010” që u mbajt në Pallatin e Rinisë në kryeqytetin e Kosovës, kanë grisur librin “Jeta Ime” të Ramiz Alisë - ish liderit të fundit komunist në Shqipëri. E tëra kjo ka ndodhur pas deklaratave të Ramiz Alisë që bëri kohëve të fundit, duke e injoruar totalisht Masakrën e Tivarit, ku më 1945 disa udhëheqës të forcave komuniste të Shqipërisë kishin tradhtuar më se 5000 rekrutë të Kosovës dhe trojeve shqiptare dhe i kishin dërguar në kasaphanë të shkakuar nga forcat serbo-malazeze në Tivar të Malit të Zi. Nga ky gjenocid kishin shpëtuar disa rekrutë shqiptarë. Njëri prej tyre që është ende gjallë është plaku Azem Hajdini Xani (85 vjeç) nga Prishtina, i cili kohëve të fundit ka folur për mediat lidhur me ngjarjen e rëndë të Tivarit dhe ka akuzuar drejtpërdrejt se Ramiz Alia dhe Enver Hoxha janë përgjegjësit e kësaj masakre. Dëshmitari Azem Hajdini Xani ka thënë se ish-lideri komunist Ramiz Alia e ka pjesën e tij të përgjegjësisë në këtë masakër. “Ka qenë një tradhti kombëtare. Ramiz Alia duhet të tregojë për këtë masakër”, - ka thënë Azem Hajdini. Azem Hajdini XANI ka shkruar disa libra për ngjarjen e 1945-s si dhe u është drejtuar disa institucioneve për të kërkuar ndriçimin e saj, por nuk ka marrë përgjigje. ■

Përgatiti: F. M.



Kritika - cila është ajo?

Ilir SEFAJ

Krijimet e caktuara letrare dhe jo vetëm letrare, gjithnjë i ka përcjellë edhe kritika ndaj tyre. Nëse iks krijues është shfaqur para lexuesit (dëgjuesit, shikuesit) me një libër, këngë, skenar filmi, regji e të tjera aktivitete si këto, është ballafaquar edhe me vlerësimet që janë dhënë për krijimin e caktuar. Ky është, në esencë, qëllimi i parë dhe final i kritikës.

Me termin kritikë, në një përkufizim më të përgjithësuar, nënkuptojmë vlerësimin. Pra, pse është i mirë ose pse ka vlera një krijim i caktuar dhe e kundërta, pse nuk është në nivel, ose pse është pa vlera një tjetër krijim i caktuar.

Meqenëse përkufizimi mbi kritikën është paksa i përgjithësuar, dhe duke e pasur këtë epitet kërkon një përjasje më përgjithësuese shumëdimensionale, ne sikur do të ngustohemi paksa.

Do flasim mbi kritikën letrare bashkëkohore shqiptare, gjithnjë në linja shumë të ngushta, meqë edhe kjo aventurë kërkon goxha përkushtim, përgjegjësi e njohuri. Faktikisht, formulimi 'mbi kritikën' më shumë mëton të jetë i natyrës polemizuese, inicuese në kuptimin e asaj se nga po shkon kritika letrare sot...

Libra janë botuar gjithnjë, botohen edhe sot. Po ashtu, gjithnjë ka pasur krijime të arrira, deri-diku të arrira, dhe të paarrira. Mirëpo, kritika letrare shqipe sot (sidomos në Kosovë), sikur e ka marrë një dhe të vetmin drejtim: mendoj se mungon një përjasje më objektive ndaj krijimeve të caktuara letrare, në mënyrë që kur të flasim për letërsinë nga lexuesi eventual të konsiderohemi/perceptohemi më kompetent! Shumë kritikë të letrave shqipe sot sikur e

kanë harruar formulën me mjaft domethënie të babait të kritikës sonë, Faik Konica, i cili kur fliste për kritikën letrare ndër të tjera thoshte: "Lyrismi nukë ka punë me kritikën". Gjithnjë sipas kësaj formule, mendoj se duhet bërë ndarja/ dallimi i veprës letrare nga krijuesi i veprës letrare dhe kritiku i veprës letrare, në kuptimin emotiv të tyre, ndërsa në kuptimin e përjasjes (shih. procesit vlerësues ndër-lidhshmërisë) gjithsesi këto të tria janë të ndërlikura dhe vetëm si të tilla japin plotësinë e tyre.

Meqenëse kritiku konsiderohet si njeri me kulturë të gjerë letrare, shenjat e objektivitetit duhet të jenë prezent në formulimet e dhëna mbi veprën letrare, përkundër asaj se nga recipienti i mundshëm çdo formulim konsiderohet vetëm një përshtypje, nëse shprehemi me terminologjinë e estetikës.

Sidoqoftë, jo rrallë ka ngjarë që krijime me një cilësi shumë të varfër kanë fituar epitetin e diçkaje shumë të arrirë. Me këtë fjalor nuk kontribuohet në letërsi dhe në art në përgjithësi. Përkundrazi, vlerësime të tilla e shpien artin në vulgarizim, në kuantitet, duke ua shtuar epshin për t'u marrë me krijime letrare edhe njerëzve që nuk e kanë artin fushë të veprimtarisë së tyre, ose njerëzve që nuk e ndiejnë në palcë një nevojë të tillë.

Formulime të tilla si: një vepër e shkëlqyer, e përmasave universale, kryevepër, vepër model, temë e virgjër, postmoderne etj, etj... kam përshtypjen se janë ekzagjeruar aq shumë saqë kanë kaluar në banalitet.

Nuk krijohen çdo ditë kryevepra. Nuk mund ta marrë epitetin e "veprës model" çdo krijim, çdo vepër... Përfundimisht, kur flasim për kritikën letrare shqipe sot, flasim për kritikën e mikut për mikun, ndërkohë që do të duhej të flitej për kritikën e studiuesit për veprën....■



Promovohet kompleti i librave të Nexhat Ibrahimit

Në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës të Prishtinës, nën organizimin e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, u bë promovimi i kompletit prej 10 librash të Nexhat Ibrahimit, botuar nga shtëpia botuese "Logos-A". Myftiu i Kosovës, Mr. Naim ef. Tërnavë, në fjalën përshëndetëse, shpalosi disa momente nga jeta dhe veprimtaria shkencore e Nexhat Ibrahimit. Gjithashtu, Myftiu Tërnavë tha se përmbajtja e përmbledhjes së veprës së Nexhat Ibrahimit synon transmetimin e mesazhit të Kur'anit të të gjithë njerëzve. Ndërsa, Qemajl Morina, prodekan në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, shpalosi një biografi të shkurtër të autorit Ibrahimit, ku përmendi vitet e burgimit të tij, si i ri aktiv në jetën fetare. Nexhat Ibrahimit, deri tani, ka botuar 85 vepra autoriale dhe 80 libra të përkthyer. Promovimi i kompletit të librave të Nexhat Ibrahimit u bë në 50 vjetorin e lindjes së autorit dhe 10 vjetorin e daljes së tij nga burgu. Ndërsa, autori, Nexhat Ibrahimit, shpalosi disa momente të rëndësishme të kohës kur ka shkruar veprat. Ai, duke mos i fshehur emocionet, tha se kjo paraqet një faqe të re në jetën tonë, kur përveç njohjes së vetvetes, ua ofrojmë edhe të tjerëve këtë mesazh. Ai tha se e keqja individuale dhe kolektive fillon kur mbyllet diskutimi dhe se diversiteti është më se i pranueshëm në Islam. Gjithashtu, Nexhat Ibrahimit shpalosi disa kujtime nga bankat e medresesë e deri më sot, duke thënë: "Në jetën time shkrimi u bë ushqimi, nevoja dhe prehja ime, megjithëse që nga viti 1981-1992 pata shumë arrestime dhe dy vuajtje dënimi me burg". Në fund të këtij promovimi u shtrua edhe një koktej rasti, që shënoi edhe përfundimin e këtij tubimi.

(F. Maloku)

Misteret e fundit të botës



Agim AVDIU

Pesimizëm

Parashikimet apokaliptike kanë qenë modë e kohëve të vjetra. Fatkeqësisht, qeniet njerëzore kanë prirje të investojnë autoritet drejt njerëzve që i bindin se janë “ekspertë” profecish, ose se kanë ndonjë njohuri të fshehur që të tjerët s’e kanë, e që i lejon ata të lexojnë të ardhmen. Sipas kalendarit të Majave, toka do të marrë fund rreth 21 dhjetorit 2012. Pra sipas kësaj na mbeten edhe më pak se dy vjet jetë në këtë tokë. “Toka është djepi i njerëzimit, por njeriu nuk mund të jetojë përjetësisht në djepin e tij”, - shkruante Konstantin Tsiolkovsky, shkencëtar rus në fillim të shekullit XX, duke paralajmëruar nisjen e qenieve njerëzore drejt planetëve të tjerë. Nëse na ka mbetur pak jetë këtu, duhet lipsur diku tjetër. Mirëpo ku, se?! Sipas dy astrofizikanëve, Roger Maurice Bonnet-it, president i “Cospar”, Komiteti për Kërkimet Hapësinor dhe Lodewijk Woltjer-it, nuk ekziston një tokë tjetër ku do të mund të transferoheshim. Duhet të qëndrojmë këtu ku jemi, në këtë planet, duke u përpjekur të kapërcejmë çdo problem që del. Pra, nuk mund të lëvizim që këtu. Por cilat janë rreziqet që na kanosen dhe a mund t’u bëjmë ballë atyre? Është e mundur që të verifikohen përplasjet me asteroide të mëdhenj, por sot ka më pak trupa qiellorë të rrezikshëm sesa në kohërat e para të sistemit diellor. Gjithsesi, një përplasje me një meteor mund të parashikohet dhe më pas të ndërhyhet duke i devijuar trajektoren. Për sa u përket rreziqeve të tjera kozmike, si ndryshimi i fushës magnetike tokësore, ose futja e sistemit diellor në një krah të ri të galaktikës, gjithçka ka ndodhur, por nuk ka pasur katastrofa. Sigurisht nga pikëpamja gjeologjike, toka mund të fshehtë edhe ndonjë surprizë të pakëndshme, të tipit supershpërthime vullkanike. Rast në vete është edhe ngrohja globale dhe

efektet e saj. Disa pretendojnë se tokës po i vjen fundi dhe se njerëzimi do të marrë fund si rezultat i ndryshimeve klimatike të shkaktuara nga vetë njeriu. Sipas kësaj teorie do të shkrijnë akujt në pole dhe do të rritet niveli i oqeanëve dhe deteve. Ndryshimi i klimës do të ndryshojë dhe jetesën në planet. Problemi kryesor është se në Tokë po shterojnë të gjitha burimet natyrore. Brenda 60 vjetëve nuk do të kemi më naftë, madje edhe rezervat e mineraleve të tjera do të jenë ezauruar. E gjitha kjo është rezultat i një rritjeje demografike pa precedent dhe e zhvillimit industrial që e ka shoqëruar. Sot popullsia e botës është 6 miliardë banorë dhe është parashikuar që do të arrijë në 9.4 miliardë brenda vitit 2050, për të vazhduar me 11 miliardë rreth vitit 2200. Dhe bota nuk mund të mbajë 11 miliardë banorë, me një mënyrë jetese si ajo evropiane. Veç të tjerash, rritja e popullsisë është një nga shkaqet e ngrohjes globale. Edhe nëse do të merreshin menjëherë masa drastike, fenomeni do të vazhdonte për inerci për dhjetëra vjet.

Optimizëm

Por ka disa arsye që mund të na japin shpresë se jeta jonë do të vazhdojë edhe pas vitit 2012, të cilat kundërshtojnë pikërisht arsyet se pse bota do të marrë fund në këtë vit. Në radhë të parë sepse ndryshimi i poleve magnetike nuk është katastrofik. Duket se qindra mijëra vjet më parë fusha magnetike e tokës u reduktua në thuajse asgjë e më

pas u rishfaq gradualisht ndërkohë që poli i veriut dhe i jugut u zhvendosën. Kjo zhvendosje nuk është veçanërisht e rrezikshme, por mungesa e fushës magnetike mund të dëmtojë jetën në planet sepse zgjatja e periudhës së pakësimit të mbrojtjes magnetike lejon stuhitë meteorike dhe rrezet kozmike të diellit të godasin atmosferën e tokës. Por shkencëtarët kanë arritur në përfundimin se ne e kemi kaluar një ngjarje të tillë dhe kanë vënë re se fusha jonë magnetike është rritur me pesë për qind në shekullin e shkuar, ndaj dhe ka kohë që cikli të përfundojë. Pra është diçka për të cilën s’kemi pse të shqetësohemi për disa qindra mijëra vjet. Rritja e aktivitetit të njollave të diellit në vitin 2012 nuk do ketë ndonjë efekt të dëmshëm në planetin tonë. Siç e di çdo nxënës shkolle, dielli ynë nxjerr vazhdimisht shtëllunga gazi plazme të nxehtë prej mijëra kilometrash në hapësirë, të cilat atmosfera jonë i mban larg prej nesh. Nganjëherë, këto shtëllunga janë më të mëdha se normalja, por gjithsesi janë ato që ne i quajmë flakërima diellorë. Fatmirësisht, këto shpërthime të mëdha magnetike që bombardojnë tokën me një rrekë grimcash subatomike shkrihen nga atmosfera e planetit dhe fusha magnetike, ndaj ne rrallë i ndiejmë efektet e shpërthimeve plazmike, përveç rritjes së shkëlqimit të dritave të Veriut dhe Aurorës Borealis, sepse polet e tokës nuk zhvendosen dhe as orbita e planetit nuk shformohet. Disa individë pretendojnë se polet fizike të planetit





janë gati të ndërrojnë vend ose se forcat gravitacionale të planetëve të tjerë mund të ndikojnë tek orbita e tokës dhe kjo mund të ndryshojë klimën dhe mjedisin. Fatmirësisht, forcat gravitacionale që ndikojnë në planetin tonë dhe vendin e tij në sistemin diellor janë konform ligjeve të Njutonit mbi mekanikën planetare dhe nuk mund të ndryshojnë pa ndonjë ngjarje ekstremisht dramatike, që mund të ndodhë në miliarda vjet, siç është përplasja e një hëne të vogël, ose një gropë e zezë masive që mbërrin në sistemin diellor, gjë që do dihej shumë më përpara se të ndodhte, sepse avancimi do ishte aq gradual sa do të duheshin shekuj për të krijuar një impakt. Ndryshimi i klimës së tokës është një proces gradual, me të cilin jetesa adaptohet përgjatë rrugës.


Realizëm

Gjithsesi ideja është se askush nuk e di se çfarë rezervon për ne e ardhmja, nëse s'kanë një gradë shkencore për ta ditur. Sepse toka nuk shkatërrohet aq lehtë. Sigurisht që ka shumë gjëra që mund ta vënë për fundi planetin tonë, por në fakt toka është shumë herë më e fortë sesa pretendohet prej disave. Mos të harrojmë se ajo s'ka lëvizur nga vendi i saj për miliarda vjet, duke duruar ndryshime klimaterike e madje i ka mbijetuar dhe përplasjes me një planet tjetër që krijoi dhe hënën tonë e sërish vazhdon të funksionojë. Ndaj s'mund të mendojmë se shkrirja e akujve në pole dhe disa armë bërthamore mund ta shkatërrojnë.

Profecitë e fundit të botës gjithnjë kanë rezultuar të rreme. Deri tani ka pasur me qindra data që janë zgjedhur për të shënuar fundin e botës. Mirëpo, të gjitha rezultuan të dështuara, sepse fundin e tokës mund ta dijë vetëm Ai që e ka krijuar atë e jo krijesat e saj. ■

Rrethina e Malishevës

Temperaturat e larta ndikojnë në shfaqjen e etheve hemorragjike dhe tani veç jemi në fillimin e sezonit të shfaqjes së tyre. Rajoni më i prekur prej kësaj sëmundje, ai i Malishevës, është më i preokupuari me këtë problematikë. Qershori i këtij viti regjistron vdekjen e tretë nga kjo sëmundje në këtë rajon dhe një rast nga Gjakova.



Artan N. BEJTA

Temperaturat e larta ndikojnë në shfaqjen e etheve hemorragjike dhe tani veç jemi në fillimin e sezonit të shfaqjes së tyre. Ethet hemorragjike janë sëmundje të kamotshme në vendin tonë dhe zanafillën e tyre e kanë afërsisht nga viti 1986. Ato kanë filluar të shfaqen në forma sporadike dhe me shpërthime epidemike. Epidemitë e këtyre sëmundjeve në Kosovë janë paraqitur disa herë, duke filluar në vitin 1986, pastaj 1989, 1995 2001, 2004 dhe 2005. Këto janë sëmundje mjaft të rrezikshme, duke marrë parasysh vdekshmërinë e lartë të tyre.

Ekzistojnë disa sëmundje në grupin e etheve hemorragjike. Në vende të ndryshme të botës janë të njohura 12 lloje, edhe pse në Kosovë deri më tani, fatmirësisht, janë të njohura vetëm dy tipa: **ethet hemorragjike me sindromë veshkore** ose populli e njej si ethe të minjve dhe **ethet hemorragjike krime kongo** ose ethja e rriqrave.

Këto sëmundje përfshijnë afro 60 për qind e territorit të Kosovës, me një vdekshmëri të lartë. Fatmirësisht, këto sëmundje janë të lidhura ngushtë me faktorët ekologjikë e klimatikë të vatrave natyrore. Kjo arsyeton faktin se këto sëmundje kanë karakter sezonal, duke bërë që këto të paraqiten kryesisht në muajt e ngrohtë të vitit.

Ethet e rriqrave kanë sezonalitet më të hershëm dhe infeksioni në mesin e njerëzve fillon zakonisht nga fundi i muajit prill, për të vazhduar në muajt maj-korrik. Ndërsa ethet e minjve fillojnë të shfaqen diku nga qershori, korriku, gushti e deri në shtator a tetor.

Kushtet gjeografike dhe klimatike të një vendi janë të ndërlidhura ngushtë

me këto sëmundje. Nga kjo përcaktohen edhe zonat endemike të infeksionit, p.sh. ethet hemorragjike të rriqrave ose krime kongo, përfshijnë kryesisht Kosovën qendrore, prandaj edhe në vitin e kaluar ka pasur një numër të madh të rasteve, gjithsej 125 raste të hospitalizuara, prej tyre 5 raste vdekjesh (4 nga ethet e rriqrave dhe 1 nga ethet e minjve).

Ethet hemorragjike krime kongo

Shkaktari i sëmundjes është një virus (i llojit Nairovirus që bën pjesë në familjen Bonyaviridae; së pari është zbuluar në Crimea më 1944, më vonë është gjetur edhe në Congo më 1969, nga ka marrë emrin). Jeton në shtazë të ndryshme si lepuj të egër, disa lloje të zogjve dhe rriqra. Gjendet përkohësisht në shtazë shtëpiake si: lopë, dele, dhi, kuaj, etj. Rriqrat *Hyaloma* kanë rezervuar dhe vektorë të virusit krime-kongo. Është sëmundje ngjitëse e rrezikshme, me vdekshmëri të lartë dhe fillon në mënyrë të shpejtë, me temperaturë dhe me ethe. Si bartës të etheve hemorragjike krime kongo janë rriqrat, të cilat zakonisht gjenden në vendet me një lartësi mbidetare 400-1000 metra. Kjo është zonë blegtorale, e pasura me kullosa d.m.th. bujqësore, pyje të vogla dhe lumenj.

Ethet hemorragjike krime kongo (ethet hemorragjike të rriqrave) përfshijnë më tepër komunën e Malishevës, Drenasit, Klinës, Skenderajt, fshatrat përreth brigjeve të lumit Drin, Therandën, rajonet e Hasit, Rahovecit



nis "luftën" me rriqrat

dhe Prizrenit. Rajonet e tjera janë më pak të prekura dhe me raste sporadike.

Cilat janë shenjat e sëmundjes?

Në fillim shfaqet skuqja e fytyrës, e shoqëruar me skuqje të gjoksit dhe të syve, e më vonë, pasi sëmundja përparon paraqitet gjakderdhja, fillimisht në mucozë (gojë, hundë) si dhe në lëkurë në pjesën e barkut, kraharorit e deri në shpinë. Në fazat e mëvonshme i sëmurit ka gjakderdhje me intensitet të madh nga të gjitha vrimat e trupit.

Si infektohet njeriu nga kjo sëmundje?

Infektimi nga kjo sëmundje, më së shpeshti, ndodh nga pickimi i llojeve të ndryshme të rriqrave, që përmbajnë në vete shkaktarin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK). Po ashtu, nuk janë të rralla edhe infektimet përmes kontaktit me gjakun e njeriut të sëmurë nga kjo sëmundje. Më të rralla janë të njohura edhe mënyra të tjera të infektimit me këtë virus: me ndrydhjen e rriqrës, me këputjen e trupit të rriqrës gjatë nxjerrjes nga lëkura e shtazës dhe me prerjen e rriqrës gjatë qethjes së deleve. Vlen të përmendim se sëmundja përcillet nga njeriu i sëmurë tek i shëndoshi, zakonisht tek ata persona që përkujdesen për të sëmurin, si familjarët ose edhe personeli shëndetësor.

Trajtimi është kryesisht simptomatik. *Ribavarina* është mjaft e efektshme. Në rastet e shokut hemorragjik luftohet me dhënien e gjakut.

Mbrojtja:

Ikja nga kontakti me rriqrat. Rriqrat luftohen me Dietil-mtoluanide. Te personat që mund të jenë në kontakt me rriqra këshillohet përdorimi i masave mbrojtëse (dorëza, roba mbrojtëse, etj.)

Ethet hemorragjike me sindromë veshkore ose ethet e minjve

Është lloji i dytë i etheve hemorragjike që është prezent edhe te ne. Shkaktohet nga viruset (hantavirusë



- familja Bonyaviridae). Si burim infektionit, më së shpeshti, janë minjtë e pyllit dhe të fushës. Për këtë, në popull, kjo sëmundje njihet edhe si "ethet e minjve". Minjtë dhe brejtësit në përgjithësi nuk shfaqin shenja të sëmundjes. Ata janë bartës të shkaktarit të kësaj sëmundje dhe e eliminojnë këtë shkaktar me anë të feçeve, urinës, pështymës, duke e rrezikuar njeriun që të infektohet po të bie në kontakt me to. Kjo sëmundje infektive është e përhapur në zonat malore me lartësi mbidetare 500-2000 metra.

Ethet hemorragjike me sindromë veshkore (Ethet e Minjve) kanë një shtrirje krejt tjetër nga ajo e etheve hemorragjike krime kongo dhe përfshijnë kryesisht fshatrat rrëzë maleve të bjeshkëve të Dukagjinit, duke filluar nga fshatrat e rrethit të Burimit, Pejës, Deçanit, Gjakovës, e deri te Prizreni. Po ashtu, raste më të rralla janë paraqitur edhe në brigjet e liqenit të Batllavës, fshatra të Ferizajt dhe Kaçanikut. Këtë e arsyeon fakti që në këto zona kushtet klimatike janë të tilla që i përshtaten jetesës së bartësve (minjve dhe brejtësve) të sëmundjes.




Si arrihet deri tek infektimi i njeriut?

Deri tek infektimi i njeriut arrihet kur njeriu është në kontakt me minjtë dhe me gjësendet të cilat ata i kanë kontaminuar me feçet ose urinën e tyre. E kjo zakonisht ndodh gjatë punëve në fshat, në pyje, gjatë kampingut, gjatë gjuetisë, si edhe gjatë kërkimit të frutave të pyllit, siç janë dredhëzat, kërpudhat, ose edhe fruta dhe bimë të tjera të ndryshme.

Shenjat e sëmundjes

Paraqitjen e kësaj sëmundje e karakterizon temperatura e lartë. Kjo temperaturë, zakonisht, është e shoqëruar me ethe, plogështi, marramendje, dhimbje koke, humbje oreksi, vjellje, e në stadet më të avancuara të kësaj sëmundje



paraqiten gjakderdhje, si dhe dëmtim i veshkave, dëmtim i cili mund të jetë aq i rëndë saqë mund të çojë deri te bllokimi i punës së tyre, e të përfundojë në mënyrë fatale. Vlen të ceket se sëmundja nuk përhapet nga njeriu tek njeriu.

Trajtimi: Zakonisht është simptomatik, edhe pse tek ethet hemorragjike me sindromë veshkore Renal Ribavirina (bar antiviral) ka treguar efekt të mirë të disa pacientë. ■

Mbrojtja:

Kontrollimi i popullacionit të brejtësve, eliminimi i tyre nga shtëpitë. Shmangia e kontaktit me urinë, feçe, pështymë dhe strofuj të brejtësve.

Historiku i botërorëve nga viti 1930-2006

Brazili me pesë tituj të fituar, ndërsa pas tij pason Italia me katër tituj të fituar, Gjermania me tre tituj, Argjentina dy tituj, Uruguai dy tituj, Franca një titull dhe Anglia një titull.

Dilaver POLISI

Historiku i botërorëve të futbollit fillon në vitin 1930, në Uruguai.

Më së shumti tituj në kampionatet botërore ka Brazili me 5 tituj të fituar, pas tij vjen Italia me 4 tituj të fituar, Gjermania me 3 tituj, Argjentina 2 tituj, Uruguai 2 tituj, Franca 1 titull dhe Anglia 1 titull.

Kupa e Botës në futboll për herë të parë i takoi Urugait, pasi mposhti Argjentinën në finale me rezultatin 4:2. Në gazetën "Gazzeta dello Sport", më 31 korrik 1930, lajmi për finalen e botërorit u dha nga një artikull i vogël me një titull që thoshte: "Urugai fiton kampionatin e Montevideos duke mundur Argjentinën 4-2".

Katër vjet më vonë përkatësisht në vitin 1935, organizatore e kampionatit botëror ishte Italia, pasi vitin e parë të botërorit nuk mori pjesë. Këtë vit e mori seriozisht dhe njëherësh u shpall edhe fituese duke fituar në finale, në Romë, me rezultat të ngushtë 2:1. Edhe katër vjet më pas, Italia sërish i gëzohet kupës së botës pasi në finalen e vitit 1938 mposhti Hungarinë në finale me rezultat 4:2. Italianët, përballë hungarezëve, me të vërtetë ishin më të fortë dhe iu gëzuan me meritë këtij titulli.

Organizator i kampionatit botëror në vitin 1950 ishte Brazili, i cili nuk kishte fat ta fitonte atë vit, pasi këtë gjë ia pamundësoi Uruguai, i cili e mposhti me rezultat të ngushtë 2:1.

Kampionati i pestë i botës u zhvillua në Zvicër, në vitin 1954. Ishte viti ku Gjermania Perëndimore e asaj kohe u shpall kampion e botës. Pas shkatërrimeve të luftës, megjithatë ajo arriti të shpallet kampion bote, pasi në filane e mposhti Hungarinë me rezultatin 3:2.

Pas katër vjetëve, përkatësisht në vitin 1958, Kampionati Botëror sa vinte e bëhej më shumë interesant dhe më i shikuar. Ky

vit i takoi Brazilit pasi në finale mundi Suedinë me rezultatin 5:2. Pele shënoi dy herë në finale për t'i ndihmuar kombëtares së Brazilit ta fitonte botërorin.

Edhe pas katër vjetëve (1962), Brazili u shpall sërish kampion bote, këtë herë viktima ishte kombëtarja e Çekosllovakisë, e cila u mposht me rezultatin 3:1.

Kampionati botëror i vitit 1966 u mbajt në Angli. Aty edhe ku filloi futbollit, aty ku për herë të parë në historinë e futbollit u zbulua loja me këmbë. Mikpritësi i këtij kampionati njëherësh shpallet edhe kampion pasi në finale mposhti Gjermaninë P. me rezultatin 4:2. Më të dalluarit e këtij botërori ishin portieri Benks, mbrojtësi i lirë More dhe qendërsulmuesi Çarlton.

Meksika ishte mikpritëse e vitit 1970. Brazili ishte i thyeshëm në mbrojtje, por i pathyeshëm në sulm. Kombëtarja e Brazilit ishte ajo e cila këto vite mbi-zotëronte në të gjitha aspektet, si taktike ashtu edhe teknike, dhe e cila e mposhti bindshëm Italinë në finale 4:1.

Gjermania P. u shpall kampion e botës në vitin 1974, duke e mundur kombëtaren e Holandës me rezultatin 2:1. Ajo njëherësh ishte edhe organizatorja e këtij kampionati.

'Më tepër evropian sesa amerikano-jugor në stil loje, domethënë më konkret sesa artistik', - për të fituar duhesh të luash kështu dhe Argjentina ia doli kësaj në vitin 1978, pasi e mposhti Holandën në finale 3:1. Argjentinasi ishin mikpritës të shtëpisë dhe kampionë të botës.

Kujtojmë një dhënie të Bearxotit duke ia kujtuar Selvaxhit, lojtarit të 22-të të Kombëtares së Italisë: "Merre me vete valixhen, por këpucët lëri në shtëpi". Ishte kjo kur në vitin 1982 u zhvillua kampionati botëror i vitit 1982 në Spanjë. Italia ishte fituese e këtij kampionati pasi në finale mposhti Gjermaninë 3:1. Ndërsa të nesërmen shkruhej nëpër gazetë italiane "Campioni del mondo!".

Argjentina ishte fituese e vitit 1986,

pasi në përballje me Gjermaninë fitoi me rezultatin 3:2, ndeshje e cila u mbajt në Meksikë.

Italia ishte organizatore e vitit 1990, por nuk kishte fat ta fitonte kampionatin. Gjermania ishte ajo e cila e fitoi pasi në finale e mposhti Argjentinën 1:0.


Në vitin 1994, SHBA ishte organizatore e botërorit dhe në këtë kampionat ishin penalltitë që vendosën fituesin. Brazili triumfon për herë të katërt në një botëror dhe këtë e bën kundër Italisë që e mposhti me penallti pas përfundimit të 120 minutave.

Franca ishte fituese e kampionatit botëror në vitin 1998, e cila në finale mposhti bindshëm Brazilin 3:0. Ylli i këtij viti ishte Zinedine Zidane, i cili me "klasën" e tij bëri për vete shumë adhurues.

Botërori 2002 u mbajt në Kore-Japoni. Ndërsa në finale të këtij kampionati u ndeshen dy kombëtares gjigante të futbollit. Brazili arriti të fitonte për të pestën herë që nga botërori i parë, pasi në finale mposhti Gjermaninë me rezultatin 2:0. Ronaldo ishte golashënues i dyfishtë për Brazilin, njëkohësisht edhe golashënuesi më i mirë i botërorit, me 8 gola të realizuara.

Në vitin 2006, organizatore e kampionatit botëror ishte Gjermania. Fituese në këtë vit ishte kombëtarja e Italisë, pasi në finale ajo e mposhti Francën, pas përfundimit të 120 minutave, me penallti 5:4, pasi koha e rregullt kishte përfunduar baras 1:1. Golashënuesi më i mirë u zgjodh sulmuesi i Gjermanisë, Miroslav Klose, ndërsa epiteti i lojtarit më të mirë iu dha Zinedine Zidane.

Të shpresojmë që edhe kampionati botëror i vitit 2010, "Afrika e Jugut 2010", do të na dhurojë kënaqësi dhe emocione. Duhet cekur se Afrika e Jugut do të jetë shteti i parë nga kontinenti i Afrikës që do të organizojë botëror të futbollit. Botërori do të mbahet në këtë vend nga 11 qershori deri më 11 korrik. ■



Xhamia në Sevilje, pronë e një futbollisti



Alban BILALLI

Futbollisti nga Mali, Frederik Kanute, ka paguar më shumë se 700.000 dollarë nga xhepi i tij për të blerë një xhami në Sevilje. Në fakt, kontrata në tokën ku ishte ndërtuar xhamia kishte përfunduar dhe komuna e kishte vënë në shitje tokën, por Kanute i pagoi të gjitha paratë dhe xhamia shpëtoi nga shitja, e ndoshta edhe nga rrënimi, sepse ka pasur shumë të interesuar për ta blerë tokën ku ishte vendosur xhamia. Muslimanët në qytetin e Seviljes e vlerësojnë shumë lart këtë gjest të Kanutes. "Po të mos ishte Kanute, atëherë ne nuk do të kishim pasur një xhami për t'u falur ditën e premte, e cila është dita më e shenjtë e javës për muslimanët," - ka thënë një zëdhënës i Bashkësisë Islame të Spanjës. Xhamia në qytetin e Seviljes është në emër të Kanutes. Sipas zyrtarëve të komunës, xhamia është pronë e Kanutes dhe është regjistruar në emër të tij. Lidhur me këtë gjest të tij, Kanute nuk ka folur kurrë.

Kanute njihet jo vetëm si futbollist, por edhe si musliman shumë i devotshëm. Ai qysh nga mosha 20 vjeçare ka filluar praktikimin e fesë islame. Islamin ai e çmon shumë lart, sepse i ka ndihmuar shumë gjatë jetës së tij. "Islami më ka ndihmuar mua që të jem ky që jam. Islami është një rrugë që të mban në gjendje normale, që të mban të qetë, që të ndihmon të mendoni për vendin ku jetoni, për fqinjën tënd dhe për njerëzit që jetojnë me të", - ka thënë Kanute.

Ai, edhe pse është i zënë me përgatitjet për futbollin, prapëseprapë gjen kohë për namaz. "Po, unë gjej një vend të qetë dhe lutem. Ndonjëherë shokët e mi më shohin duke u falur, por ata e dinë se unë jam musliman. Ata e kuptojnë dhe e respektojnë këtë dhe janë të çuditshëm, sidomos kur vjen Ramazani. Ata më py-

esin pse unë nuk ha dhe më bëjnë shumë pyetje të tjera".


Njeri humanitar

Në vitin 2006, ai nisi një apel për të krijuar "Fshatin e fëmijëve" në Mali. "Kur unë kam qenë nëpër rrugët e Bamakos (kryeqytet i Malit), kam parë fëmijë të dëshpëruar e të varfër, kështu që kam kërkuar për t'u ndihmuar atyre. Këtë ide e kam pasur për shumë kohë dhe kam kërkuar të bëj punë bamirësie," - ka thënë Kanute.

Kanute ka refuzuar të veshë një këmishë në klubin e tij Sevilla, që mbante emrin "888.com" që ishte sponsor i klubit, për shkak të faktit se ky sponsor është i njohur për lojën e pokerit në internet, lojë e fatit, e cila është kundër parimeve të Islamit. Klubi kishte vendosur t'i jepte atij një fanellë pa markë çdo ndeshje. Kompania, megjithatë, ra dakord që disa nga fitimet me reklama t'i japë për "Fshatin e fëmijëve" në Mali, që ishte themeluar nga vetë Kanute.

Gol për Palestinën

Më 7 janar 2009, në një ndeshje kundër Deportivo La Coruna, kur shënoi gol, Kanute hoqi fanellën e tij dhe u shfaq me një këmishë të zezë ku ishte e shkruar fjala "Palestinë". Ky veprim u interpretua nga burimet si një protestë kundër sulmeve izraelite në Rripin e Gazës. Kanute u ndëshkua me një karton të verdhë për këtë gjest me mesazh politik dhe u gjobit më pas me








rreth 4.000 dollarë nga Federata e Futbollit të Spanjës. Ai, për këtë gjest, fitoi përkrahje të madhe nga muslimanët e gjithë botës. Madje disa analistë e ish-futbollistë e mbrojtën Kanuten për këtë veprim dhe u habitën me vendimin e federatës spanjolle, ngase edhe shumë futbollistë të tjerë shfaqin mesazhe të ndryshme gjatë festimit të golave dhe nuk ndëshkohen për këtë.

Kush është Kanute?

Frederik Kanute është futbollist nga Mali dhe luan për klubin Sevilla, në Spanjë. Kanute u lind më 2 shtator të vitit 1977, në Lion të Francës. Karrierën prej sulmuesi e nisi në klubin e qytetit të Lionit, në Olimpik Lion. Pas tri viteve në këtë klub, ai kaloi në Angli te Vest Ham United. Për këtë klub, Kanute zhvilloi 84 ndeshje, duke shënuar 29 gola. Dy vite luajti edhe për klubin tjetër londinez, Totenhemin, klub me të cilin zhvilloi 60 ndeshje, ku shënoi 14 gola. Në vitin 2005 kaloi në Spanjë te klubi i Seviljes. Ai është ende futbollist i këtij klubi, madje njëri ndër më të mirët. Për Malin ka zhvilluar 38 ndeshje dhe ka shënuar 23 gola.

Është i njohur për ritmin, forcën dhe teknikën e tij. Më 2 shkurt 2008, u shpall Futbollisti Afrikan i Vitit dhe është i pari lojtar i lindur jashtë kontinentit afrikan që e fiton këtë titull. ■

Autor: Agim Gashi	SHUMË I GJATË	MUZIKA E SHTHURUR	KOMPO- ZITORI, RUDI (shq.)	AKTORJA, PAPAS	VEND NË INDI	PËREMËR VETOR	KËSTI I PAGESËS	ITALIA		ABDYL FRASHËRI	THELLA E HOLLË E MISHIT	MËNJANIMI	NOVACION	SULMIMI			
DETARI									SKANDALI ----- TUFË DHENSH								
LLOJ BISKOTE								TORTUROJ ----- EKREMI (dim.)									
PUNIMET E GJATA SHKENCORE										DRURË TË GJATË ----- DANI ALVESH							
MEJDANI						TITULL DIJETARI ----- 1 ROMAK											
ELEMENT KIMIK							MËRIA, MARAZI, SMIRA						INDUKSIONI ----- I PAKËT NGA TRUPI				
PERSONAZHI NË FOTO Fatmir Spahiu				MIKRO- BORGJEZ						ANESË							
NATRIUMI		FRANCA ----- KAMERA- MANET											I AFËRMI ----- I UJITUR				
PERLË												KËNGËT. SUMAK (pashq.)					I PËLQYER
GATI TË BINDEM												KOMUNË JONA (pashq.)					
 NUMËR RENDOR ----- DESPOTIKE													AMPERI		GRUP GJAKU ----- PASTRUES HOTELESH		
QYTET NË ÇEKI													ZAKON, ADET				
INTERNETI		EDHE (lat.) ----- KURSIV											IDENTITETI				GRAMI ----- LLOJ SHALE
RRËQE- BULLI									... DHE PRAKTIKË	KASA	1000 KG		QERIM (varinat)	LLOJ GOTE METALIKE (sh.pashq.) ----- REPUBLIKA			
PËRPJEKJE PËR TË VRARË												BANOR I KRUIJËS ----- KRYEQYTETI ITALIAN					
NATALI (dim.)				FLLADITËSE ----- HARTË (ang.)										MEMORJA E KOMPJUT. ----- PJATA			
IRMA LIBOHOVA			LLOJ DHE GËLQEROR ----- TITANI								TITULL ETIOPAS ----- FLORI						
VEGËL MUZIKORE ME TELA							MJET PLASËS ----- GJERMANIA					RUTENI ----- ZANORE					
SKUADRA						ENA E GJAKUT							REOMIRI				

PAQJA

REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË



SHTOJCË PËR PROBLEMATIKËN E GJYQËSORIT NË KOSOVË

Kosova – saraj i përmbytur në



Sabri HALILI

Drejtësia në Kosovë është fushë atraktive me gjetje të pashtershme për një gazetar, gjegjësisht një hulumtues të pavarur. Kjo për faktin se zhvillimet e përgjithshme në këtë fushë janë në dekadencë të vazhdueshme. Për këtë shkak edhe informacionet, që mund të plasohen në opinion nga kjo fushë, janë me shumicë negative. Zhvillimet negative janë të shtrësuar edhe në vetë sistemin e drejtësisë, brendapërbrenda saj. Ky segment është i mbarsur me elemente shumë korruptuese, me dezorganizim total, me një kolaps të llojit të vet, me shantazhe të aktorëve të brendshëm, me mungesë të etikës gjyqësore dhe me mungesë të profesionalizmit, me një mentalitet nga e kaluara dhe me relikte të asaj të kaluarë, që për dikë ishte e hidhur, e për dikë, “ktheje Zot edhe njëherë atë sistem”.

Pos këtyre aspekteve negative, brendapërbrenda, ky sistem është i atakuar edhe nga faktorë të jashtëm, me refleksione politiko-partiake dhe klanore, në forma të ndryshme.

Gjendja aktuale në drejtësi, kaotike...

Gjendja e rëndë, që po mbretëron tash 10 vjet në sistemin e drejtësisë së Kosovës, është e njohur për të gjithë bartësit e pushtetit në Kosovë, vendorë e ndërkombëtarë. Të gjithë flasin e nxjerrin lot krokodili për këtë gjendje dhe askush nuk bën asgjë për ta ndryshuar këtë situatë, për ta vënë në trende pozitive, edhe pse ka pasur dhe ka mundësi të shumta. Çdo vonesë në fillimin e mëkëmbjes së këtij sistemi çon ujë vetëm në mullirin e anarkistëve, të kriminelëve dhe përkrahësve të tyre, qoftë institucionale ose jashtë institucionale. Dhe, siç është vërtetuar deri tash, ata janë të shumtë dhe të fuqishëm.

Një fjalë e urtë thotë se “edhe gërmadhat ku sundon drejtësia janë më të vlefshme se sarajet. Sarajet e mbytura

Kosova është bërë një saraj i mbytur nga krimi dhe padrejtësia. Kjo gjendje nuk i konvenon asnjë njeriu të ndershëm në këto hapësira.

në dhunë dhe padrejtësi janë më gërmadhe se gërmadhat”. Është e qartë se Kosova është bërë një saraj i mbytur nga krimi dhe nga padrejtësia, andaj kjo nuk i konvenon asnjë njeriu të ndershëm në këto hapësira.

Kur flitet për gjendjen në drejtësinë kosovare, shumëkujt i shkon mendja te veriu, siç e quajten disa, “i egër” i Kosovës. Atje mbretëron kaosi, mbisundon krimi dhe paligjshmëria. Të gjithë e kanë të qartë se ajo gjendje atje është si refleksion i politikës ditore dhe refleksion i një të kaluarë të dhimbshme që ka kaluar Kosova dhjetë vjet më parë. Megjithatë, nëse rezonojmë si qytetarë të zakonshëm dhe apolitikë, shohim se drejtësia nuk funksionon as në pjesë të tjera të Kosovës, gjegjësisht në zemër të Kosovës. Gjithashtu, duhet ta kuptojmë se sundimi i drejtësisë është për të mirën e qytetarëve dhe për të mirën e zhvillimeve të përgjithshme të Kosovës. Kon-



solidimi i drejtësisë atakon vetëm atë që me vite të tëra është duke e shfrytëzuar këtë kaos, këtë anarki dhe anomalitë në drejtësinë kosovare, përmes formave të ndryshme kriminale.

Në të kaluarën jo shumë të largët, drejtësia kalkulohej dhe bëhej duke zbatuar vendime dhe urdhra politike, të



padrejtësi, gjyqësori në kolaps



gatuara në kancelaritë pushtetmbajtëse - politike. Shumë profesionistë në gjyqësor, ishin vetëm zbatues të devotshëm të politikave ditore të këtyre kancelarive. Aktualisht, shumë gjyqtarë dhe prokurorë të po atij sistemi, ende punojnë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës. Është e qartë se disa prej tyre



nuk kanë ndryshuar shumë nga mentaliteti i së kaluarës, edhe pse po bëhen 10 vjet të çlirimit nga prangat e atij sistemi tashmë të dështuar. Mjerisht, kjo gjendje ka ndryshuar vetëm në aparençë, përndryshe gjyqtarët dhe prokurorët ende nuk janë të pavarur në vendimet dhe veprimet e tyre dhe ende punojnë me interferenca, nën kërcënime e shantazhe të ndryshme, nën kanosje për humbjen e vendeve të punës, pa siguri personale dhe familjare, pa siguri financiare...

Fajtorët

Gjendja aktuale në drejtësinë kosovare mund të pasqyrohet me pak fjalë: e rëndë, me tensione të brendshme, me rritje të mosbesimit... Në shikim të parë një gjendje pa rrugëdalje dhe shumë shqetësuese.

Arsyet për këtë gjendje janë të shumta, por arsyeja parësore është se shoqëria, pushteti, gjegjësisht dy pushtetet në Kosovë (ndërkombëtar dhe ai vendor), gjatë kohës së pasluftës, gjegjësisht, gjatë periudhës transitore, por as sot, nuk i kushtuan dhe nuk i kushtojnë vëmendje aq të sinqertë dhe profesionale, këtij segmenti të rëndësishëm shoqëror. Pos "shqetësimeve" të përditshme që shprehin udhëheqësit institucionalë të Kosovës, ata nuk ndërmarrin asgjë konkretisht për ta ndryshuar këtë gjendje.

Takimet e fundit të presidentit dhe kryeministrit me gjyqësorin dhe "përkrahja" e tyre, nga shumë profesionistë shihet si e panevojshme dhe humbje kohe. Në vend të kësaj, ata, në mënyrë komode, deri tashti kanë mundur ta nxjerrin ligjin për organizimin e gjyqësorit, gjegjësisht të bëjnë akreditimin e emrave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët tashmë janë të rekomanduar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial i Kosovës. Këto janë obligimet ligjore dhe kushtetuese të dy krerëve kryesorë dhe këtë kanë mundur ta bëjnë me një shpejtësi më të madhe, pasi që e dinë shumë saktë gjendjen e përgjithshme në këtë fushë të drejtësisë. Rekrutimet që janë duke u udhëhequr, në masë të madhe nga ndërkombëtarët, janë procese shpresëdhënëse, por emërimi dhe dekretimi përfundimtar duhet të bëhet nga vendorët, të cilët shihet qartë

se nuk janë duke e bërë punën e tyre në mënyrën e duhur.

Aktualisht gjyqësori është në kolaps. Asnjë gjykatë në Kosovë dhe asnjë prokurori nuk ka personel të mjaftueshëm për zgjidhjen e lëndëve, si pasojë e mosveprimeve institucionale. Kjo gjendje është e njëjtë që gati një vit. Secili qytetar, që ka pasur ndonjë lëndë në gjykatë, e ka përjetuar në kurrizin e tij këtë gjendje. Shtyrje të seanceve, ecejake të shumta deri në caktimin e një seance, prolongime të shumta dhe forma të tjera të maltretimeve të qytetarëve. Kjo është gjendja aktuale, mjerisht. Pushtetarët këtë nuk e përjetojnë, nuk e shohin, sepse ata nuk shkojnë për të kryer asnjë punë, nuk presin në radhë, sepse i bëjnë të tjerët për ta. Nëse kemi parasysh kushtet e përgjithshme të punës dhe jetës së atyre gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë mbetur dhe dukuritë korruptive që e kanë kapluar drejtësinë dhe segmentet e tjera në Kosovë, atëherë para institucioneve relevante shtetërore, tashmë do të duhej të ishte ndezur sinjali i kuq. Megjithatë, ende nuk shihet një brengë aq e sinqertë e tyre.

Faji për këtë gjendje domosdo adresohet te të gjithë pushtetarët, te të zgjedhurit e popullit dhe vetë menaxhuesit e niveleve të ndryshme të gjyqësorit.

Qasja jo serioze e të zgjedhurve të popullit

Të gjithë tashmë e shohin dhe e dëgjojnë se gjyqësori mbetet segmenti më i kritikuar, edhe nga Bashkimi Evropian edhe nga organizatat e tjera ndërkombëtare. Kjo kërkon qasje dhe kujdes të posaçëm ndaj këtij segmenti, nëse pretendojmë integrimin euroatlantik.

Pa një përkujdesje serioze dhe profesionale ndaj gjyqësorit, gjendja në këtë segment nuk do të përmirësohet, madje do të keqësohet edhe më shumë dhe pretendimet integruese do të mbeten vetëm dëshirë. **Edhe qasja e deputetëve të Kosovës, lidhur me këtë çështje, deri tashti ka qenë jo serioze, madje do të thosha edhe hipokrite. Në njërin anë, ata e kritikojnë qeverinë për këtë gjendje, në anën tjetër, kur diskutohej për ligjin mbi organizimin e gjyqësorit kishin shumë rezerva në nenet ku**

Deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë përkrahur misionin evropian EULEX, në luftën kundër korrupsionit

Deputetët kërkojnë ndëshkimin e të korruptuarve



Muhamet JAHIRI

Luftën kundër korrupsionit, të filluar nga misioni evropian në Kosovë EULEX, e të përkrahur nga përfaqësuesit më të lartë të institucioneve të vendit, e përkrahin edhe deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ata kërkojnë që EULEX-i të veprojë më fuqishëm dhe me një vendosmëri më të madhe për ta luftuar këtë dukuri, e cila sipas tyre po e largon vendin tonë nga integritet.

Beqiri: Të gjithë të korruptuarit duhet të ndëshkohen



Deputeti Ismet Beqiri ka thënë se nëse vërtet gjenden fakte për korrupsion, atëherë duhet të ndërmerren të gjitha hapat

që, të paktën, të zvogëlohet kjo dukuri nga shoqëria kosovare.

“Nëse ka dëshmi dhe faktografi duhet të merren veprime të guximshme në mënyrë që të luftohen këto dukuri shumë të dëmshme për shoqërinë. Këto dukuri nuk mund të çrrënjosen, por të paktën të fillohet që të luftohen në mënyrë që të zvogëlohen deri në minimum”, - ka thënë Beqiri duke shtuar se ai, si deputet i Kosovës, i përkrah iniciativat e fundit për luftimin e korrupsionit.


“Unë si deputet e përkrah këtë iniciativë dhe duhet të punohet nga ana e drejtësisë me të gjitha indicjet, për t'i hulumtuar dyshimet që ka në luftimin e korrupsionit, i cili nuk mund të mohohet se nuk ekziston. Perceptimi është se në shoqërinë kosovare ka korrupsion dhe se ai duhet të luftohet absolutisht dhe kush gjendet në ato ujëra duhet ta marrë shpërblimin nga gjyqësori”, - është shprehur Beqiri.

Sipas Beqirit, institucionet e Kosovës

duhet t'i kryejnë obligimet e veta në luftën kundër korrupsionit dhe dukurive negative.

“Me këtë dua të them se organet e drejtësisë duhet ta bëjnë punën e tyre dhe nuk duhet të pengohen nga askush dhe rastet e hulumtimit duhet të çohen absolutisht deri në fund”, - ka deklaruar Ismet Beqiri.

Kosumi: Pakica janë të korruptuar, shumica jo



Edhe deputeti Bajram Kosumi e ka përkrahur iniciativën e EULEX-it për ta luftuar korrupsionin në Kosovë. Ko-

sumi ka thënë se nuk duhet të fajësohet shumica e shoqërisë kosovare për korrupsion, sepse, sipas tij, shumica janë të pastër, por kemi një pjesë të vogël të korruptuarish.

“Besoj se beteja kundër korrupsionit mund të fitohet për arsyen e thjeshtë se nuk janë të korruptuar të gjithë dhe është gabim perceptimi i imazhit se të gjithë janë të korruptuar, sepse kjo nuk është e vërtetë. Pakica është e korruptuar, ndërsa shumica është e pakorruptuar. Por, ajo pakicë e korruptuar është e fortë, i ka mekanizmat në duart e veta dhe është e fortë që të mbrohet”, - ka theksuar Kosumi.

Sipas tij, lufta kundër korrupsionit në Kosovë nuk do të jetë e lehtë për arsye se, në bazë të të gjitha informacioneve dhe raporteve që po bëhen, po shihet se korrupsioni e ka prekur sistemin e pushtetit në Kosovë, qoftë në pozitë, qoftë në opozitë.

Më tutje, deputeti Kosumi ka fajësuar edhe EULEX-in, i cili sipas tij është vonuar në luftën kundër korrupsionit.

“EULEX-i ka pasur një vonesë në këtë drejtim dhe ka qenë momenti i fundit kur EULEX-i është dashur të

tregohet se pse ka ardhur në Kosovë. Ka qenë një gabim fatal ai që filloi me Albin Kurtin, sepse ky mision ka ardhur në vendin tonë për t'i ndihmuar institucionet, për të vendosur rendin dhe ligjin, për të luftuar krimin, korrupsionin, etj”, - ka deklaruar ai.

Ndër të tjera, Kosumi ka kërkuar nga institucionet përgjegjëse që të veprojnë të pavarura për të luftuar deri në fund këtë fenomen negativ në Kosovë.

“Gjykata duhet të dëshmojë se kush është fajtor dhe kush nuk është. Prandaj e inkurajoj EULEX-in që ta vazhdojë me një hov edhe më të madh punën e nisur dhe, po ashtu, inkurajoj edhe institucionet e Kosovës që të mos e pengojnë punën e nisur të këtij misioni”, - ka pohuar deputeti Kosumi.

Zeneli: Pjesë e aferave korruptive edhe pushteti



Lidhur me korrupsionin është shprehur edhe deputeti Lulzim Zeneli, i cili ka theksuar se lufta kundër korrupsionit do

të jetë shumë e vështirë, sepse nuk ka vullnet politik për ta luftuar këtë dukuri.

“Do të jetë sfida më e madhe e Kosovës sepse qeveria nuk ka vullnet politik, është e kompromentuar, nuk ka autoritet dhe ka një pozicion, i cili ka humbur legjitimitetin”, - ka theksuar Zeneli.

Sipas Zenelit, pjesë e këtyre aferave korruptive janë edhe përfaqësuesit e institucioneve të vendit, të cilët, sipas tij, po i pengojnë hulumtimet për këtë fenomen.

“Kur dihet se vetë zyrtarët institucionalë janë të përfshirë në afere korruptive dhe në adresë të kësaj qeverie adresohen akuza për korrupsion dhe krim ekonomik, lufta kundër korrupsionit do të jetë vetëm në suazat e një retorike ditore”, - është shprehur Lulzim Zeneli. ■

Prokuroria e Republikës së Kosovës vazhdon të ketë probleme me kryerjen e lëndëve me korrupsion

Kabashi: Prokuroria e Kosovës ka ngecur në lëndët me korrupsionin

Kryeziu: "Momentalisht në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë janë katër prokurorë, ndërsa numri i lëndëve me paraburgim është i madh. Ky është një shkak që të ngecet në kryerjen e veprave të korrupsionit, sepse siç dihet për këto vepra nuk ka të paraburgosur, sepse janë në hetime"

Llolluni: "Lëndët e korrupsionit nuk kanë të paraburgosur, sepse ato ende janë duke u hetuar. Përderisa kemi të akuzuar në burgje, ne duhet t'i shqyrtojmë këto lëndë sepse personat janë prapa grilave."

Mehemeti: "Lëndët që kanë të bëjnë me korrupsion duan shumë hetime dhe janë mjaft të mëdha kur shqyrtohen."



Qendresa MUSTAFA

Prokuroria e Republikës së Kosovës, institucioni më kompetent për luftimin e dukurive negative në vend, vazhdon të shënojë ngecje në kryerjen e veprave penale të korrupsionit.

Kreu i këtij institucioni, Ismet Kabashi, fajin e gjithë kësaj e hedh te mungesa e prokurorëve në gjykatat e Kosovës.

Prokuroria e cila ballafaqohet me më së shumti lëndë të kësaj natyre është ajo e Qarkut të Prishtinës. Janë 90 për qind të rasteve të korrupsionit, të cilat i drejtohen prokurorëve të kësaj gjykate. Këta të fundit ankohen për vështirësitë që u sjell numri i madh i lëndëve dhe mungesa e prokurorëve.

Kabashi: 90 % e rasteve me korrupsion në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë

Kryeprokurori i Kosovës, Ismet Kabashi, ka thënë se prokuroria e Qarkut në Prishtinë ka ngecur në kryerjen e lëndëve që kanë të bëjnë me korrupsionin. Këto deklarata Kabashi i ka bërë gjatë publikimit të raportit mbi punën e Prokurorisë së Kosovës.

"Nuk mund të them se në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë ka pasur sukses në nxënien e trendit të prioritetet në procedimin e lëndëve që kanë të bëjnë me korrupsionin", - ka theksuar Kabashi.

Ai ka deklaruar se arsyeja që në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë ka pasur ngecje në kryerjen e lëndëve që kanë të bëjnë me korrupsionin ka qenë

mungesa e prokurorëve.

"Prokuroria e Qarkut në Prishtinë, gjatë vitit 2009, ka funksionuar me katër prokurorë dhe me disa prokurorë ndihmës, andaj ka pasur edhe ngecje në lëndët me korrupsion", - është shprehur Kabashi.

Ai ka thënë se shumica e lëndëve që kanë të bëjnë me korrupsionin janë në nivel të Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë.

"Është fakt. Unë e thashë se veprat penale të korrupsionit, në të shumtën e rasteve, mbi 90 për qind, janë në nivel të Prokurorisë së Qarkut të Prishtinës", - ka theksuar Kabashi.

Në fund të deklaratës së tij, Kabashi ka treguar se, për momentin, në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë janë 111 persona, për të cilët është duke u bërë grumbullimi i informatave mbi dyshimin e korrupsionit.

"Momentalisht në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë kemi procedurën e grumbullimit të informatave kundër 111 personave të dyshuar për korrupsion", - ka thënë Kabashi

Mungesa e prokurorëve shkakton ngecje në lëndët me korrupsion

Edhe kryeprokurori i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Osman Kryeziu, ka thënë për revistën "Paqja" se moskryerja e lëndëve të korrupsionit qëndron te numri i vogël i prokurorëve në këtë gjykatë

"Momentalisht në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë janë katër prokurorë, ndërsa numri i lëndëve me paraburgim është i madh. Ky është një shkak që të ngecet në kryerjen e veprave të korrupsionit, sepse siç dihet për këto vepra nuk ka të paraburgosur, sepse janë në hetime", - ka thënë Kryeziu.

Të njëjtin mendim e ka ndarë edhe prokurori Gëzim Llolluni. Ai, sikurse


kollegët e tij, fajin më të madh për moskryerjen e lëndëve për korrupsion e ka hedhur te mungesa e prokurorëve në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

"Në këtë gjykatë mungojnë kushtet për punë, ndërsa në anën tjetër është një numër i vogël i prokurorëve, të cilët e kanë të pamundur t'i përfundojnë të gjitha lëndët. Personalisht asnjëherë nuk më ka ndodhur të kem kaq shumë lëndë në sirtarin tim, sa që ka ndodhur që brenda një viti t'i përfundoj 400 sosh, të cilat kanë qenë me paraburgim. Arsyeja e moskryerjes së lëndëve qëndron te numri i vogël i prokurorëve", - ka deklaruar Llolluni.

Ai ka thënë se numri i madh i këtyre lëndëve, të cilat janë me paraburgim, e pamundësojnë një prokuror t'i kryej lëndët të cilat nuk janë me paraburgim.

"Lëndët e korrupsionit nuk kanë të paraburgosur, sepse ato ende janë duke u hetuar. Përderisa kemi të akuzuar në

burgje, duhet n e t ' i



shqyrtojmë këto lëndë, sepse personat janë prapa grilave”, - është shprehur Lolluni.

Ai ka treguar se ka dërguar kërkesën e tij në polici në lidhje me hetimet për personat që janë të involvuar në vepra të korrupsionit.

Ndryshe nga kolegët e tij, prokurori Osman Mehmeti ka thënë se i ka përfunduar të gjitha lëndët me korrupsion.

“Lëndët e natyrës së korrupsionit i kam përfunduar, pra e kam ripërsëritur kërkesën time në polici për të bërë hetime rreth personave të involvuar në këto vepra. Është viti i tretë që unë e ripërsëris kërkesën time në polici për hetimin e këtyre lëndëve”, - është shprehur Mehmeti.

Ai ka treguar se hetimi i lëndëve me korrupsion kërkon shumë punë, sepse janë lëndë vulominoze dhe të natyrës së rëndë.

“Lëndët që kanë të bëjnë me korrupsion duan shumë hetime dhe janë mjaft të mëdha kur shqyrtohen”, - ka deklaruar ai.

Mehmeti ka thënë se nuk është arsye numri i prokurorëve në kryerjen e këtyre lëndëve.

“Në Gjykatën e Qarkut ka mjaft prokurorë. Jemi një më pak se vitet e kaluara. Nuk është arsye numri i prokurorëve për kryerjen e lëndëve”, - ka thënë Mehmeti.

Në raportin e publikuar mbi punën e Prokurorive të Kosovës janë dhënë edhe disa këshilla mbi efikasitetin e punës së prokurorëve. Në mesin e disa këshillave është edhe pagesa e prokurorëve, siguria e tyre, krijimi i kushteve të punës dhe plotësimi i pozitave të prokurorëve. ■

Ismet Hasani



Vështrim sistemit gjyqësor



Jeton ISUFI

Si të gjitha shtetet që pretendojnë të jenë demokratike, e që pushtetin e tyre shtetëror e ushtrojnë përmes tri pushteteve kryesore: pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, edhe vendi ynë i ka këto tri pushtete, të cilat në praktikë janë të pavarura në ushtrimin e funksionit të tyre, por në teori janë të lidhura në mes vete dhe e kontrollojnë njëra-tjetrën në formën e paraparë të veprimit të tyre. Përderisa pushteti legjislativ dhe ekzekutiv e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nga marrja e mandatit të tyre nga populli përmes zgjedhjeve, një gjë e tillë nuk ndodh me pushtetin gjyqësor, për arsye se funksionet që ushtrohen në këtë pushtet duhet të jenë apolitike dhe profesionale në mënyrë që të garantohej ajo që shpesh ne e dëgjojmë nga udhëheqësit tanë: funksionimi i ligjit, i rendit dhe i rregullit.

Meqenëse pushteti gjyqësor është aq i rëndësishëm në funksionimin e drejtë të një shteti, institucionet e Kosovës po mundohen të instalojnë një sistem gjyqësor efikas, i cili do të siguronte funksionimin e mirë të të gjitha ligjeve pozitive.

- **Gjykata Supreme e Kosovës** është autoriteti më i lartë gjyqësor. Orga-

nizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave të tjera (gjykatat e qarkut dhe komunale) rregullohen me ligj. Të paktën pesëmbëdhjetë për qind (15%) e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por jo më pak se tre (3) gjyqtarë, janë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës e emëron dhe e shkarkon Presidenti i Kosovës, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, për mandat shtatëvjeçar, pa mundësi të riemërimit, pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin ose shkarkimin e tij. Kryetarët e të gjitha gjykatave të tjera emërohen në mënyrë të përcaktuar me ligj. Të paktën pesëmbëdhjetë për qind (15%) e gjyqtarëve nga cilado gjykatë tjetër, e themeluar me juridiksionin e apelit, por jo më pak se dy (2) gjyqtarë janë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Gjykatat e specializuara mund të themelohen me ligj kur kjo të jetë e nevojshme, por në asnjë mënyrë nuk mund të themelohen gjykata të jashtëzakonshme. Mirëpo deri me sot nuk është themeluar asnjë gjykatë speciale. A thua nuk ka pasur nevojë që të themelohet gjykatë speciale, apo sistemi gjyqësor i Kosovës është i nivelit aq të lartë sa që nuk ka nevojë për themelimin e gjykatave speciale? Gjyqtarët i emëron, i riemëron dhe i shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit

Gjyqësor të Kosovës. Mandati fillestar për gjyqtarët është trevjeçar. Në raste të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar me ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin. Kriteret dhe procedurat për riemërimin e një gjyqtari, përcaktohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe ato mund të dallojnë në shkallë nga kriteret e përdorura për shkarkimin e gjyqtarëve.

- **Këshilli Gjyqësor i Kosovës** është organ tjetër me rëndësi, i cili siguron pavarësinë dhe paanshinë e sistemit gjyqësor. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës e të ndjekin parimet e barazisë gjinore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë të kualifikuar dhe profesionalë. Anëtarët emërohen për një mandat pesëvjeçar. Këshilli do t'u japë përparësi, për emërim si gjyqtarë, anëtarëve të komuniteteve të nënpërfaqësuar në mënyrën e përcaktuar me ligj. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita gjyqësore, për inspektimin gjyqësor, administrimin gjyqësor, përpilimin e rregullave për gjykatat në pajtim me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave, hartimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit për gjyqësorin, përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin juridiksion dhe bën rekomandime për themelimin e gjykatave të reja. Themelimi i gjykatave të reja bëhet me ligj.

Prokurori i Shtetit është

insti-



insti-
tucion i pavarur, me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj. Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit. Organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit rregullohen me ligj. Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore. Mandati fillestar për prokuror është trevjeçar. Në rast të riemërimit, man-

dati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar me ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin. Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçar, pa mundësi riemërimi.

Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, në pajtim me ligjin. Këshilli Prokurorial i Kosovës

siguron qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë personat në Kosovë. **Këshilli Prokurorial i Kosovës** siguron që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore. Këshilli Prokurorial i Kosovës do të rekru-





tojë, propozojë, avancojë, transferojë, disiplinujë prokurorët në mënyrën e rregulluar me ligj. Këshilli do t'i japë përparësi emërimit për prokurorë të anëtarëve të komuniteteve të nënpërfaqësuar në mënyrën e përcaktuar me ligj. Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. Përbërja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe dispozitat për emërimin, shkarkimin, mandatin, strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, rregullohen me ligj.

Avokatura është profesion i pavarur, e cila ofron shërbime sikurse është e rregulluar me ligj. Mënyra e fitimit të së drejtës për të ushtruar profesionin e avokatit, si dhe marrja e kësaj të drejte, rregullohen me ligj.

Parregullsitë

Me gjithë rregullativën e mirë ligjore, sa i përket sistemit gjyqësor, prapëseprapë në Kosovë po mungon funksionimi i mirë i këtij sistemi.

Pothuajse të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare, të cilat merren me monitorimin e punës së këtij pushteti, e nxjerrin si institucionin më jo aktiv dhe joefikas në punën e tij. Ky joefikasitet i tij e ka një adresë, ose një arsye, pse gjendet në këtë gjendje dhe në fokus të kritikave. Mjafton të përmendet raporti i rritjes ballkanike për gazetari hulumtuese BIRN. Aty nxirren shumë parregullsi në funksionimin e gjykatave të qarkut dhe gjykatave komunale. Këto parregullsi ose probleme, kryesisht, kanë të bëjnë me stafin e gjykatave, e sidomos me disiplinën në punë. Ndër këto, problemet më kryesore në gjykatat e Kosovës janë: moslajmërimi i gjykimeve në tabelën e shpalljeve, vonesa e fillimit të gjykimeve, caktimi i pakoordinuar i seancave gjyqësore mes gjykatësve e prokurorëve, ku jo rrallë herë ndodh që seancat të shtyhen për shkak të mungesës së prokurorëve, fillimi i seancave pa përbërjen e plotë të trupit gjykues, mosfikasiteti i policisë për urdhëresat, mospërdorimi i pajisjeve elektronike nëpër gjykata, përdorimi i telefonave celularë gjatë mbajtjes së gjykimeve, mbajtja e gjykimeve në zyrat e gjykatësve, etj. Të gjitha këto të meta paraqesin sfidë për funksionimin normal të sistemit gjyqësor. Me një intervenim në stafin menaxherial, administrativ dhe një numri të gjykatësve, të cilët janë dëshmuar si jo të denjë për ushtrimin e funksionit të gjykatësit

ose prokurorit, do të evitoheshin këto probleme. Kjo do të do të mundësonte rregullimin dhe orientimin e funksionimit normal të gjykatave.

Mirëpo shtrohet pyetja se çka tjetër po e pengon funksionimin e mirë të sistemit gjyqësor në Kosovë? Joefikasiteti i gjykatësve dhe prokurorëve, mungesa e tyre, grumbullimi i madh i lëndëve, mungesa e sallave për mbajtjen e gjykimeve, kultura e ulët qytetare dhe shtetërore në respektimin e ligjit dhe në rastin e shkeljes së tij dhe ndoshta lidhjet familjare në këtë sistem, për shkak të popullsisë së vogël në Kosovë, po e ngufatin sistemin gjyqësor të Kosovës dhe mirëfunksionimin e tij.

Në funksionimin e sistemit gjyqësor, pa dyshim, që ka kontribuar edhe numri i madh i lëndëve, të cilat kanë hyrë në shqyrtim e në mungesë të kuadrove, por edhe të përzjerjes së kompetencave, grumbullimi i shumë lëndëve ka bërë që ato të mos zgjidhen në kohën e paraparë ligjore, e jo rrallë herë edhe t'ju skadojë afati duke qëndruar në sirtarët e gjykatave. Ky grumbullim i lëndëve ka ndikuar që të paraqitet pengesa tjetër, e cila është më e pranishme në institucionet tona, e pa dyshim ky është korrupsioni. Ky fenomen është më i përhapuri në këtë sistem.

Nëse marrim parasysht vendin tonë si një vend i vogël dhe ende në procesin e formimit të tij, pengesë paraqesin edhe lidhjet që kanë bartësit e këtij pushteti me

bartësit e pushteteve tjera, gjë e cila në një vend si Kosova nuk është për t'u befusuar.

Askund nuk shkohet pa u nisur, edhe ne jemi nisur drejt funksionimit të shtetit ku mbizotëron ligji, e pa dyshim sistemi gjyqësor është bartësi kryesor i garantimit dhe funksionimit të një shteti me standarde të larta demokratike. ■

Autori është student në Fakultetin Juridik dhe aktualisht është Nënkryetar i Parlamentit të Studentëve të Universitetit të Prishtinës.



Gjyqtarët e Kosovës e kanë përkrahur futjen e dënimit të përjetshëm në Kodin Penal të Kosovës

Përkrahhet dënimi i përjetshëm

“Unë jam caktuar për hartimin e Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe, në këtë kuptim, pjesëmarrja ime tregon përkrahjen e iniciativës që në KPK të kemi dënim të përjetshëm. Ne si shoqëri po ballafaqohemi me shumë vepra të rënda penale, të kryera në rrethana aq të rënda dhe në shkallë aq të lartë të rrezikshmërisë shoqërore, për të cilat dënimi afatgjatë prej 40 vitesh burgim, që është i paraparë me KPK-së, nuk është i mjaftueshëm”, - ka thënë gjyqtari Hamdi Ibrahim, njëherësh edhe iniciuesi për miratimin e dënimit të përjetshëm.



Qendresa MUSTAFA

Kryerja e veprave të rënda penale në Kosovë mund të kush-tojë me dënim të përjetshëm. Kjo ngaqë njerëzit e drejtësisë së Kosovës kanë propozuar futjen e një mase të tillë në reformimin e Kodit Penal të Kosovës. Nëse një propozim i tillë do të miratohet nga grupi punues për ndryshimin e Kodit Penal të Kosovës, atëherë kryerja e një vrasjeje të shkallës së parë, do të mund të gjykohej me burgim të përjetshëm.

Gjyqtari Hamdi Ibrahim, njëherësh edhe iniciues për miratimin e dënimit të përjetshëm, ka thënë se kjo masë duhet të miratohet, sepse Kosova po ballafaqohet me shumë vepra të rënda, të cilat po e rrezikojnë edhe rrethin shoqëror.

“Unë jam caktuar për hartimin e Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe, në këtë kuptim, pjesëmarrja ime tregon përkrahjen e iniciativës që në KPK të kemi dënim të përjetshëm. Ne si shoqëri po ballafaqohemi me shumë vepra të rënda penale, të kryera në rrethana aq të rënda dhe në shkallë aq të lartë të rrezikshmërisë shoqërore, për të cilat dënimi afatgjatë prej 40 vitesh burgim, që është i paraparë me KPK-së, nuk është i mjaftueshëm”, - ka thënë Ibrahim.

Ai ka deklaruar se miratimi i dënimit të përjetshëm do të ndikonte në parandalimin e kryerjes së veprave penale që kanë të bëjnë me natyrë të rëndë.

“Mendoj se dënimi me burgim të përjetshëm do të ndikonte në parandalimin e kryerjes së veprave të rënda penale, sepse secili individ që mendon të kryejë vepra të tilla, paraprakisht, do të ishte në dijeni se e pret burgun e përjetshëm”, - është shprehur ai.

Ibrahim ka thënë se dënimi maksimal prej 40 viteve, i cili është në fuqi, tash nuk mjafton, sepse, sipas tij, ky dënim ka edhe masat zbutëse dhe lirinë me kusht që do t'i mundësonte çdo të akuzuar të mos e përfundonte dënimin deri në fund.

“Kështu sikurse është tash, dënim deri në 40 vite dhe jo më shumë, do t'i mundësonte individëve, që janë të prirë për kryerjen e veprave të rënda penale, që të shpresojnë në daljen e tyre nga burgun”, - ka deklaruar Ibrahim.

Ai ka theksuar se përveç propozimit që të ketë dënim të përjetshëm në Kodin Penal të Kosovës, është dakord të jetë edhe dënimi me 40 vjet burgim.

Ndërsa i pyetur se pse duhet të ketë dënim të përjetshëm në Kosovë, përderisa një masë e tillë nuk ekziston në vendet e Evropës, gjyqtari Ibrahim ka thënë se “e vetmja arsye është gjendja në Kosovë, sa i përket veprave penale që kryhen”.

Në fund të deklaratës së tij, Ibrahim ka deklaruar se është i gatshëm të japë një dënim të tillë për kryesit e veprave të rënda penale.

“Po, pa hezitim do ta shpallja një dënim për personat që kanë kryer vepra të rënda penale”, - ka thënë Ibrahim.

Në anën tjetër, futjen e dënimit të përjetshëm në Kodin Penal të Kosovës e kanë përkrahur edhe gjyqtarët e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, gjykatë kjo, e cila ballafaqohet më së shumti me vepra penale të natyrës së rëndë.

Gjyqtarja Marie Ademi është shprehur e gatshme që dënimi maksimal prej 40 vjetësh të zëvendësohet me dënim të përjetshëm.

“Të gjitha veprat penale, për të cilat dënimi mund të jetë deri në 40 vjet, jam dakord që të shndërrohen në dënim të përjetshëm”, - ka thënë Ademi.

Ajo madje ka treguar disa raste kur ka shpallur dënim maksimal ndaj të

akuzuarve, lëndën e të cilëve e ka kryesuar ajo.

“Ka disa raste kur unë kam shpallur dënim maksimal prej 40 vjetësh. Këta të dënuar, pas një kohe, me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës edhe janë liruar me kusht, ose edhe u është zbutur dënimi dhe nuk e kanë përfunduar dënimin 40 vjet, ashtu sikurse edhe u është shqiptuar. Për këtë arsye, është i nevojshëm dënimi i përjetshëm”, - ka thënë ajo.


Ademi ka thënë se miratimi i dënimit të përjetshëm në Kodin Penal të Kosovës do të ndikonte në uljen e kryerjes së veprave penale.

“Të gjitha dënimet janë të parapara si preventivë për vetëdijesimin e individëve që të mos kryejnë vepra penale. Ndoshta dënimi i përjetshëm do të ndikojë në uljen e veprave penale”, - është shprehur Ademi.

Ndërsa e pyetur se a do të ishte e gatshme të shpallte një dënim të përjetshëm, Ademi ka thënë: “Do e kisha shpallur një dënim të tillë nëse do të vërtetoja se një individ është kryesi i veprës penale me natyrë të rëndë. Nuk do ta kisha pasur problem të shpallja një dënim dhe pasi të marr një vendim nuk mendoj më pas për të, sepse e shqyrtoj mirë rastin”.

Edhe Raif Emiri, njëherësh gjyqtari më i vjetër në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e ka përkrahur miratimin e dënimit të përjetshëm.

“Është më mirë të futet dënimi i për-



Përvjetshëm

jetshëm, sepse kriminaliteti ka marrë shumë hov në Kosovë, sidomos për vepra të rënda penale, të cilat kanë pasojë katastrofale për shtetin tonë të ri", - ka thënë Emini.

Po ashtu sikurse kolegët e tij, ai është shprehur i bindur që një masë e tillë do t'i parandalonte personat, të cilët, sipas Emini, janë kryes të veprave të rënda penale.

"Ky lloj dënimi sigurisht do t'i parandalonte individët, të cilët janë potencialisht kryes të veprave të rënda penale që mos t'i kryejnë ato, sepse po të mësonin për shqiptimin e dënimit të përjetshëm do të mendoheshin mirë", - është shprehur ai.

Emini ka thënë se dënimi prej 40 vjetësh burgim, shpeshherë, te të dënuarit zbutet dhe këta të fundit, sipas tij, lirohen me kusht dhe nuk arrijnë ta përfundojnë dënimin e plotë.

"Kjo ndikon edhe në psikikën e njerëzve, se edhe po të kryejnë një vepër penale do t'iu zvogëlohet dënimi. Kjo dallon në krahasim me dënimin e përjetshëm, sepse aty nuk ka falje", - është shprehur Emini.

Ai ka treguar se dënimi i përjetshëm mundet të rregullohet nëse kryesi i veprës penale gjatë vuajtjes së dënimit përmirësohet në sjellje dhe, për këtë, gjykata mund ta zëvendësojë dënimin me burg në afat të gjatë, pa të drejtë amnistie ose falje.

Emini ka deklaruar se dënimi i përjetshëm duhet të rregullohet me ligj për një periudhë të caktuar.

"Ky sistem amerikan nuk praktikohet në Evropë. Duke parë gjendjen e rëndë të kriminalitetit në Kosovë, atëherë, ndoshta, për një periudhë të caktuar duhet të rregullohet me ligj dënimi i përjetshëm", - ka deklaruar Emini.

I pyetur se a do të shpallte një dënim të përjetshëm, Emini ka thënë: "Po, jam në gjendje sepse profesioni i gjyqarit nuk lidhet me ndjenjë, sepse interesi i shoqërisë është më i madh se ndjenjat e veçanta të individit".

Sipas Nenit 35 të Kodit Penal të Kosovës, dënimi me burg afatgjatë për vepra të rënda penale të kryera me dashje, ose në rrethana veçanërisht rënduese, është prej 21 deri në 40 vjet burgim. ■

Shpallet aktgjykimi ndaj Albin Kurtit nën akuzat se ka kryer veprën penale pjesëmarrje në grup që pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrës zyrtare

Mbaron procesi kundër Kurtit, dënohet me nëntë muaj burgim

"Në emër të popullit shpallim aktgjykimin ndaj të akuzuarit Albin Kurti, i cili sipas nenit 318 paragrafit 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës shpallet fajtor për veprën penale pjesëmarrje në grup që pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrës zyrtare dhe dënohet me nëntë muaj burgim", - ka thënë gjyqtari Buatier de Mongueto.

Qëndresë MUSTAJA

Pas një procesi të gjatë maratonik, Lideri i Lëvizjes " Albin Kurti është dënuar me nëntë muaj burgim nën akuzat se ka kryer veprën penale pjesëmarrje në grup që pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrës zyrtare. Aktgjykimi është shpallur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë nga gjyqtari ndërkombëtar i EULEX-it, Ferdinando Buatier de Mongueto.

"Në emër të popullit shpallim aktgjykimin ndaj të akuzuarit Albin Kurti, i cili sipas nenit 318 paragrafit 1 dhe 2 të Kodit Penal të Kosovës shpallet fajtor për veprën penale pjesëmarrje në grup që pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrës zyrtare dhe dënohet me nëntë muaj burgim", - ka thënë gjyqtari Buatier de Mongueto.

Kurti pas shpalljes së aktgjykimin është liruar pasi që gjatë vitit 2007 ai ka mbajtur dhjetë muaj paraburgim dhe sipas gjyqarit Buatier de Mongueto kjo kohë e paraburgimit i llogaritet në dënim.

"Ndëshkimi më i vogël për këtë vepër penale do të ishte një vjet burgim mirëpo trupi gjykues sipas nenit 66 te Kodit Penal të Kosovës ka gjetur se duhet të zbritet dënimi. Duke marr parasysh se Kurti ka kaluar më shumë paraburgim se dënim që është shqiptuar ai nuk duhet të kthehet në burg", - ka deklaruar Buatier de Mongueto.

Me këtë aktgjykim Kurti është urdhëruar t'i paguajë edhe shpenzimet e gjyqësorit.

Pas shqiptimit të aktgjykimin gjyqtari Buatier de Mongueto ka dhënë arsytet se mbi çka është bazuar një masë e tillë e dënimit.

"I akuzuari Albin Kurti ka kryer veprën penale që e përshkruan pika 2 e aktakuzës. Në veçanti është vërtetuar se Kurti si lideri

i një organizate me veprimet e përbashkëta ka penguar SHPK-në dhe policë e UNMIK-ut në kordonin që ata kishin bërë për të parandaluar demonstruesit. Këta



policë ishin duke e kryer punën e tyre si zyrtar dhe nga kjo Kurti ka ra në kundërshtim me urdhrat e dhëna nga zyrtarët policor", - është shprehur Buatier de Mongueto.

Pas përfundimit të procesit gjyqësor, Kurti është paraqitur para medieve me çrast ka thënë se shpallja e këtij aktgjykimi nga EULEX-i është bërë vetëm për t'i mbuluar legalisht letrat e tyre të brendshme të padrejtësisë së deritashme.

"Meqë nëse unë kam qëndruar në paraburgim gjithsej dhjetë muaj, pesë në burg dhe pesë në arrest shtëpiak EULEX-i shqiptoi një dënim për letrat e tyre të brendshme. Ky dënim është mbulesë legale dhe juridike për EULEX-in dhe nuk ka të bëjë me demonstratën e 10 shkurtin të vitit 2007 dhe as kundër meje. Ata edhe njëherë e dëshmuar se prej fillimit deri në fund hall të vetëm e kanë vetën e tyre, pra duan që EULEX-i të duket në aspektin legal dhe juridik në rregull", - ka thënë Kurti.

Aktgjykimi është shpallur pas propozimit të Prokurorit Special të Kosovës Ali Rexha, i cili ka kërkuar dënim sipas ligjit për Albin Kurtin nën akuzën se ka kryer veprën penale pjesëmarrje në grup që pengon personat zyrtarë në kryerjen e detyrës zyrtare. Prokurori Rexha gjatë të njëjtës seancë ka hequr dorë nga pika 1 dhe 3 e akuzës me të cilat Kurti akuzohej për veprën penale pjesëmarrje në grup që kryen vepër penale dhe veprën penale thirrje për rezistencë. ■



Ligjet nxirren nga Kuvendi, por idetë për ligje të reja vijnë nga burime të ndryshme në shoqëri - shtet. Ato mund të vijnë nga politikat e partive në qeveri, mund të vijnë nga idetë e deputetëve të Kuvendit, nga departamentet e ndryshme të qeverisë ose nga përfaqësues të elitës intelektuale dhe nga shoqëria civile.



Mr. Flamur HYSENI

Në fillim të çdo viti, qeveria e miraton strategjinë legjislativë, ku parasheh se cilat fusha shoqërore duhen mbuluar, duke nxjerrë ligje të reja, ose duke futur në kuadër të strategjisë ligje, të cilat duhen ndryshuar. Këto ide mund të vijnë nga vetë kabineti qeveritar. Kjo do të thotë se mund të vijnë nga ministritë përkatëse, të cilat janë kompetente për t'i zbatuar ligjet e caktuara. Po ashtu, idetë për ligje

të reja mund t'i futë në plan qeveria, duke pasur parasysh edhe kërkesat e shoqërisë civile. Por kjo, zakonisht, ndodh më tepër në demokracitë e zhvilluara perëndimore, kurse te ne dhe, në përgjithësi, në Ballkan nuk është shumë e njohur kjo formë e presionit demokratik që e shtyn qeverinë t'i ketë parasysh kërkesat e shoqërisë civile për ndonjë ligj të ri.

Nëse bëjmë një krahasim me format e bashkëpunimit të qeverive të shteteve të tjera perëndimore me shoqërinë civile, ku ka debate të mjaftueshme për iniciativa të reja legjislativë, si nga shoqëria civile ashtu edhe nga komuniteti i biznesit, në përgjithësi, në Ballkan bashkëpunime të tilla janë shumë

të zbehta, për të mos thënë se nuk ka fare bashkëpunime të tilla. Kjo ndodh për shumë arsye, por si arsye themelore do të kisha thënë se është mungesa e një tradite bashkëpunimi ndërinstytucional, demokracia e brishtë dhe në zhvillim, gjendja ekonomike jo stabile, mungesa e kushteve infrastrukturore dhe mungesa e fondeve të veçanta për bashkëpunime të tilla.

Bashkëpunimi qeveri-shoqëri civile do të identifikonte shumë nevoja të shoqërisë, të cilat do të kishin nevojë për t'u rregulluar me ligje përkatëse dhe do të lindnin shumë ide funksionale, ku dhe do të dilnin shumë rezultate pozitive në vënien në funksion të qytetarëve (shoqërisë civile) dhe njëherësh do të



t'i rregulluar çështjet e caktuara me ligje, por këto ide krijohen nga burokratët profesionalë në zyrat e organeve të shtetit, pa debate publike, atëherë do të ishte shumë e vështirë që këto ligje të jenë të pranueshme në të ardhmen për respektimin e tyre, me rastin e kërkesave nga ana e qeverisë, sepse shoqëria nuk do të mund t'i pranonte si të vetat, pasi do të ishte totalisht e paedukuar dhe e panjoftuar në këtë drejtim për rëndësinë e tyre. Këtu, pra, do të ketë një shkëputje të traditës së bashkëpunimit ndërshoqëror dhe kërkesave për zbatim të ligjeve, të cilat janë krijuar nga qeveria dhe fuqizuar nga kuvendi.


Ligjet përgatiten dhe bëhen për popullin pa dallime ndër komunitete, por nuk do të thotë që ato duhen bërë vetëm në stilin profesional. Ato, së pari, i duhen përshtatur kulturës dhe traditës, pastaj mentalitetit të popullit, kushteve ekonomike të tij, standardit të jetesës së tij dhe kërkesave mesatare, që do të mund të shfaqeshin eventualisht nga idetë e shoqërisë. Po, në këtë drejtim, qeveria duhet të bëjë plane afatgjata se si të nxisë interesimin e qytetarëve për të dhënë kontributin e tyre në debate publike për ligje të caktuara dhe të debatohet detajisht për projekt – draftin (projektligjin), i cili synohet që në të ardhmen e afërt të bëhet ligj, pavarësisht se jetën e cilit komunitet do ta rregullonte në të ardhmen.



Do të ishte absurde nëse ligjet do të kopjoheshin nga shtetet e tjera dhe do të tentohej që po të njëjtat ligje të adaptoheshin në sistemin shoqëror të vendit tonë, sepse në të ardhmen këto ligje do të ishin të papranueshme nga ana e shoqërisë sonë. Për shembull, ne kemi ligjin i cili përcakton lartësinë e dënimit me gjobë në veprat e kundërvajtjes që shkaktohen në komunikacionin e trafikut rrugor. Këto lloj gjobash janë në mospërputhje të lartë me standardin jetësor të gjendjes ekonomike në Kosovë, ku gjoba më e ulët është sa 1/3 e të ardhurave mesatare për muaj të një të punësuarit. Po aq më e papërshtatshme dhe jo serioze

shtohet edhe interesimi i tyre për përkudjesjen ndaj punës së qeverisë dhe do të kishte një vetë edukim në këtë drejtim, ku do të shtohej edhe serioziteti i qasjes së kontrollit në punën e qeverisë së atij shteti. Ky bashkëpunim ndërshoqëror, që do të përfshinte të gjithë faktorët relevantë për krijimin e ideve të reja për plotësimin e kërkesave të shtetasve/qytetarëve që të gëzonin të drejtat e tyre që u garantohen me kushtetutë dhe ligje, do të kishte si rezultat krijimin e ideve të reja origjinale për ligje të caktuara, të cilat pastaj shumë lehtë do të mirëpriteshin nga qytetarët dhe do të respektoheshin dhe kështu do të krijohej tradita dhe kultura e respektimit të ligjeve dhe përfshirjes së tyre në përditshmërinë e shtetasve/qytetarëve.

Nëse shoqëria nuk do të ishte të paktën pjesëmarrëse indirekte e krijimit të ideve për identifikimin e kërkesave për





është mosarritja e efektit të këtyre gjobave, sepse, në të shumtën e rasteve, në pamundësi të kryerjes së pagesës nga kundërvajtësit, këto dënime me gjobë shndërrohen/zëvendësohen nga Gjykata në dënime me burgim. Kjo mund të shkaktojë një efekt të kundërt tek të rinjtë e shumtë (një ditë në burg zëvendësohet me shumë prej 15 €), ku dhe në to bëhen lëshime, sepse është e pamundur të përballohen pagesat për ta përmbushur obligimin financiar që del nga shqiptimi i asaj gjobe të cilën e jep gjykata. Nga e gjithë kjo del se asesi nuk mund të arrihet efekti i këtij

sistemi gjobash të parapara me ligj. Kjo do të thotë se është duke ndodhur e kundërta: ligji nuk respektohet, ndërsa kemi rritje të vazhdueshme të kundërvajtësve. Shembulli tjetër i kundërt me këtë që sapo elaborova është ai me komunitetin e artistëve, ku organizohen debate për shembull për projektligjin për Teatrin Kombëtar, ku atyre u ofrohet një draft i marrë si model diku, nga një shtet shumë i zhvilluar ekonomikisht, i cili për shembull parashih edhe implikime të larta buxhetore. Në këtë debat marrin pjesë një numër simbolik i atyre që në të ardhmen u

preken drejtpërdrejt interesat nga po ky ligj. Ata të cilët synojnë ta imponojnë këtë projekt, llojnë maksimalisht për interesat e dikujt tjetër, i cili fare nuk është as për së afërmi i informuar, se cila është rëndësia e këtij projekti ligjor dhe kështu arrihet disi një marrëveshje dhe bëhet ligji, por pa u llogaritur pasojat që mund të dalin në të ardhmen, si për shembull moszbatimi i tij as 51%. Për ta shmangur këtë duhet që këtyre projekteve t'u paraprihet me një debat serioz, nga i cili do të rezultojnë shumë ide konkrete dhe të pranueshme që për një të ardhme të afërt ose të largët do të llogaritej që ligji do të ishte i pranueshëm nga komuniteti përkatës, të cilit i adresohet, sepse është origjinal dhe konform kërkesave të tyre.

Në vendin tonë ende mungon një kulturë e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesit, shoqërisë civile dhe qeverisë. Në këtë drejtim, po ashtu, ne jemi ende të papërvajë dhe ka fare pak iniciativa ose projekte konkrete për të ndërmarrë iniciativa legjislative nga shoqëria civile (për ta shfrytëzuar nenin 79 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila e garanton këtë të drejtë). Deri më tani, për të mos thënë fare, kanë ekzistuar dy-tri iniciativa të tilla: ajo e KDI-së për ndryshimin e ligjit për vetëqeverisjen lokale, që nuk u mor seriozisht nga kuvendi dhe ajo e OJQ "Lobimi për ligjin dhe demokracinë" për nxjerrjen e "Ligjit për statusin e verbërisë" që u përkrah nga Fondacioni Fridrich Ebert Shtiftung dhe që u zhvilluan debate në të gjitha qytetet e Republikës së Kosovës për nxjerrjen e këtij ligji, por që kërkesa mbeti pa u shtruar deri te Kuvendi. Nga e gjithë kjo doli edhe një e mirë, sepse qeveria e ka edhe këtë projektligj në strategjinë legjislative të vitit 2010, që është një shpresë nga ana e komunitetit të të verbërve se ata do të kenë mundësi që deri në fund të vitit të kenë ligjin i cili do të garantojë të drejtat e tyre dhe se jeta e tyre do të rregullohet sipas standardeve ndërkombëtare.

Mosbashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile së një vendi ka mundësi të çojë në mosfunksionimin e mirëfilltë të shoqërisë dhe demokracisë...

(Autori është Asistent në Katedrën Kushtetuese – Administrative në Fakultetin Juridik të UP-së)

Anketim me qytetarët e Kosovës për Sistemin e Drejtësisë së Kosovës

Qytetarët e Kosovës nuk kanë besim në drejtësi

“Momentalisht se si janë duke u zhvilluar ngjarjet d.m.th nga paslufta e këndej mund të them se pak ka drejtësi. Kështu unë e shoh të vërtetën e ligjit në Kosovë. Edhe kjo pak drejtësi mund të them se është e çrregulluar dhe me vetë faktin se është një gjendje e tillë unë nuk i besoj fare”, ka thënë qytetari Gani Ibrahim.



Qendresa MUSTAFA

Ministri i Drejtësisë së Kosovës, Haki Demolli u ka bërë thirrje qytetarëve të vendit që të kenë besim në sistemin e drejtësisë edhe përkundër që sipas tij kjo drejtësi është duke ardhur me hapa të ngadalë.



Ministri Haki Demolli

“Qytetarëve të Kosovës do t’ua kujtoja se drejtësia vjen ngadalë, por me hapa të sigurt. Mos të humbet durimi sepse, ndonëse me vonesë drejtësia gjithnjë ngadhënjën”, - ka thënë për revistën “Paqja”, ministri Demolli.

Mirëpo edhe përkundër kësaj thirrje, qytetarët e Kosovës në një anketim për



Gani Mulliqi

revistën “Paqja” kanë thënë se besimi në sistemin e drejtësisë së vendit është në përqindje shumë të ulët.

Gani Mulliqi qytetar i Kosovës ka thënë se sistemit gjyqësor në Kosovë nuk i beson fare, sepse brenda këtij institucioni ka shenja korrupsioni.

“Gjithçka në ditën e sotme është duke shkuar si shenjë e korrupsionit dhe asaj të njoftësisë, andaj ka humbur besimi në sistemin e drejtësisë së Kosovës, sepse edhe ky institucion po ballafaqohet me dukuri të tilla”, - u shpreh Mulliqi.

Edhe pse nuk është ballafaquar me ligjin, Mulliqi thotë se ka dëgjuar shumë raste kur gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës nuk e kanë kryer punën e tyre ashtu siç e parashihet ligji.

“Në Kosovë fatkeqësisht ekziston një gjendje e tillë, askush nuk e kryen punën ashtu siç parashihet me ligji”, - ka deklaruar ai.

Mulliqi ka shprehur më shumë besim tek avokati i popullit, duke thënë se ky institucion ka vlera më të mira se Sistemi i Drejtësisë së Kosovës.

“Sa i përket avokatit të popullit kam më shumë besim se sa në sistemin gjyqësor të Kosovës. Ky është mendimi im tani për tani”, - është shprehur Mulliqi.



Nexhaip Karanzi

Në anën tjetër edhe qytetari Nexhaip Karanzi ka shprehur pakënaqësi për Sistemin e Drejtësisë së Kosovës.

“Drejtësia e Kosovës është në nivel shumë të ultë. Sistemi gjyqësor i Kosovës është shumë i dobët, ndërsa sa i përket Avokati të Popullit deri më tash nuk kam dëgjuar se ka përfunduar ndonjë rast madhor për popullin”, - është shprehur Karanzi.

Ai ka thënë se përveç Sistemit të Drejtësisë së Kosovës nuk i beson as Avokatit të popullit dhe kjo vjen si pasojë e mospunës së tyre.



Gani Ibrahim

I pakënaqur me gjendjen e gjyqësorit, është shprehur edhe qytetari Gani Ibrahim, i cili ka thënë se që nga paslufta e deri më tani drejtësia e Kosovës nuk ka triumfuar fare.

“Momentalisht se si janë duke u zhvilluar ngjarjet d.m.th nga paslufta e këndej mund të them se pak ka drejtësi. Kështu unë e shoh të vërtetën e ligjit në Kosovë. Edhe kjo pak drejtësi mund të them se është e çrregulluar dhe me vetë faktin se është një gjendje e tillë unë nuk i besoj fare”, - ka thënë Ibrahim.

Ai këtë e arsyeton me rastet që i ka pasur në gjykatë për të cilat thotë që asnjëherë nuk është ndihmuar nga njerëzit e ligjit.

“Personalisht kam pas raste të vogla kur jam ballafaquar me gjykata, por asnjëherë nuk kam nxjerr përfundim se ndokush prej njerëzve të ligjit mund të kryen punë në aspektin e drejtësisë”, - ka deklaruar Ibrahim.

Të njëjtin mendim ai e ka dhënë

edhe për Avokatin e Popullit.

“I njëjti mendim qëndron edhe për Avokatin e Popullit, sepse më ka ra rasti të ballafaqohem edhe me këtë institucion, raste që kanë mjaftuar të marrë një mendim edhe për ta”, - është shprehur Ibrahim.



Teuta Berisha

Besimi në Institucionet e Kosovës për qytetaren Teuta Berisha është në nivelin zero. Ajo thotë se kjo bindje vjen nga shenjat e korrupsionit që vërehen në sistemin e drejtësisë.

“Besimi në institucionet e tona për mua personalisht është zero. Në Sistemin e Drejtësisë së Kosovës ka shenja jo 50 a 60 për qind të korrupsionit, por 100 për qind. Në anën tjetër këta punonjës nuk e përfundojnë asnjëherë punën në

atë mënyrë siç e parasheh ligji”, - është shprehur Berisha.

Ajo mendon se njerëzit e drejtësisë për momentin punojnë vetëm nëse e njih një person ose nëse u jep edhe para kesh në dorë.

“Nëse nuk ke të japësh kesh ose nuk ke të njohshëm mundësinë për ta përfunduar një rast është zero”, - ka thënë Berisha.

Ajo ka deklaruar se të gjitha padrejtësisë e Sistemit Gjyqësor të Kosovës i ka parë dhe dëgjuar nëpër media vendore.

“Personalisht nuk më ka ra rasti të ballafaqohem drejtpërdrejt me gjykata, por të gjitha këto padrejtësi po vërehen nëpër media”, - ka deklaruar Berisha.

Në anën tjetër ajo ka theksuar se Avokati i Popullit ballafaqohet me raste të ndryshme dhe sipas saj ky institucion nuk mund të ec përpara pasi që nuk ka kuadro rreth vetes.

“Avokati i popullit ka shumë raste të shumta sa nuk mundet t'i përfundojë ato sepse nuk ka staf të kompletuar që mund të ballafaqohen me të gjitha kërkesat e qytetarëve të Kosovës. Pra 100 për qind e popullatës shkon përmes Avokatit të Popullit dhe ky është problemi që nuk mund të përfundohen të gjitha punët në këtë institucion”, - ka deklaruar Berisha.



Majlinda Nura

Edhe Majlinda Nura ka pohuar që nuk ka drejtësi e as besim në sistemin gjyqësor.

“Nuk mund të them se ka drejtësi në Kosovë sepse të gjithë njerëzit e ligjit po i shikojnë interesat dhe xhepat e tyre dhe jo interesat e qytetarëve”, - ka thënë Nura.

Edhe pse nuk është ballafaquar me ligjin mosbesimi për Sistemin e Drejtësisë sipas Nures ka ardhur nga ato që ka dëgjuar dhe ka parë në media.

Mirëpo kjo qytetare besim pak më të madh ka për Avokatin e Popullit.

“Sa i përket Avokatit të Popullit mund të them se kam një besim pak më të ngritur, por jo edhe aq të madh sa të krenohemi me të”, - ka thënë Nura. ■

